



Bashkia Elbasan
Plani i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike
2024 – 2040

Mars 2024

Deklaratë e rëndësishme

Përparimi i planifikimit të përshtatjes afatmesme dhe afatgjatë përmes një procesi të Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) në Shqipëri është projekt i financuar nga GCF-ja. Përfituesi i drejtpërdrejtë i projektit është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë. Projekti zbatohet nga Zyra e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri. Pikëpamjet dhe komentet në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të lartpërmendura.

Tabela e përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	2
1 HYRJE	7
1.1 RËNDËSIA E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	7
1.2 FUNKSIONET E PVP-SË.....	7
1.3 KUADRI POLITIK DHE INSTITUCIONAL PËR PLANIFIKIMIN E PËRSHTATJES	8
1.4 PËRMBLEDHJE E ORGANIZIMIT TË PVP-SË (PËRMBLEDHJE E KAPITUJVE).....	8
2 RRETHANAT VENDORE	10
2.1 TIPARET GJEOGRAFIKE	10
2.1.1 <i>Tiparet vendore</i>	11
2.1.2 <i>Zonat urbane</i>	12
2.1.3 <i>Tiparet ekologjike</i>	12
2.2 EKONOMIA DHE TRAJEKTORJA EKONOMIKE	13
2.2.1 <i>Bazat e ekonomisë</i>	13
2.2.2 <i>Treguesit ekonomikë</i>	14
2.2.3 Trajektorja për të ardhmen dhe përparësitë e zhvillimit ekonomik të bashkisë	15
2.3 KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE	17
2.3.1 <i>Varfëria</i>	17
2.3.2 <i>Treguesit shëndetësorë</i>	17
2.3.3 Treguesit arsimorë	18
2.4 PROFILET E SEKTORËVE ME PËRPARËSI	19
2.4.1 Bujqësia	19
2.4.2 Zhvillimi Urban	20
2.4.3 Turizmi	20
2.4.4 Energjia	20
2.4.5 Transporti	21
3 QEVERISJA DHE KUADROT RREGULLATORE, SI DHE POLITIKAT, PLANET DHE PROGRAMET PËRKATËSE	22
3.1 PROFILI I QEVERISJES NË ELBASAN.....	22
3.2 OBJEKTI I PLANIT VENDOR TË PËRSHTATJES.....	22
3.3 LIDHJET ME STRATEGJINË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT/KUADRIN E PLANIFIKIMIT	23
4 PROCESET QË MBËSHTESIN HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË PËRSHTATJES	25
4.1 ORGANIZIMI I NEVOJSHËM INSTITUCIONAL PËR PROCESIN E PVP-SË	25
4.2 PROCESET E ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT.....	26
4.3 INFORMACIONE/ORGANIZIME INSTITUCIONALE SHITESË TË NEVOJSHME PËR PROCESIN E PVP-SË.....	26
5 INFORMACIONI MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE	28
5.1 PËRKUFIZIMI I TERMAVE KYÇ.....	28
5.2 INFORMACIONI KLIMATIK	29
5.2.1 Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri	29
5.2.2 Parashikimet klimatike për të ardhmen për Shqipërinë	31
5.2.3 Rreziqet	34
5.3 QASJA E VLERËSIMIT TË RISKUT DHE CENUESHMËRISË.....	35
5.4 DISPONUESHMËRIA DHE NEVOJA PËR TË DHËNA.....	39
6 NDIKIMET SEKTORIALE	40

6.1	HAPI 1: VLERËSIMI I NDIKIMIT KLIMATIK NË ELBASAN	40
6.2	HAPI 2: IDENTIFIKIMI I RISKUT.....	42
6.3	HAPI 3: PIKËZIMI I RISKUT	42
6.4	ANALIZA SEKTORIALE DHE MUNDËSITË PËR BASHKINË ELBASAN	43
6.4.1	Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar.....	44
6.4.1.1	<i>Risqet nga temperaturat më të larta</i>	<i>45</i>
6.4.1.2	<i>Mundësitë lidhur me ngritjen e temperaturave</i>	<i>46</i>
6.4.1.3	<i>Risqet nga shtimi i reshjeve.....</i>	<i>46</i>
6.4.2	Infrastruktura.....	47
6.4.2.1	<i>Risqet dhe mundësitë për infrastrukturën nga temperaturat më të larta në verë</i>	<i>47</i>
6.4.2.2	<i>Mundësia lidhur me ngritjen e temperaturave në verë dhe dimër.....</i>	<i>47</i>
6.4.2.3	<i>Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve</i>	<i>47</i>
6.4.3	Biznesi (përfshirë turizmi, bujqësia dhe pylltaria)	49
6.4.3.1	<i>Risqet për biznesin nga temperaturat dhe reshjet e rritura dhe të ulëta</i>	<i>49</i>
6.4.3.2	<i>Mundësitë për biznes.....</i>	<i>51</i>
6.4.3.3	<i>Risqet dhe mundësitë për bujqësinë dhe turizmin.....</i>	<i>51</i>
6.4.3.4	<i>Industritë e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit</i>	<i>51</i>
6.4.3.5	<i>Gjetjet e turizmit.....</i>	<i>52</i>
6.4.4	Risqet për natyrën	52
6.4.4.1	<i>Risqet dhe mundësitë për speciet tokësore brenda Bashkisë Elbasan.....</i>	<i>52</i>
6.4.4.2	<i>Risqet dhe mundësitë për tokat dhe për speciet e ujërave të ëmbla.....</i>	<i>53</i>
6.4.4.3	<i>Risqet dhe mundësitë nga ndryshimi klimatik në karakteristikat e peizazhit</i>	<i>54</i>
6.4.5	Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.....	54
6.4.5.1	<i>Risqet për asetet në pronësi të bashkisë ose të mirëmbajtura nga Bashkia Elbasan</i>	<i>54</i>
6.5	PËRFUNDIMET.....	55
7	PLANI VENDOR I VEPRIMIT	57
7.1	QËLLIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT	57
7.1.1	<i>KONTEKSTI I KËTJU PLANI PËR BASHKINË ELBASAN</i>	<i>57</i>
7.2	PROCEDURA DHE KRITERET E PËRPARËSISË.....	58
7.3	QEVERISJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI	67
7.3.1	<i>Përfaqësimi</i>	<i>67</i>
7.3.2	<i>Zbatimi</i>	<i>67</i>
7.3.3	<i>Raportimi</i>	<i>67</i>
8	SHTOJCAT.....	68
SHTOJCA I:	QASJA E PALËVE TË INTERESUARA NË PËRGATITJEN E PLANIT VENDOR TË PËRSHTATJES TË ELBASANIT	68
SHTOJCA II:	PARASHIKIMET KLIMATIKE.....	70
SHTOJCA III:	INTEGRIMI I CENUESHMËRISË DHE VLERËSIMEVE TË RISKUT	71
SHTOJCA IV:	KRITERET E PIKËZIMIT TË RISKUT.....	73
SHTOJCA V:	LISTA E MASAVE PËRSHTATËSE TË PROPOZUARA	74
A.1	Qeverisja, Monitorimi dhe Vlerësimi.....	74
A.2	Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar.....	76
A.3	Infrastruktura.....	81
A.4	Biznesi dhe Industria.....	85
A.5	Mjedisi natyror.....	87
A.6	Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.....	91
SHTOJCA VII:	KRITERET ME PËRPARËSI.....	93

Lista e shkurtesave

ALFIS – Sistemi Informativ Pyjor i Shqipërisë
PNK – Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike
VKM - Vendimi i Këshillit të Ministrave
EMS – Sistemi i Menaxhimit të Energjisë
U&K - Ujitje dhe Kullim
PINS - Plan i Integruar Ndërsektorial
IDMIS – Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Ujitjes dhe Kullimit
IPA – Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit
NJQV – Njësitë e qeverisjes vendore
PPV - Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit
MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PM - Procesverbalet e mbledhjeve
MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
PKP - Plani Kombëtar i Përshtatjes
AKZM - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AREB - Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
ARZB - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
PBVEQ - Plani Bashkiak i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme
SECO – Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
SEMP – Projekti “Bashki me Energji Inteligjente”
PLUQ - Plani i Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme
TeR - Termat e Referencës
UNDP - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC - Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
UNITAR - Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Kërkime
BB - Banka Botërore

Lista e tabelave

Tabela 2.1 _ Nxënësit e regjistruar në nivelet arsimore në Bashkinë Elbasan	18
Tabela 2.3 _ Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Elbasan (2018 – 2022).....	19
Tabela 3.1 _Përmbledhje e Objektivave Strategjikë të PZHV-së së Elbasanit me rëndësi për sektorët me përparësi të PKP-së	24
Tabela 4.1 _Burimet njerëzore të përkushtuara që mbulojnë sektorët me përparësi të PKP-së në Bashkinë Elbasan	25
Tabela 4.2 _Burimet njerëzore të përkushtuara që mbulojnë funksionet mbështetëse të PNK-së në Bashkinë Elbasan.....	26
Tabela5. 1_ Luhatja e vlerave të temperaturave dhe reshjeve mesatare vjetore	29
Tabela 5.3 _ Qasja e vlerësimit të riskut	36
Tabela 5. 4_ Matrica e ndjeshmërisë së Shqipërisë.....	36
Tabela 5.5 _ Kapaciteti përshtatës i Shqipërisë	37
Tabela5. 6_ Matrica e cenueshmërive aktuale të Shqipërisë ndaj riskut.....	38
Tabela 6.1 _ Qasja ndaj grupimit sipas sektorëve.....	44
Tabela6. 2_ Vlerësimi Përfundimtar Sektorial për bashkitë	44
Tabela6. 3_ Përmbledhje e risqeve ndaj shëndetit dhe komuniteteve nga temperaturat e larta të verës dhe pikëzimi përkatës	45
Tabela6. 4_ Mundësitë e identifikuar që vijnë si pasojë e rritjes së temperaturave gjatë verës dhe dimrit	46
Tabela 6.5 _ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e reshjeve	46
Tabela 6.6 _ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e temperaturave	47
Tabela 6.7 _ Mundësitë e identifikuar për infrastrukturën	47
Tabela 6.8 _ Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve	48
Tabela 6.9 _ Risqet e identifikuar për biznesin nga temperaturat më të larta.....	49
Tabela 6.10 _ Mundësitë për biznes	51
Tabela 6.11 _ Risqet e identifikuar për speciet tokësore brenda Elbasanit dhe pikëzimi	52
Tabela 6.12 _ Mundësitë për speciet tokësore	53
Tabela 6.13 _ Risqet e identifikuar për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla	53
Tabela 6.14 _ Mundësitë për habitatet e ujërave të ëmbla	54
Tabela 6.15 _ Risqet nga ndryshimi klimatik në karakteristikat e peizazhit dhe pikëzimi.....	54
Tabela 6.16 _ Mundësitë për peizazh	54
Tabela 6.17 _ Risqet e identifikuar për asetet e bashkisë.	54
Tabela 7.1 _ Nivelet me përparësi të masave për përshtatje.....	62
Tabela 8.1 _ Rritja e parashikuar e temperaturës globale nën skenarë të ndryshëm.....	70
Tabela 8.2 _ Shkalla e ndjeshmërisë	71
Tabela 8.3 _ Kriteret e pikëzimit të riskut.....	73

Lista e figurave

Figura 2.1 _ Harta administrative e Bashkisë Elbasan	10
Figura 2.2 _ Prirjet e popullsisë sipas grupmohave në Bashkinë Elbasan (2018 – 2022).....	11
Figura 2.3 _ Menaxhimi i mbetjeve me tonelata në Bashkinë Elbasan (2013 – 2021).....	12
Figura 2.4 _ Prirjet e Prodhimit të Sektorit Ekonomik në Bashkinë Elbasan (2017-2021).....	14
Figura 2.5 _ Poli i zhvillimit rajonal – Elbasan	16
Figura 2.6 _ Ndotësit e ajrit në Bashkinë Elbasan (2014 – 2021).....	18
Figura 2.7 _ Konsumi i energjisë sipas sektorëve në Elbasan (Ktoe)	21
Figura 3.1 _ Poli i zhvillimit rajonal Elbasan – Librazhd	23
Figura 5.1 _ Shpërndarja e temperaturave mesatare vjetore	29
Figura . 2_ a) shpërndarja vjetore e Tmax mesatare vjetore; b) shpërndarja mujore e temperaturave mesatare vjetore.....	30
Figura5. 3_ Shpërndarja e reshjeve vjetore (1951 - 2010)	31
Figura 5. 4 _ Ndryshimi botëror i temperaturës së sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 - 1900. 31	
Figura5. 5_ Shpërndarja e ndryshimeve të Tmax gjatë verës deri në vitin 2050	32
Figura 5.6 _ Ndryshimet e mundshme në vlerat vjetore dhe verore të Tmax në Elbasan	33
Figura 5.7 _ Ndryshime të mundshme në reshjet vjetore dhe verore në Elbasan	34
Figura 5.8_ Metodologjia.....	35
Figura6. 1_ Grafiku që tregon panoramën e përgjithshme të metodologjisë.....	40
Figura 7.1 _ Masat e propozuara bioinxhinierike	61
Figura 8.1 _ Shkalla e ceneshmërisë	71

1 Hyrje

1.1 Rëndësia e ndryshimeve klimatike

Popullsia e Shqipërisë, e cila është kryesisht rurale, është shumë e ndjeshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ku reshjet ekstreme shpesh sjellin përmbytje shkatërrimtare, ndërsa jetesa e bazuar në bujqësi dhe disponueshmëria e ujit të pijshëm kërcënohen gjatë thatësirave. Me rritjen e temperaturave, skenarët klimatikë parashikojnë rritjen e seriozitetit dhe shpeshtisë së këtyre kushteve ekstreme të lagështirës dhe thatësirave, së bashku me pakësimin e reshjeve të përgjithshme vjetore. Këto ndryshime sjellin risk për popullsinë e Shqipërisë dhe kërcënojnë industrinë energjetike nga burimet hidrike dhe të turizmit.

Shqipëria është e ekspozuar ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve, shumica e të cilave (90%) janë përmbytje, vërshime dhe zjarre pyjore të shkaktuara kryesisht nga kushtet hidrologjike dhe meteorologjike. Për shkak të pozicionit të saj bregdetar, Shqipëria renditet ndër vende që përballen me risqe të mëdha klimatike.

Zhvillimi aktual socio-ekonomik e rrit edhe më shumë cenueshmërinë e vendit. Indeksi ND-GAIN për Vendet¹ për vitet 2020 dhe 2021 mati dimensionet e cenueshmërinë dhe gatishmërinë, në bazë të të cilave u renditën vendet në mbarë botën. Nga 182 vendet e vlerësuara në vitin 2021, Shqipëria u rendit e 80-ta për rezultatin e kombinuar ND-GAIN. Ajo u rendit në vendin e 78-të sa i përket cenueshmërisë dhe në vendin e 96-të sa i përket gatishmërisë.

Njohuritë për ndikimet dhe cenueshmëritë e ndryshimeve klimatike në Shqipëri vijnë si rezultat i punës në kuadër të Komunikimit Kombëtar të Parë (2002), të Dytë (2009), të Tretë (2016) dhe të Katërt (2022) në UNFCCC, dhe tregojnë se cenueshmëria e vendit mbetet mjaft e lartë. Me qëllim trajtimin e këtyre cenueshmërive, Qeveria e Shqipërisë nisi procesin e saj të dytë për planin kombëtar të përshtatjes (PKP) në vitin 2021 në sektorët me përparësi të turizmit, zhvillimit urban, bujqësisë, transportit dhe energjisë, dhe Planet e para Vendore të Përshtatjes (PVP) për tetë bashki: Vlorë, Fier, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Përmet, Kukës, Krujë.

PVP-të janë hartuar në bashkëpunim me personelin e bashkive, përmes ngritjes së bazës së fakteve për PNK-në, sigurimit të zhvillimit të kapaciteteve dhe hartimit të planit të bashkërenduar të veprimit për zvogëlimin e riskut dhe investime afatgjata lidhur me PNK-në në bashkitë përkatëse.

1.2 Funksionet e PVP-së

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes (PVP), ashtu si edhe procesi i Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) “shihet si mënyrë më e mirë për të punuar, duke marrë plotësisht në konsideratë problematikat e ndryshimeve klimatike gjatë proceseve të planifikimit dhe vendimmarrjes. Ai do të përfshijë të gjitha organizimet e nevojshme për zhvillimin e njohurive në mbështetje të vendimmarrjes, si dhe të kapaciteteve të nevojshme për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në kuadër të procesit strategjik të vendit për planifikimin e përshtatjes”.

UNFCCC-ja promovoi Planet Kombëtare të Përshtatjes (PKP) në nivel ndërkombëtar për t'i ndihmuar vendet të hartojnë, bashkërendojnë, zbatojnë dhe monitorojnë më mirë përpjekjet për trajtimin e risqeve klimatike. Elementi më i rëndësishëm është se procesi i PKP-së synon të ngrëjë sistemet dhe

¹ Indeksi ND-GAIN i Vendeve përmbledh cenueshmërinë e një vendi të caktuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe sfidave të tjera botërore kombinuar me gatishmërinë e tij për të përmirësuar aftësitë ripërtëritëse. Indeksi synon të ndihmojë qeveritë, bizneset dhe komunitetet t'i japin më shumë përparësi investimeve që i përgjigjen në mënyrë më efikase sfidave aktuale botërore. Renditja botërore sipas Indeksit ND-GAIN, sa më lart në renditje, aq më e mirë është situata.

kapacitetet e nevojshme për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin për zhvillim, vendimmarrje dhe buxhetim.

PVP-të hartohen në mënyrë që bashkia të mund ta monitorojë dhe rishikojë atë rregullisht, si dhe ta përditësojë herë pas here bazuar në të dhëna dhe parashikime të reja dhe/ose më cilësore klimatike, si dhe informacione të tjera të dobishme për procesin e planifikimit. PVP-ja duhet të identifikojë vazhdimisht mangësitë në kapacitete dhe përshtatje dhe të planifikojë trajtimin e tyre. Ai gjithashtu duhet të integrojë në proces pikëpamjen gjinore me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në proceset vendimmarrëse, si dhe në zbatimin e veprimtarive të përshtatjes. Për më tepër, duhet të sigurohet që procesi i PVP-së dhe veprimtaritë e tij të mos përkeqësojnë pabarazitë gjinore. Këto plane mund të rezultojnë në përshtatje më të mirë dhe komunitete me aftësi më të mira ripërtëritëse.

1.3 Kuadri politik dhe institucional për Planifikimin e Përshtatjes

Si Palë e UNFCCC-së, Shqipëria angazhohet ndaj Procesit të Planifikimit të PNK-së. Kjo është e qartë në Dokumentin Strategjik dhe Planet Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (si të Zbutjes ashtu edhe Përshtatjes) (2019), legjislationin për ndryshimet klimatike (2020), dokumentin e KKP-së (2021), NC-në e 4-t (2022), BUR-në e parë (2022) etj. si dhe një sërë marrëveshesh dhe angazhimesh ndërkombëtare ose rajonale.

Dokumentet e politikave që përcaktojnë përgjegjësi për qeverisjen kombëtare dhe vendore lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë dokumenti i Planit Kombëtar të Përshtatjes i Shqipërisë (PKP), i miratuar me VKM nr. 466, datë 03.07.2019 dhe Ligji nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”.

Në shtator të vitit 2021, Shqipëria i paraqiti PKP-në e vet të parë UNFCCC-së, përfshirë një strategji gjithëpërfshirëse financimi. Për shkak të mangësive financiare të pranura që prej nisjes së hartimit, PKP-ja e parë është zbatuar pjesërisht. Aktualisht, Shqipëria po përgatit PKP-në e dytë, nën bashkërendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me pjesëmarrjen e palëve të interesuara dhe kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK).

1.4 Përmbledhje e organizimit të PVP-së (përmbledhje e kapitujve)

PVP-ja e **Elbasanit** organizohet në gjashtë kapituj përveç kësaj hyrjeje. **Kapitulli 2 paraqet rrethanat vendore të Bashkisë Elbasan**, përfshirë pozitën gjeografike, sektorët ekonomikë me përparësi dhe situatën dhe dinamikën socio-ekonomike në territorin e saj.

Sistemi i qeverisjes së Bashkisë Elbasan dhe angazhimi i saj për përshtatje diskutohen në **Kapitullin 3**. Ndërkohë që në rang kombëtar mekanizmat janë disi më të zhvilluara, integrimi i problemeve të ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes në Bashkinë Elbasan, sipas detyrave që i ngarkohen qeverisjes vendore nga Ligji për Ndryshimet Klimatike, nuk është kryer për shkak të mungesës së njohurive, burimeve njerëzore, teknike dhe financiare.

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, përfshirë angazhimin e palëve të interesit trajtohet në **Kapitullin 4**. Në nivelin vendor nuk ka marrëveshje të rregullta institucionale, mekanizma bashkërendimi, procedura konsultimi me palët e interesit.

Kapitulli 5 trajton informacionin mbi ndryshimet klimatike. Ai nis me përkufizimin e termave të përdorur në plan dhe vijon me rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe informacionit për vlerësimin e cenueshmërive klimatike. Ai siguron informacion mbi variablat e shumta të klimës, si ato do të ndryshojnë gjatë shekullit, variacionin e mundshëm në këto ndryshime në skenarët e ndryshëm të klimës dhe se si këto ndryshime mund të dallojnë.

Ndikimet e mundshme sektoriale të ndryshimeve klimatike në Bashkinë Elbasan diskutohen në **Kapitullin 6.**

Kapitulli 7 trajton Planin Vendor të Veprimit për Elbasanin, të hartuar bazuar në vlerësimin e riskut dhe cenueshmërisë klimatike të Elbasanit dhe identifikimin e masave të dhënies së përparësisë dhe të përshtatjes.

2 Rrethanat vendore

2.1 Tiparet gjeografike

Bashkia Elbasan ndodhet në Shqipërinë qendrore dhe është qyteti i tretë më i madh i vendit. Kjo bashki ka një pozicion shumë strategjik, pasi përshkohet nga rrugë të rëndësishme kombëtare. Për shkak të vendndodhjes strategjike, bashkia ka pasur banorë që në kohërat e lashta dhe ka qenë vendndodhje e rëndësishme për rrugën tregtare Egnatia. Bashkia është lehtësisht e aksesueshme për shkak të distancave të shkurtra nga infrastrukturat kryesore (aeroporti, porti dhe pika kufitare). Bashkia shtrihet në një territor të gjerë kodrinoro-fushor që ofron relieve dhe peizazhe të ndryshme. Territori përshkohet nga shumë lumenj si: Shkumbini, Manazdere, Papër, Gostrima dhe Zaranika. Qyteti i Elbasanit dhe zona industriale (ish-zona metalurgjike) shtrihen përgjatë luginës së Shkumbinit. Bashkia Elbasan përfshin edhe zona të ndryshme të mbrojtura si Sopot, Stravja dhe Kuturmani, siç tregohen në Figurën 2.1 më poshtë.

Figura 2.1 _ Harta administrative e Bashkisë Elbasan




Burimi: Përgatitur për këtë raport nga A. Zotaj

2.1.1 Tiparet vendore

Analiza e të dhënave demografike të Bashkisë Elbasan (që ndërthur të dhënat e INSTAT-it, bashkisë dhe prefekturës²) tregon rënie të ndjeshme të popullsisë së grupmoshave më të reja, veçanërisht atyre nën 10 vjeç (Figura 2.2), gjatë viteve të fundit (periudha 2018 – 2022). Kjo prirje mund të tregojë ulje të numrit të lindjeve ose ndryshim të mundshëm të preferencave të popullsisë për planifikim familjar.

Nga ana tjetër, vihet re qëndrueshmëri te grupet në moshë pune (20-59), që mund të tregojë fuqi punëtore relativisht të qëndrueshme. Të dhënat zbulojnë edhe një prirje në rritje të moshës 65 vjeçare e lart, duke identifikuar kështu një popullsi në plakje. Kjo mund të tregojë jetëgjatësi për moshat mbi 70 vjeç. Në grupmosha të caktuara, ka dallime të dukshme midis popullsisë së meshkujve dhe femrave. Për shembull, popullsia e femrave në grupmoshën 55-59 vjeç është pak më e lartë se ajo e meshkujve, të cilat mund të tregojë prirjen e migrimit në rajon.

Figura 2.2 _ Prirjet e popullsisë sipas grupmoshave në Bashkinë Elbasan (2018 – 2022)



Burimi: INSTAT (2018 – 2022), Të dhënat e Bashkisë dhe Prefekturës Elbasan, përlogaritjet e autorit

Ndërsa Bashkia Elbasan planifikon të ardhmen, marrja në konsideratë e ndryshimeve demografike do të jetë thelbësore. Për shembull, rënia e popullsisë në moshë të re mund të sjellë reduktim të fuqisë

² Të dhënat e bashkisë janë të disponueshme në <https://elbasani.gov.al/levizja-demografike/> dhe të dhënat e prefekturës në: <https://qarkuelbasan.gov.al/bashkite-e-qarkut/>

punëtore në të ardhmen dhe nevojën për politika që nxisin rritjen e numrit të lindjeve ose kundërpeshojnë ndikimin e një popullsie në plakje. Qëndrueshmëria e grupit në moshë pune tregon dividendin demografik që mund të shkaktojë rritje ekonomike në Bashkinë Elbasan.

2.1.2 Zonat urbane


Pas viteve '90, prirjet e zhvillimit ndryshuan shumë në Bashkinë Elbasan. Lëvizja e lirë e njerëzve shkaktoi migrim të brendshëm nga qendrat rurale në ato urbane, të cilat sollën zgjerimin e qyteteve dhe rritjen e sipërfaqes së ndërtuar shpesh te tokat bujqësore, si rrjedhojë edhe krijimin e zonave informale. Problemi madhor në këto zona ishte mungesa e infrastrukturës publike.³ Pas viteve '90, për shkak të planifikimit urban të pazbatuar plotësisht, shumë prej banesave të sapondërtuara ndodheshin në zona të pandërtueshme, pra ku kishte rrëshqitje dhe materiale të cilësisë së dobët.⁴

Qyteti dhe zona industriale (ish-zona metalurgjike që ndodhet pranë qytetit) shtrihen përgjatë luginës së Shkumbinit. Përpara viteve 90-të, Elbasani identifikohet si qytet industrial ku u ndërtuan uzina metalurgjike, fabrika e përpunimit të drurit, uzina e ferro-kromit dhe fabrika e çimentos. Këto industri ndikuan te cilësia e ajrit, tokës dhe ujit të bashkisë. Pas viteve 90, këto industri u mbyllën dhe zona përdoret nga kompani private të industrive të rënda si Albchrome, Kurum, R.B.H Beline, Albtek Energy, etj. Megjithatë, Elbasani është një nga qytetet më ndotje të lartë të ajrit në Shqipëri për shkak të ndikimit të ish-industrive të rënda dhe mbetjeve të tyre të ngurta, të cilat janë ende të pranishme, si dhe për shkak të ndikimit të industrive aktuale.

Qasja dhe lidhja e bashkisë me kryeqytetin, aeroportin ndërkombëtar dhe portin e Durrësit është përmirësuar ndjeshëm. Investimet në **infrastrukturën rrugore**, veçanërisht në autostradën “Elbasan – Tiranë” (A3), kanë shkurtuar kohën e udhëtimit drejt këtyre infrastrukturave kyçe si për banorët ashtu edhe për bizneset. Megjithatë, rrugët rurale dhe terrenet e largëta malore kanë ende nevojë për investime.

Nga viti 2013 deri në vitin 2021, ka rënie të dukshme të **mbetjeve** totale **urbane** të menaxhuara për banor. Përbërja e mbetjeve tregon prirje të qëndrueshme të mbetjeve organike dhe tekstile, ndërsa kategoritë si: mbetje plastike dhe inerte kanë pësuar luhatje.

Figura 2.3 _ Menaxhimi i mbetjeve me tonelata në Bashkinë Elbasan (2013 – 2021)



Burimi: Bashkia Elbasan

2.1.3 Tiparet ekologjike

Territori i Bashkisë Elbasan ndodhet në pjesën e mesme të basenit lumor të Shkumbinit, ku gjenden habitate të ndryshme natyrore nga liqenet dhe përrenjtë malorë deri te lumaret dhe habitatet e lumenjve. Krahas lumit Shkumbin, bashkia përshkohet nga **degë** të shumta që e furnizojnë, si lumenjtë

³ Bashkia Elbasan PZHV, Strategjia e Territorit (2016), fq.17

⁴ Procesverbalet e Mbledhjeve me Bashkinë Elbasan, 9 shtator 2022

Gostrimë, Zaranikë, Kushe dhe Zalli i Papërit. Pjesa më e madhe e këtyre lumenjve derdhen shumë pranë qytetit të Elbasanit, ku kryesori është lumi i Zaranikës, i cili kalon në qytetin e Elbasanit.⁵

Në territorin e Bashkisë Elbasan ndodhen pjesë të **rezervateve natyrore të menaxhuara të Qafë Bushit, Sopotit dhe Kuturmanit**. Ato kanë vlera për biodiversitetin pasi përfaqësojnë pyjet e dushkut dhe përbëjnë biokorridorin më të rëndësishëm për vertebrorët e mëdhenj si ariu, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, etj. Asnjë nga këto tre zona rezervash natyrore nuk kanë një plan menaxhimi.⁶

Bashkia Elbasan është e pasur me **monumente natyrore** në formën e hidro-, bio- dhe gjeomumenteve. Pjesë e hidromumenteve janë *liqeni i Seferanit* (liqeni karstik në Dumre), *liqeni i Degës* (liqeni karstik në zonën e Dumresë), *burimet termale të Hibratit*, *burimi i përroit Kushe*. Biomonumentet përfshijnë shfaqje të rralla të biodiversitetit dhe gjeomumentet janë karste nëntokësore në formën e puseve dhe shpellave, të cilat përfshijnë *Hinkën e Kosovës*, *Malin e Gradishtës* dhe *shpellën e Gracenit*.⁷

Në këtë bashki ndodhen **pyjet** më të larta, të cilat gjenden pothuajse në të gjitha njësitë administrative. Pas viteve 90, peizazhi pyjor është degraduar për shkak të veprimtarive njerëzore dhe zjarreve në pyje. Bashkia Elbasan po përpiqet ta trajtojë këtë problem përmes disa nismave, sikurse mbjellja e 25,000 fidanëve (në 54,000 ha sipërfaqe) të kodrat afër Krastës, me pamje nga qyteti i Elbasanit.⁸ Madje, është planifikuar restaurimi i peizazhit pyjor, që përfshin mbjelljen e pemëve, krijimin e brezave me bimësi barishtore dhe mbjelljen e menjëhershme të barit në nëntë zona shumë të gërryera (që mbulojnë 8.2 ha), së bashku me ndërtimin e digave të kontrollit të gabionit dhe shkarpace për restaurimin e përrorskave në degën ujëmbledhëse të Gurrës.⁹

2.2 Ekonomia dhe trajektorja ekonomike

Në përgjithësi, në Bashkinë Elbasan veprimtaria ekonomike zhvillohet pranë qytetit të Elbasanit, ndërsa në njësitë e tij administrative zhvillohet pranë terrenin fushor të bashkisë. Vetëm 4% e të gjitha ndërmarrjeve aktive të vendit janë me seli në Bashkinë Elbasan. Që nga viti 2022, struktura e ndërmarrjeve mbizotërohet nga ndërmarrje shumë të vogla, me 1 deri 4 punonjës, të cilat përbëjnë më shumë se 87% të të gjitha ndërmarrjeve aktive.¹⁰

2.2.1 Bazat e ekonomisë

Përpara viteve 90, në qytetin e Elbasanit veprimtaritë kryesore ekonomike ishin të orientuara drejt industrisë së rëndë (Uzina Metalurgjike, Fabrika e Përpunimit të Drurit, etj.). Kjo prirje ndryshoi pas shfaqjes së sektorit të shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.¹¹ Kjo prirje vazhdon, pasi ekonomia vendase bazohet te tregtia me pakicë. 86% e ndërmarrjeve aktive janë ofrues shërbimesh, ndërsa pjesa tjetër (14%) janë prodhues mallrash.¹²

Gjatë periudhës 2018 — 2022, numri i ndërmarrjeve aktive në Bashkinë Elbasan ka qenë i qëndrueshëm me një rritje të lehtë në vitin 2022 (4,681 ndërmarrje gjithsej). Që prej vitit 2022, sa i përket pronësisë ndërmarrjet aktive janë 98% shqiptare dhe vetëm 2% e tyre financohen me kapitali të huaj dhe/ose

⁵ Bashkia Elbasan PZHV (2016), fq. 20

⁶ Elbasan PPV (2016), fq. 17

⁷ Tavanxhi V. "Vlerat dhe problemet e trashëgimisë natyrore të qarkut të Elbasanit" (2014) të disponueshme në https://www.researchgate.net/publication/271105396_The_Values_and_the_Problems_of_the_Natural_Heritage_of_the_Region_of_Elbasan

⁸ Po aty

⁹ https://www.iucn.org/sites/default/files/2023-12/nbs-compendium-western-balkans_finalo.pdf

¹⁰ INSTAT, Regjistri i Biznesit 2018-2022 i disponueshëm në: <https://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-p%C3%ABrgjithshme-dhe-rajonale/tr-egues-sipas-bashkive/#tab2>

¹¹ Elbasan PPV (2016), fq. 17

¹² INSTAT, numri i ndërmarrjeve aktive (përfshihen fermerët)

kapital të përbashkët.¹³

Në Bashkinë Elbasan, për shkak të industrisë të rëndë janë vendosur operatorë të mëdhenj industrialë si “Kurum Steel”, “ECF Cement Factory”, Uzina e Karbonit, Fabrika e Tullave, Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës, Uzina e Shkrires së Ferro-kromit, Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera. Veprimtaritë e tyre kanë ndikime serioze në mjedis.

Bujqësia dhe gjëja e gjallë mbeten veprimtari të rëndësishme ekonomike në zonat rurale. Për fat të keq, në nivel vendor nuk ka të dhëna të kategorizuara për këto veprimtari ekonomike.

2.2.2 Treguesit ekonomikë

Gjatë viteve 2017-2021, qarku i Elbasanit ka kontribuar vazhdimisht me rreth 6,7% - 6,8% të PBB-ja kombëtare. Analizimi i të dhënave të PBB-së për bashkinë Elbasan, bazuar në përqendrimin e popullsisë brenda qarkut, tregon një kontribut të qëndrueshëm të Bashkisë Elbasan me rreth 49% të PBB-ja e prefekturës.

Sektori i bujqësisë ka pasur vazhdimisht përqindjen më të lartë të PBB-së midis sektorëve të listuar, duke filluar nga 38.92% deri në 39.7%. Të dhënat tregojnë rritje të vazhdueshme të sasisë së prodhimit në sektorin e bujqësisë nga viti 2017 në 2021, duke arritur kulmin me 195 milionë dollarë në vitin 2021, duke përlogaritur kështu rritje të mëtejshme në 2022. Edhe numri i kompanive në këtë sektor është rritur, duke treguar një industri bujqësore në lulëzim.


Sektorët e industrisë dhe turizmit vërejtën rritje të kontributeve të tyre ndër vite, me industrinë që tejkaloi 19% në vitin 2021 dhe turizmin që arriti në 4.09%. Në veçanti, sektori industrial tregon një prirje në rritje të sasisë së prodhimit, edhe pse numri i kompanive mbeti relativisht i qëndrueshëm deri në vitin 2021, me një ulje të lehtë të parashikuar në vitin 2022. Kjo mund të tregojë konsolidimin ose përshkallëzimin e aktiviteteve industriale. Në vitin 2021, shumica e të ardhurave nga industria kapi vlerën 97 milionë dollarë. Ndërsa, **në vitin 2020** pati rënie të të ardhurave në **sektorin e turizmit (17 milionë dollarë krahasuar me 19 milionë dollarë në 2019)**, të cilat mund të lidhet me ndikimin global të pandemisë Covid-19 në turizëm. Megjithatë, shumica parashikohet të rikuperohet dhe të rritet në vitin 2021 dhe 2022.

Sektorët e energjisë/transportit dhe të shërbimeve patën PBB-në të qëndrueshme përgjatë viteve, përkatësisht 8% dhe 30%. Edhe pse sektori i energjisë ka pasur rritje të sasisë së prodhimit, numri i kompanive të energjisë dhe transportit ka rënë që nga viti 2020, të cilat mund të tregojnë rritje të efikasitetit apo dominim të tregut nga më pak subjekte. Ndër të gjithë sektorët, sektori i shërbimeve ka sasinë më të madhe të prodhimit (141 milionë dollarë në 2021), që është e rëndësishme për ekonominë e Elbasanit. Numri i kompanive të shërbimit ka ardhur vazhdimisht në rritje, me një rënie të lehtë të parashikuar në vitin 2022.

Sektorët e tjerë patën luhajtje të vogla në kontributet e tyre, të cilat ishin më të vogla në krahasim me sektorët kryesorë.

Figura 2.4 _ Prirjet e Prodhimit të Sektorit Ekonomik në Bashkinë Elbasan (2017-2021)

¹³ Po aty



Burimi: INSTAT (2017 – 2022), përlogaritjet e autorit

2.2.3 Trajektorja për të ardhmen dhe përparësitë e zhvillimit ekonomik të bashkisë

Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit Vendor (PZHV) për Bashkinë Elbasan është dokumenti kryesor i politikave sa i përket objektivit të këtij studimi, dhe ky dokument identifikon përparësitë kryesore të zhvillimit ekonomik. Dokumenti është miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 29.12.2016.

Katër nga pesë objektivat strategjike të PZHV-së së Elbasanit identifikojnë ndërhyrjet me rëndësi për fushat me përparësi të PKP-së, përkatësisht ato të planifikimit urban, transportit, turizmit dhe bujqësisë. Më konkretisht:

- sipas **Objektivit Strategjik nr. 1** “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, ruajtja e ekuilibrit midis sektorëve të ndryshëm ekonomik në territor dhe rritja e konkurrencës dhe diversitetit midis sektorëve aktivë të rajonit për të hapur vazhdimisht vende pune” janë identifikuar me përparësi ndërhyrjet te: infrastruktura e energjisë së rinovueshme për bizneset në ish-zona industriale (O1P1), rigjenerimi i hapësirës publike nëpërmjet menaxhimit të tokës së ish-zonave industriale/ekonomike të Elbasanit (O1P2), rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike (O1P5);
- sipas **Objektivit Strategjik nr. 2** “Mbrojtja dhe rigjenerimi i burimeve natyrore si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe rinovimit ekonomik nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor”, ndërhyrjet trajtojnë: rehabilitimin e argjinaturave ekzistuese për mbrojtjen e sistemit urban nga përmbytjet (O2P1), rehabilitimin e shtretërve të lumenjve, brigjeve të lumenjve dhe zonave ripariane (O2P2), hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave vendore (O2P4), hartimin dhe zbatimin e planit sektorial për turizmin në nivel bashkiak (O2P7);
- sipas **Objektivit Strategjik nr. 3** “Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes për të mbështetur lëvizshmërinë efektive, ndërlidhjen më të mirë dhe reduktimin e bllokimeve të trafikut në Bashkinë Elbasan”, ndërhyrjet trajtojnë: përforcimin e lidhjeve midis qendrave kryesore urbane me qytetin e Elbasanit (O3P1), përforcimin e bajpasit të Elbasanit për të reduktuar trafikun ndërqytetës (O3P2), përmirësimin e transportit publik ndërqytetës, transportit të ndryshëm dhe transportit të mallrave (O3P5), përmirësimin e transportit publik ndërqytetës përmes ndërhyrjeve të itinerareve për stacionet e autobusëve/furgonave përgjatë rrugëve lidhëse (O3P6), rregullimin e trafikut të qytetit duke rehabilituar rrethrotullimet/kryqëzimet kryesore në qytet (O3P7), promovimin e investimeve publike dhe private në fushën e lëvizshmërisë së gjelbër (Green Mobility) për këmbësorët dhe biçikletat, rrugët natyrore dhe rekreative (O3P8);
- sipas **Objektivit Strategjik nr. 4** “Promovimi i sektorit të bujqësisë dhe gjëja e gjallë, si sektorë kyç për zhvillimin e ekonomisë vendase dhe rritjen e punësimit, si dhe për përforcimin e zhvillimit rural” ndërhyrjet trajtojnë: rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kullimit dhe ujitjes (O4P1), programimin dhe hartimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për të udhëhequr zhvillimet

urbane që të mbrojnë tokën bujqësore (O4P2).¹⁴

Dokumenti i PZHV-së së Elbasanit njih ndryshimet klimatike si faktorë të rëndësishëm për pengimin e zhvillimit ekonomik të bashkisë. Dokumenti trajton ndikimin që pritet të kenë ndryshimet klimatike të i) bujqësia, për shkak të reshjeve të shpeshta dhe të dendura, valëve të të nxehtit, rritjes së organizmave të dëmshëm të korrat bujqësore, etj; ii) burimet ujore, për shkak të temperaturës që do të ndikojë në disponueshmërinë e ujit, të cilat do të duhet të plotësojnë nevojat gjatë gjithë vitit për bujqësi dhe energji, si dhe më shumë përmbytje në zonat e Zaranikës, Manazderes dhe në zonat ku bashkohen me lumin Shkumbin dhe iii) turizmi.¹⁵

Dokumenti strategjik identifikon edhe një numër dokumentesh strategjike që do të krijohen, përfshirë Planin Afatmesëm të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Planin Sektorial të Turizmit dhe Instrumentet e Menaxhimit të Tokës për periudhën 2015-2030. Plane të tilla nuk janë përgatitur ende.

Bashkia ka përgatitur **Planin e Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme (PLUQ)** për të trajtuar lëvizshmërinë e transportit. Dokumenti pritet të miratohet nga Këshilli Bashkiak. **Planit** i parë i **Veprimet** të Bashkisë **për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (PVEQK)** është duke u përgatitur.¹⁶

Vendndodhja strategjike e Bashkisë Elbasan dhe afërsia e saj me Tiranën nënkupton se bashkëpunimi me polin rajonal të zhvillimit Tiranë – Durrës është thelbësor. Nga ana tjetër, përfundimi i aksit qendror, i cili do të lidhë Elbasanin me Beratin dhe më tej me Gjirokastrën, do të rrisë mundësinë e shoqërimit dhe vlerësimit të potencialeve të reja të bashkëpunimit mes këtyre dy qendrave, duke i konsideruar qendrat si Elbasani, Korça dhe Berati si një pol ekonomik. Ky bashkëpunim do të forcohet edhe nga lidhjet e reja të propozuara për Korçën me Beratin. Projektet strategjike ndërrajonale dhe rajonale, në lidhje me sektorët e PKP-së, të propozuara nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar¹⁷ janë si më poshtë:

- Vlerësimi i potencialit natyror për sa i përket diversifikimit të energjive alternative;
- Vlerësimi i mundësisë për krijimin e parqe fotovoltaike duke shfrytëzuar 2500 orë diell në vit;
- Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor, pjesë e Korridorit VIII, për lidhje të qëndrueshme që mbështet zhvillimin e tregtisë dhe transportin e qëndrueshëm të mallrave nga Deti i Zi në portin e Durrësit;
- Rijetësimi i rrugës antike “Via Egnatia” (rruga Egnatia) për nxitjen e turizmit, duke mbështetur dhe nxjerrë në pah vlerat, traditat dhe historinë e vendit;
- Mbështetja për promovimin e turizmit elitari në zonat termale dhe turizmit malor në atraksione turistike si Gjinari, etj.


Figura 2.5 _ Poli i zhvillimit rajonal – Elbasan

¹⁴ Bashkia Elbasan PZHV (2016), fq. 355 – 359

¹⁵ Bashkia Elbasan PZHV (2016), fq. 147 – 153

¹⁶ Me mbështetjen e "Tranzicionit të Energjisë EU4: Konventa e Kryetarëve të Bashkive (KKB) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", veprimtaria me shumë donatorë, e bashkëfinancuar nga BE-ja dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, dhe e zbatuar nga Fondi i Hapur Rajonal GIZ për EIL – Energjia, Transporti dhe Mbrojtja e Klimës; në zbatim në (mars 2021 deri në shkurt 2025)

¹⁷ <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6005&token=4545cf3808648a678e1a9c3ca8042a712a56493f>



Burimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, 2030

2.3 Kushtet socio-ekonomike

Matja e fundit e pabarazisë rajonale në Shqipëri është kryer në vitin 2012. Këto të dhëna tregojnë se qarku i Elbasanit konsiderohet si një nga qarqet me shkallën më të ulët të varfërisë në vend.¹⁸

2.3.1 Varfëria

0.3% e popullsisë janë përfytyes të shërbimeve sociale, të cilat ndodhen dhe ofrohen kryesisht në Bashkinë Elbasan. 2.7% e popullsisë janë përfytyes të ndihmës ekonomike, ndërsa numri i përfytyesve me aftësi të kufizuara është 5527.¹⁹ Qarku i Elbasanit renditet ndër qarqet me shkallën më të ulët të papunësisë, me shkallën më të lartë të punësimit në bujqësi (67.2%) dhe njëkohësisht me shkallën më të ulët të shërbimeve (23.4%).²⁰

2.3.2 Treguesit shëndetësorë

Në Bashkinë Elbasan, kujdesi shëndetësor parësor ofrohet në nivel bashkiak, ndërsa kujdesi shëndetësor dytësor ofrohet në qendrën më të madhe urbane në qytetin e Elbasanit, pas rajonalizimit të shërbimeve shëndetësore spitalore. Në përgjithësi, shifrat e objekteve ekzistuese të kujdesit shëndetësor përfshijnë një spital rajonal, një spital psikiatrik kombëtar, 53 qendra shëndetësore dhe 81 ambulanca.²¹

Sikurse u diskutua në seksionet 2.1.2 dhe seksionin 2.2.1, Elbasani është një qytet industrial, ku cilësia e ajrit është problem për shkak të pranisë së industrisë metalurgjike. Këto industri, të cilët kanë instalime të vjetruara, janë ende në gjendje pune dhe nuk monitorohen siç duhet. Kjo do të thotë se ka shumë emetim të gazrave të dëmshëm që shkaktojnë probleme shëndetësore në frymëmarrje dhe në gjak, si dhe në sëmundjet e profesionit. Në Elbasan, rritja e përmbytjeve, prania e pikave të prodhimit të metalurgjisë rrisin riskun e ndotjes së ujit të mbartur në rrjedhën e poshtme nga ujërat e përmbytjeve

¹⁸ Elbasan PZHV (2016), fq. 62

¹⁹ <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2016/11/Bashkia-Elbasan.pdf>


²⁰ Dokument veprimi për: Programi Bashkëpunimit Ndërkufitar Maqedonia e Veriut – Shqipëri për 2021-2027 (2020), fq. 14 i disponueshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu>

²¹ <https://www.fsdksh.com.al/qendrat-shendetesore>

dhe riskun e kontaminimit të burimeve ujore, të cilat ndikojnë te shëndeti i popullsisë.²²

Në Elbasan, të dhënat për cilësinë e ajrit tregojnë një prirje dukshëm në ulje të tejkalimeve për PM10 nga 58 ndodhi në vitin 2014, në 29 ndodhi në 2021 (gjatë periudhës 2012-2021), që mund të jetë përmirësim i mundshëm i përqendrimeve të grimcave ndër vite. Sipas të dhënave të NO₂, tejkalimet janë ulur nga 35 në vitin 2014 në 50.5 në vitin 2021, pavarësisht rritjes në vitin 2019. Këto të dhëna janë thelbësore për vlerësimin e efektshmërisë së politikave mjedisore dhe të shëndetit të popullsisë.

Figura 2.6 _ Ndotësit e ajrit në Bashkinë Elbasan (2014 – 2021)



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

2.3.3 Treguesit arsimorë

Bashkia Elbasan ka 87 kopshte, 127 institucione arsimore bazë dhe 23 shkolla të mesme.²³ Institucionet e arsimit bazë janë të pranishme në të gjitha njësitë administrative. Vetëm në katër njësi administrative nuk ka shkolla të mesme. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin bazë (fillor dhe i mesëm i ulët) është 13,411, prej të cilëve 49% janë femra.²⁴

Tabela 2.1 _ Nxënësit e regjistruar në nivelet arsimore në Bashkinë Elbasan

Niveli arsimor	Regjistruar 2017-2018	Regjistruar 2018-2019	Regjistruar 2019-2020	Regjistruar 2020-2021	Regjistruar 2021-2022
Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët (arsimi 9-vjeçar)	19,745	18,918	14,148	13,821	13,411
Arsimi i mesëm i lartë (i përgjithshëm)	5,955	5,657	4,325	4,274	4,223
Shkolla e mesme (profesionale)	464	373	320	278	233
Studime universitare	11,748	11,420	9,448	8,490	8,774

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve

Bashkia Elbasan ka dy shkolla të arsimit të mesëm profesional/me drejtim të orientuar. Të dhënat tregojnë se ky lloj arsimit nuk është ende tërheqës për të rinjtë, pasi numri i regjistrimeve bie vazhdimisht. Prirja në rënie e numrit të regjistrimeve është e pranishme te të gjitha nivelet arsimore (Tabela 2.1).

²² ADAPT: Zgjidhje të bazuara në natyrë për përshtatjen e shoqërive në Ballkanin Perëndimor, në basenin lumor të Shkumbin, në Bashkinë Elbasan, në Shqipëri, i disponueshëm në: https://www.iucn.org/sites/default/files/2023-03/nature-based-solutions-for-climate_elbasan_albania.pdf

²³ Elbasan PPV (2016), fq. 58

²⁴ Ministria e Arsimit dhe Sportit, Vjetari Statistikor për Arsimin dhe Sportin (2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023) i disponueshëm në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Vjetari-Statistikor-per-Arsimin-dhe-Sportin-2021-2022-Final-Shqip.pdf>

2.4 Profilet e sektorëve me përparësi

Në përputhje me procesin e PKP-së, sektorët me përparësi në nivel vendor janë bujqësia, planifikimi urban, turizmi, energjia dhe transporti.

2.4.1 Bujqësia

Bashkia Elbasan nuk ka **sipërfaqe** të mëdha **bujqësore** për t'u përdorur për kultivim. Megjithatë, bashkia ka shumëllojshmëri tokash në territorin e saj (fushor, kodrinor dhe malor), të cilat përdoren për prodhimin e kulturave të ndryshme dhe shumimin e gjësë së gjallë. Për sa i përket kulturave bujqësore, mbjellja e grurit ka pësuar rënie drastike prej vitesh (-48%).²⁵

Toka bujqësore po ndikohet nga ndryshimi i kushteve klimatike. Zona është e ndjeshme ndaj përmbytjeve dhe erozionit të tokës, për shkak të degradimit të pyjeve në rrjedhën e sipërme dhe rënies së shpeshtë të reshjeve ekstreme.²⁶ Rritja e reshjeve me intensitet të lartë brenda një periudhe të shkurtër kohore ka shkaktuar erozion të madh të zonave kodrinore dhe malore. Reshjet e shumta sjellin dhe bartin materiale të ngurta te toka bujqësore; d.m.th. në fshatin Shushicë, përrrenjtë malorë degën ujëmbledhëse të Gurrës bartin zhavorr dhe fundërresë në rrjedhën e poshtme, duke dëmtuar shumë strukturën e tokës. Çdo 3 vjet, rreth 4,000 m² tokë bujqësore (kategoria e parë) dëmtohet për shkak të rrëshqitjes së lumit, kryesisht në fshatrat Papër dhe Bradadesh pranë të cilëve rrjedh lumi Shkumbin.²⁷ Edhe mungesa e mirëmbajtjes së argjinaturave malore i ka dëmtuar tokat bujqësore.

Në Bashkinë Elbasan ka sipërfaqe të konsiderueshme të dedikuara **pemëve** frutore **dhe vreshtave**. Por, ndryshimet në temperaturë kanë ndikuar edhe në strukturën e të korrave. Në zonat malore po mbillen agrume dhe ullinj, si psh.: ullinj të po mbillen në Gjinar, ndërsa agrumet në Zavalinë, të dyja zona malore të Bashkisë Elbasan.²⁸ Të dhënat mbi **efikasitetin e kanaleve të ujitjes dhe kullimit** tregojnë se vetëm 54% (2018) e sipërfaqes së tokës së kultivuar ka qasje në sistemin e ujitjes. Sistemi i ujitjes mbështetet nga 22 rezervuarë artificialë, të ndërtuar para viteve '90 dhe të mbushura me ujërat e shiut. 20% janë humbjet e vlerësuara të ujit nga sistemi i ujitjes.²⁹ Një çështje tjetër që lidhet me ujitjen është uji i kontaminuar nga aktiviteti metalurgjik, si dhe ujërat e ndotura (përfshirë ujërat urbane), të cilat prekin tokat bujqësore në pjesën jugore dhe perëndimore të bashkisë.³⁰

Tabela 2.2 _ Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Elbasan (2018 – 2022)

Bashkia	2018	2019	2020	2021	2022
Gjatësia e sistemit të ujitjes (në km)	638	631	522	522	606.1
Sipërfaqja bujqësore e mbuluar me ujitje (në ha)	4,863	4,745.3	4,499.3	4,649.3	4,665
Gjatësia e sistemit të kullimit (në km)	439	441	415	415	406.1
Sipërfaqja bujqësore e mbuluar nga kullimi (në ha)	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Burimi: Bashkia Elbasan

Sa i përket **gjësë së gjallë**, të dhënat tregojnë rënie të përgjithshme të numrit të bagëtive dhe rënie të madhe të lopëve (në periudhën 2018-2022). Gjëja e gjallë për vitin 2022 përbëhet nga: lopë 7,070; dhi

²⁵ Procesverbalet e Mbledhjeve (PM) me Bashkinë Elbasan, 9 shtator 2022

²⁶ ADAPT: Zgjidhje të bazuara në natyrë për përshtatjen e shoqërive në Ballkanin Perëndimor, në basenin lumor të Shkumbin, në Bashkinë Elbasan, në Shqipëri

²⁷ Procesverbalet e Mbledhjeve me Bashkinë Elbasan, 9 shtator 2022

²⁸ Procesverbalet e Mbledhjeve me Bashkinë Elbasan, 9 shtator 2022

²⁹ Baza e të dhënave të Bashkisë Elbasan

³⁰ Procesverbalet e Mbledhjeve me Bashkinë Elbasan, 9 shtator 2022

27.273; dele 19.980 (qumështi 9.635); dhi 25.638 (qumështi 15.258); njëthundrakë 2,511; shpendë 212,279; koshere bletësh 10188.

2.4.2 Zhvillimi Urban

Sipas informacionit në Planin e Përgjithshëm Vendor, ka pasur **rritje** të konsiderueshme të **përdorimit të tokës për banim** në zona të caktuara të Bashkisë Elbasan, si Labinot-Mal në periudhën 2017-2023, të cilat mund të tregojë zgjerim urban apo pika të reja zhvillimi të projekteve ndërtimore.

Përdorimi i tokës tregtare duket i qëndrueshëm në zonat ku është raportuar. Të dhënat **për përdorimin e tokës industriale** mungojnë, por ka shënime vetëm për përdorimin e tokës industriale në vitet 2022/2023, kryesisht në Labinot-Fushë dhe Labinot-Mal, të cilat tregojnë aktivitete industriale në këto zona.

Në disa njësi administrative, ka pasur rritje të dukshme të **përdorimit të tokës bujqësore**, si në Labinot-Mal ashtu edhe në Papër (periudha 2017-2023). Kjo prirje mund të reflektojë investim ose zhvendosje drejt aktiviteteve bujqësore.

Edhe zhvillimi urban është i lidhur me **modelet e banesave**. Njësitë e banesave janë rritur dukshëm në shumicën e zonave administrative, duke treguar rritje të qëndrueshme të popullsisë ose zgjerim të banesave. Bradasheshi, Shushica dhe Shirgjani kanë pasur rritje çdo vit, e cila mund të tregojë kërkesë të qëndrueshme ose në rritje për banim në këto zona.

2.4.3 Turizmi

Turizmi mbetet një potencial ekonomik i pashfrytëzuar për Bashkinë Elbasan. 72% e territorit të bashkisë është hapësirë natyrore, e paprekur nga aktiviteti njerëzor, me potencial të madh për zhvillimin e **turizmit aventuresk** (kodrinor/malor). Fshatrat ë skajet e bashkisë janë shumë panoramikë dhe kanë potencial për oferta të ndryshme turistike, përfshirë ecjen, ecjen me biçikletë në mal, hedhjen me parashutë³¹, kajakun, sportet ujore etj. **Turizmi kulturor** është i pranishëm çdo ditë dhe zhvillohet rreth monumenteve kulturore që përfaqësojnë të kaluarën bizantine dhe osmane të qytetit. Në Bashkinë Elbasan, 18 monumente kulture janë në risk, ku përfshihen urat, xhamitë, kishat, bazilikat, Hamami i Kalasë, shtëpitë, dy shtëpitë muze, Kalaja e Skampit dhe stacioni *Ad Quintum* (në Egnatia).³²

Turizmi i banjave termale është aktiviteti kryesor turistik, i cili mbulon rreth 70% të ofertës turistike të bashkisë. Rajoni është i njohur për banjat e tij termale që trajtojnë sëmundjet e artritit reumatoid, artritit, reumatizmit etj. Hotelet (43) dhe ambientet e fjetjes dhe mëngjesit janë ndërtuar pranë burimeve termike në njësinë administrative Tragan për akomodim. Këto struktura akomodimi (2400 shtretër) janë të rezervuara plotësisht në sezonin e fluksit (prill-qershor dhe shtator-tetor). Numri i vizitorëve në sezonin e fluksit të banjave termale arrin në 4000 vizitorë në ditë (vetëm 10% shqiptarë, të tjerë nga Kosova, Maqedonia e Veriut etj.).³³

2.4.4 Energjia

Bashkia Elbasan shtrihet në një zonë të pasur me ujë (pasuri sipërfaqësore dhe nëntokësore). Bashkia shfrytëzon ujërat e lumenjve për **prodhimin e energjisë** me SPP-të e vogla (>1MW) dhe HEC-et e mëdhenj (<50MW) që parashikohen të ndërtohen në lumin Shkumbin, duke ndikuar më tej në shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore. Aktualisht, 7 HEC-e me kapacitet total 261 MW punojnë, ndërsa 9 HEC-e të tjera, të gjitha nën 1 MW, janë në ndërtim dhe mbi 54 të tjerë janë planifikuar të ndërtohen në lumin Shkumbin

³¹ Projekti i fundit i financuar nga programi IPA CBC i Maqedonisë së Veriut – Shqipërisë po investon në njësinë administrative të Funarit, i disponueshëm në: Krushevë dhe Elbasan – destinacion i njohur ndërkufitar për turizëm – Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar i Bashkimit Evropian MK-AL (ipacbc-mk-al.eu)

³² PM-të për Workshop-in e Vlerësimit të Cenueshmërisë, 4 tetor 2023


³³ Po aty

dhe degët e tij.³⁴

Elbasani ka potencial të lartë prodhimi energjie gjeotermale falë burimeve termale të Kozanit-8 dhe Treganit. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani-8 është 2070 kW.³⁵ Energjia diellore, si burim alternativ i energjisë, është eksploruar nga ana e bashkisë duke dhënë me qira toka kullotë (77 ha) për të ndërtuar panele fotovoltaike (dhe infrastrukturave të tjetra të nevojshme) për prodhimin e energjisë.³⁶ Megjithatë, energjia diellore përdoret kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe panelet fotovoltaike janë kryesisht për përdorim individual.

Qyteti i Elbasanit renditet i treti për **konsumin e energjisë**. Sektori i transportit ka peshën më të madhe të konsumit të energjisë, i ndjekur nga sektori i banimit (në periudhën 2018 – 2022) siç parashikohet në Figurën 2.7.

Figura 2.7 _ Konsumi i energjisë sipas sektorëve në Elbasan (Ktoe)



Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

2.4.5 Transporti

Transporti publik në Bashkinë Elbasan mbështetet nga transporti periferik për përmbushjen e kërkesave të pasagjerëve për transport brenda territorit të bashkisë, si dhe nga transporti ndërqtetës për lidhjen me qytetet e tjera. Transporti periferik mbulon pjesën më të madhe të territorit dhe ka 24 linja. Qyteti nuk ka terminal, por ka stacione autobusësh ndërqtetës në vendndodhje të ndryshme të qytetit. Nuk ka as vend parkimi publik, përveç disa parkimeve me pagesë për personat fizikë dhe juridikë.³⁷

Linja **hekurudhore** e Korridorit VIII, i cili lidh Durrësin (portin) me Pogradecin, kalon në territorin e Bashkisë Elbasan. Edhe pse jashtë funksionimit prej shumë vitesh, kjo linjë, sikurse dhe lidhja e saj e ardhshme me Maqedoninë e Veriut, ka marrë fonde për përgatitjen e studimeve teknike mbi rehabilitimin dhe përmirësimin e fazave të Korridorit VIII në territorin e Shqipërisë.

Të dhënat tregojnë se në periudhën 2018-2022, automjetet ishin kryesisht vetura 79,71%, mjete transporti të përziera dhe kamionë 8,68%, motoçikleta 5,85% dhe mjete të tjera 5,81%. Të dhënat pasqyrojnë **përdorim mbizotërues të karburanteve të zakonshme (benzinë dhe naftë)** për automjetet në Bashkinë Elbasan. Aktualisht, **automjetet me benzinë** janë më të zakonshmet, të cilët janë rritur gradualisht me kalimin e viteve. Zona ka një numër shumë modest **automjetesh elektrike**, me një rritje fare të lehtë, çka tregon ndërgjegjësim të shtuar ose nisma për alternativa më të qëndrueshme transporti.

³⁴ <https://riverwatch.eu/en/balkanrivers/map> aksesuar në janar 2024

³⁵ Elbasan PZHV (viti), fq. 24 dhe fq. 35 i disponueshëm në: <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Strategjia-e-Zhvillimit-per-Territorin-e-Bashkise-Elbasan-1.pdf>

³⁷ Sistemi i Lëvizjes së Qëndrueshme Urbane në Bashkinë Elbasan (2020), fq. 12-13

3 Qeverisja dhe kuadrot rregullatore, si dhe politikat, planet dhe programet përkatëse

Ky kapitull përshkruan shkurtimisht aspektet e sistemit të qeverisjes së Bashkisë Elbasan sa i përket përshtatjes. Për fat të keq, ndërkohë që në nivel kombëtar mekanizmat janë disi më të zhvilluar, **integrimi i ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të përshtatjes** në Bashkinë Elbasan, **nuk ka nisur fare** për shkak të nivelit të njohurive, ekspertizës, dhe burimeve njerëzore, teknike dhe financiare.

3.1 Profili i qeverisjes në Elbasan

Në Shqipëri qeverisja vendore përbëhet nga zyrtarë të zgjedhur (kryetari dhe këshilli bashkiak), drejtoritë dhe zyrat e ndryshme me staf administrativ (nëpunësit civilë) të organizuara kryesisht në bazë të funksioneve themelore që ngarkohen me ligj, të cilat kanë të bëjnë me administrimin e shërbimeve vendore si punët publike, menaxhimi i mbetjeve, infrastruktura arsimore, etj.

Reforma administrative territoriale (2015) dhe grupimi i ish-bashkive dhe komunave në bashki të reja rezultoi në krijimin e Bashkisë Elbasan të organizuar me 13 njësi administrative, përfshirë qytetin e Elbasanit dhe 116 fshatra. Megjithëse reforma ka përfunduar tashmë prej shtatë vjetësh, bashkitë përballen ende me vështirësi në mbledhjen dhe konsolidimin e informacionit, organizimin dhe zbatimin e funksioneve të veta, si dhe strukturimin e burimeve njerëzore. Bashkia Elbasan është një nga bashkitë më të mëdha në Shqipëri dhe një nga bashkitë më të vështira për t'u administruar.

Bashkia është e organizuar në gjashtë Drejtori të Përgjithshme, Drejtori dhe Inspektorate, me një numër të përgjithshëm prej 389 punonjësish. Përveç kësaj, Agjencia e Shërbimeve Publike³⁸, i cili është institucion në varësi, ka punësuar 302 persona. **Planifikimi urban** (përfshirë pyjet), **bujqësia** (së bashku me ujtitjen, kullimin dhe veterinarinë), **turizmi** dhe **transporti, janë të organizuara sipas drejtorive dhe sektorëve të dedikuar**. Organigrama dhe struktura e Bashkisë **nuk parashikon një pozicion/funksion të përkushtuar për sektorin e energjisë**. Një sektor i veçantë merret me statistikat. Organigrama e bashkisë është horizontale, me nivel të përgjithshëm hierarkik nga specialisti, te përgjegjësi i sektorit, te drejtori dhe te drejtori i përgjithshëm i të gjitha drejtorive.

3.2 Objekti i Planit Vendor të Përshtatjes

Bashkitë kanë **tagër të qartë për hartimin e Planeve Vendore të Përshtatjes**. Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” parashikon:

- bashkitë projektojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në fushën e pyjeve e të bujqësisë, duke synuar reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, të pyjeve, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve; *(neni 18)*
- bashkitë, për territorin nën juridiksionin e vet, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre për klimën së bashku me raportet për masat e marra ose të planifikuara për zbutjen dhe përshtatjen e i vënë këto në dispozicion të ministrisë”; *(neni 23)*
- bashkitë, hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikuara nga ndryshimet klimatike; *(neni 29, pika 1.)*

³⁸ Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 27, datë 14.01.2022 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë së Shërbimeve Publike”

- bashkitë, përditësojnë politikat/dokumentet kombëtare, në mënyrë që të nxisin investimet për projekte miqësore ndaj klimës, mbështesin kërkimin shkencor dhe nxisin praktikën më të mirë në fushat me përparësi të prodhimit të energjisë, efikasitetit të energjisë, transportit, ujërave, menaxhimit të mbetjeve, përdorimit të tokës, përshtatjes së infrastrukturës dhe mbrojtjes së natyrës. (neni 29, pika 2.)


3.3 Lidhjet me strategjinë kombëtare të zhvillimit/kuadrin e planifikimit

Në kuadër të Veprimit me Përparësi Nr. 12 “Nisma për Planet Bashkiake të Përshtatjes me Ndryshimet Klimatike”, dokumenti Shqiptar i PKP-së, i miratuar me VKM nr. 466/2019, parashikon hartimin e Planeve të Përshtatjes me Ndryshimet Klimatike për bashkitë e cënueshme nga efektet e ndryshimeve klimatike.³⁹

Sipas Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, një nga instrumentet kombëtare të planifikimit të territorit janë Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2030 dhe Planet e Përgjithshme të Zhvillimit Vendor (PZHV) të bashkive.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2030⁴⁰ identifikon Tiranën – Elbasanin – Beratin – Gjirokastrën si aksin qendror, i cili do të përforcojë lidhjen e vendit nga veriu deri në jug, si dhe do të integrojë Shqipërinë në korridoret e Evropës Qendrore. Për më tepër, do të përmirësojë lidhjet e qendrës urbane brenda kufijve, siç ilustron Figura 3.1.

Figura 3.1 _ Poli i zhvillimit rajonal Elbasan – Librazhd



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2030

³⁹ Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri, Kuadri për Procesin e Vendit (2021), f. 66 — 67 i disponueshëm në https://unfccc.int/sites/default/files/resource/National_Adaptation_Plan_Albania.pdf

⁴⁰ <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6005&token=4545cf3808648a678e1a9c3ca8042a712a56493f>

Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit Vendor për Bashkinë Elbasan, i hartuar në vitin 2016, identifikon strategjinë për territorin dhe përparësitë strategjike për zhvillimin e bashkisë në 15 vitet në vijim. Shumica e përparësive strategjike të përcaktuara në këtë dokument kanë të bëjnë me sektorët me përparësi të PKP-së, ku energjia nuk është identifikuar si objektiv strategjik, siç theksohet në tabelën 3.1.

Tabela 3.1 _Përmbledhje e Objektivave Strategjike të PZHV-së së Elbasanit me rëndësi për sektorët me përparësi të PKP-së

Dokumenti	Sektorët me përparësi të PKP-së				
	Planifikimi Urban	Turizmi	Bujqësia	Transporti	Energjia
Elbasan PZHV	√	√	√	√	

Burimi: Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit Vendor Bashkia Elbasan, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 29.12.2016, i disponueshëm në <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732&L=2>

Për më tepër, Ligji nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë”, i ndryshuar, përcakton se Bashkitë hartojnë **plane vendore veprimi për energjinë dhe ndryshimet klimatike**, në përputhje me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës.

4 Proceset që mbështesin hartimin e Planit Vendor të Përshtatjes

Procesi i Planit Vendor të Përshtatjes me Ndryshimet Klimatike dhe “mekanizmat” e tij janë koncepte mjaft të reja në nivel vendor. Siç tregoi edhe “Vlerësimi i kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnim mbi Përshtatjen me Ndryshimet Klimatike”⁴¹ në nivel vendor nuk ka organizime institucionale, mekanizma bashkërendimi, apo procedura konsultimi me palët e interesit.

4.1 Organizimi i nevojshëm institucional për procesin e PVP-së

Megjithatë, është me rëndësi thelbësore që të diskutohen së shpejti funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të Bashkisë Elbasan në lidhje me sektorët me përparësi të PKP-së, të pasqyruara në nivel vendor. Diskutimi sesi secili prej këtyre sektorëve është rregulluar në nivel vendor, kryesisht për sa i përket burimeve njerëzore dhe dokumenteve të politikave, është i domosdoshëm për të kuptuar më mirë nevojat për ndërtimin e kapaciteteve të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për çdo sektor të PKP-së në bashkinë Elbasan.

Tabela 4.1 _Burimet njerëzore të përkushtuara që mbulojnë sektorët me përparësi të PKP-së në Bashkinë Elbasan

Sektori me përparësi i PVP-së	Drejtoria/Sektori përgjegjës	Pozicionet që mbulojnë detyrat	si % e të gjithë stafit	Komente
Planifikimi Urban dhe Pyjet	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban/Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Infrastrukturës në Territor dhe Sektori i Projektimit Inxhinierik dhe Arkitektural	15	3.9%	planifikimi urban dhe planifikimi dhe projektimi i investimeve urbane nën të njëjtën drejtori të përgjithshme
	Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit/ Sektori i Menaxhimit të Ekstensionit, Inspektorati i Pyjeve, Sektori i Pyjeve	12	3.1%	4 specialistë, një pozicion për kadastrën e pyjeve dhe për drejtorin; 6 roje që janë përgjegjës për monitorimin e territorit
Turizmi	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportive/ Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit / Sektori i Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	7	1.8%	sektor i dedikuar me 6 specialistë dhe një përgjegjës sektori
Bujqësia	Agjencia e Shërbimeve Publike / Sektori i Agronomisë, Ujitjes dhe Kullimit	15	Nuk ka	bujqësia dhe funksionet e ujitjes/kullimit nga të njëjtat struktura; 10 pozicione agronomësh dhe 5 pozicione ujitjeje dhe kullimi
Transporti	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik; Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Urbane / Sektori i Transportit	3	0.8%	një sektor i dedikuar për mbulimin e transportit, përfshirë pozicionin e menaxherit të nivelit të ulët dhe dy pozicione specialistësh
Energjia	Nuk ka	0	0	Në Strukturën e miratuar të Bashkisë për vitin 2022 nuk ka pozicion të përkushtuar pune;

⁴¹ UNDP — Projekti i PKP-së, Raporti mbi “Vlerësimin e kapaciteteve të bashkive dhe nevojave për trajnim lidhur me Përshtatjen me Ndryshimet Klimatike” (shkurt 2022)

4.2 Proceset e angazhimit të palëve të interesit

Me qëllim përfshirjen e një game të larmishme palësh interesi dhe me qëllim integrimin e kontributit të tyre në Planet Vendore të Përshtatjes (PVP), Projekti “Përparimi i planifikimit të Shqipërisë për përshtatje afatmesme dhe afatgjatë përmes zhvillimit të Procesit Kombëtar të Planifikimit të Përshtatjes” nisi një proces konsultimi me tetë bashki partnere, përfshirë Bashkinë Elbasan. Me ndihmën e Projektit UNDP-PKP, në Elbasan procesi nisi në maj të vitit 2021. Duke pranuar risinë e temës, konsultimet u shtrinë përtej drejtorive të Bashkisë Elbasan duke përfshirë aktorë të ndryshëm vendorë. Përmes korrespondencës, mbledhjeve teknike dhe workshop-eve të organizuara në periudhën 2022-2023, projekti angazhoi 42 palë interesi (21 femra dhe 21 meshkuj), përfshirë përfaqësues të Bashkisë Elbasan dhe Qarkut të Elbasanit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse synonte përfshirjen e njohurive, shqetësimeve dhe përparësive të ndryshme në procesin e PVP-së, duke mëkuar pronësinë dhe pjesëmarrjen.

Procesi i hollësishëm është përshkruar Shtojcën I në këtë dokument.

4.3 Informacione/organizime institucionale shtesë të nevojshme për procesin e PVP-së

Hartimi dhe më pas zbatimi i Planit Vendor të Përshtatjes me Ndryshimet Klimatike të Elbasanit do të kërkojë burime njerëzore të përkushtuara dhe të përmirësuara me qëllim drejtimin dhe bashkërendimin e procesit. Ndër këto masa me rëndësi të madhe është përcaktimi i një “pike kontakti” për ndryshimet klimatike. Duhet të theksohet se **ky roli i ri duhet të zyrtarizohet sa më shpejt që të jetë e mundur** në Bashkinë Elbasan, **në kuadër të pozicioneve të përcaktuara qartë në strukturën e propozuar ose si pozicione të reja të veçanta.**

Planifikimi i PNK-së lidhet ngushtë edhe me prodhimin e statistikave: mbledhjen e të dhënave, mbledhjen e të dhënave të **ndara sipas gjinisë** të rëndësishme për zbatimin e veprimeve të ndryshimeve klimatike dhe të monitorimit me ndjeshmëri gjinore. Sektori i statistikave në Bashkinë Elbasan është i mirëorganizuar. Sugjerohet që të përmirësohen përshkrimet e vendeve të punës nga përgjegjësit e sektorit të statistikave, të cilët duhet të kenë parasysh dhe duhet të diskutojnë lidhur me mbledhjen e të dhënave klimatike, në mënyrë që të mbështesin Bashkinë Elbasan për planifikimin dhe monitorimin e PNK-së më të mirë në këtë sektor kyç.

Tabela 4.2 _Burimet njerëzore të përkushtuara që mbulojnë funksionet mbështetëse të PNK-së në Bashkinë Elbasan

Prodhimi i statistikave	Drejtoria / Sektori përgjegjës	Pozicionet që mbulojnë detyrat	Çështjet mjedisore	Drejtoria/sektori përgjegjës	Pozicionet që mbulojnë detyrat
	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit/ Sektori i Vlerësimit dhe i Statistikave	3 (një përgjegjës sektori dhe dy specialistë)		Nuk ka	0

Me qëllim lehtësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive përgjegjëse për sektorët me përparësi të PVP-së, **me vendim të Kryetarit mund të zyrtarizohet një grup pune për PNK-në** dhe të ngarkohet me përgjegjësi të hollësishme në Rregulloret e Brendshme.

Në përgjithësi, është e domosdoshme të përcaktohen qartë rolet dhe tagrat zyrtarë të individëve në fushën e tyre të punës së bashku me përgjegjësitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e

punës së tyre të përditshme.

5 Informacioni mbi ndryshimet klimatike

Klima e Shqipërisë aktualisht po ndryshon. Gjatë shekullit të shkuar, temperaturat janë rritur, dhe temperaturat dhe modelet e reshjeve kanë ndryshuar me rritjen e ndryshimeve mes stinëve dhe ndikimet e motit më ekstrem. Parashikohet që këto ndryshime të vijojnë dhe të intensifikohen gjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm, ndërkohë që ndryshimet klimatike në të ardhmen parashikohet të jenë shumë më të theksuara se në të shkuarën. Ndryshimet klimatike po ndikojnë aktualisht bashkitë shqiptare, të cilat po përballen me përmbytje dhe zjarre. Veprimi i hershëm për t'u përshtatur me këto ndryshime do të ndihmojë në përmirësimin e aftësive ripërtëritëse dhe reduktimin e riskut. Ndryshimet klimatike janë sfidë e ndërlikuar, pasi risqet janë të ndërlidhura dhe kanë mundësinë të shkaktojnë ndikime të njëpasnjëshme.

5.1 Përkufizimi i termave kyç

- **Risku nga klima** është rezultat i probabilitetit të një risku (përforcuar për shembull, nga ndryshimet klimatike) dhe përmasat e efekteve negative të mundshme të këtyre kërcënimeve në shoqëri, mjedis dhe ekonomi. Identifikimi i riskut ka të bëjë me vlerësimin e riskut bazuar në analizat e mëparshme të risqeve të mundshme, ndikimeve të tyre në sektorë dhe cënueshmërisë së sektorëve përkatës. Dhënia përparësi e riskut bazohet në mundësinë e vërtetimit të riskut dhe nivelin e mundshëm të pasojave.
- **Ekspozimi:** Masa (shpeshësia dhe serioziteti) e përjetimit të rrezikut klimatik në fjalë në vendndodhjen përkatëse. Ky vlerësim bazohet fillimisht në performancën aktuale, në kushtet e sotme klimatike dhe në ngjarjet ekstreme më të fundit, dhe më pas në ndryshimin e mundshëm të ekspozimit në kuadër të ndryshimeve klimatike në të ardhmen.
- **Ndjeshmëria:** Masa në të cilën rreziku klimatik mund të ndikojë bashkinë, pavarësisht vendndodhjes. Nëse ndikimet në asete ndikojnë në përgjithësi në ofrimin e shërbimit dhe shkaktojnë ndërprerje, përcaktohet përparësia për trajtim në fazën e ardhshme. Gjithashtu, në këtë kuadër duhet të merren parasysh risqet e ndërvarësisë dhe si ndikimet në sisteme të tjera ndikojnë te bashkia; për shembull, si ngjarjet ekstreme atmosferike mund të sjellin ndërprerje të furnizimit me energji dhe si kjo mund të ndikojë te sistemet.
- **Kapaciteti i përshtatjes** është aftësia e sistemeve, institucioneve, njerëzve dhe organeve të tjera për t'u përshtatur me dëmet e mundshme, për të përfituar nga mundësitë ose për t'iu përgjigjur pasojave. Ky vlerësim synon të kuptojë burimet e qytetit/bashkisë lidhur me mundësinë e shfrytëzimit të tyre për përballimin e rreziqeve me të cilat përballlet qyteti.
- **Cënueshmëria** përbëhet nga ndjeshmëria dhe kapaciteti për përshtatje i sektorëve. Cënueshmëria mund të përkufizohet si prirja ose predispozita e një sistemi të caktuar për t'u ndikuar nga një kërcënim. Rezultatet e vlerësimeve të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve për përshtatje përbëjnë bazën e vlerësimit të cënueshmërisë së sektorëve.
- **Vlerësimi i rrezikut klimatik** identifikon probabilitetin, intensitetin dhe periudhën kohore të rreziqeve kryesore në një qytet/ bashki të dhënë dhe shpërndarjen e tyre hapësinore në territorin përkatës, duke marrë në konsideratë prirjet historike të qytetit/bashkisë dhe situatën aktuale, si dhe skenarët e ardhshëm të hartuar mbi bazën e fakteve të disponueshme shkencore.
- **Vlerësimi i ndikimit të rrezikut klimatik** shqyrton ndikimet e mundshme të ngjarjeve të rreziqeve klimatike tek njerëzit, asetet dhe shërbimet. Vlerësimi duhet të identifikojë: (1) grupet e popullsisë, sistemet dhe sektorët e cënueshëm, (2) kapacitetin e popullsisë dhe sistemeve për t'u përshtatur me rreziqet dhe (3) ndikimin e mundshëm tek njerëzit dhe sistemet.
- Vlerësimi i riskut dhe ndikimeve bazohet te **Mundësia:** sa ka të ngjarë të ndodhë risku deri në

vitin 2050 dhe te **Pasoja**: Serioziteti ose përmasat e ndikimit të lidhur me rrezikun klimatik, nëse ai ndodh. Në këtë kuadër merren në konsideratë një gamë e gjerë ndikimesh.

5.2 Informacioni klimatik

Fokusi i këtij kapitulli është zhvillimi i kuptimit të klimës në mbarë Shqipërinë dhe vlerësimi i nivelit të qëndrueshmërisë dhe cenushmërisë. Ky vlerësim përqendrohet te ekspozimi i Shqipërisë ndaj rreziqeve klimatike. Për këtë arsye, vlerësimi përqendrohet kryesisht në risqet fizike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (Risku = ekspozimi ndaj riskut x ndjeshmëria x kapaciteti për përshtatje) dhe mundësitë në kuadër të ndryshimeve klimatike. Këto risqe do të informojnë planet bashkiake për përshtatjen. Qëllimi është t'u sigurohet politikëbërësve dhe vendimmarrësve informacion rreth risqeve klimatike që mund të kenë ndikimin më të madh në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, duke u mundësuar hartimin e planeve të bazuara në prova dhe të qëndrueshme në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet në vlerësim ofrojnë gjithashtu informacion të vlefshëm mbi risqet dhe mundësitë që duhet të trajtohen.

5.2.1 Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri

Klima e Shqipërisë është klimë tipike mesdhetare, e karakterizuar nga dimri i butë me reshje të bollshme dhe vera e nxehtë dhe e thatë. Për shkak të topografisë shumë të thyer, në këtë klimë tipike mesdhetare vërehen luhajtje të konsiderueshme klimatike. Luhajtja e vlerave mesatare të temperaturës dhe reshjeve vjetore paraqiten në Tabelën 5.1.

Tabela5. 1_ Luhajtja e vlerave të temperaturave dhe reshjeve mesatare vjetore

Vlerat vjetore	Min	Max
Tmin Mesatare (° C)	-3.1	13.1
Tmax mesatare (° C)	5.3	22.9
E mesmja e T (° C)	1.1	17.4
Reshjet (mm)	370	3260


Figura 5.1 ilustron shpërndarjen gjeografike të mesatareve vjetore (periudha 1996-2015) të temperaturave të mesme maksimale (Tmax) dhe minimale (Tmin)

Figura 5.2_ Shpërndarja e temperaturave mesatare vjetore

Tmin


Tmean

Tmax



Që nga viti 1960, klima e Shqipërisë ka ndryshuar në mbarë territorin. Vihen re dy periudha të veçanta: a) vlerat mesatare vjetore kanë pësuar rënie midis viteve 1960 dhe 1990 dhe më pas b) kanë pësuar rritje. E njëjta situatë nuk është e vërtetë për **reshjet**. Vëzhgimet tregojnë luhatje, por jo prirje të qartë për të gjithë vendin. **Analiza e klimës për zonën e Elbasanit paraqitet shkurtimisht si më poshtë.**⁴²

Figura . 3_ a) shpërndarja vjetore e Tmax mesatare vjetore; b) shpërndarja mujore e temperaturave mesatare vjetore




Rritja e temperaturës gjatë periudhës 2001-2010 është mjaft e dukshme krahasuar me periudhën 1981-90 (Figura 5.2 a, b). Për këtë arsye, numri i ditëve të nxehta ($T_{max} \geq 35^{\circ}C$) rritet dhe i atyre të ftohta ($T_{min} \leq 0^{\circ}C$) dhe shumë të ftohta ($T_{min} \leq -5^{\circ}C$) ulet në periudhën 2001-2010, krahasuar me periudhën e mëparshme.

Në dallim nga shpërndarja e temperaturave, ajo e reshjeve nuk tregon prirje të qartë, vetëm luhatje (Figura 5.3)⁴³. Sasia e reshjeve vjetore gjatë periudhës së marrë në konsideratë luhatet ndërmjet 330mm (2003) dhe 1,574mm (1960). Totali i dytë më i lartë i reshjeve është regjistruar në vitin 1962 me 1,540mm. Reshjet mujore deri në 100 mm/muaj janë më të shpeshta. Në tetor të vitit 1985 është regjistruar rasti ekstrem prej 395mm.

⁴² Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi cenusmërinë klimatike dhe ndryshimet e pritshme në Bashkinë Elbasan, Bruci E. (Janar 2024)

⁴³ Për shkak të ndërprerjes së vëzhgimeve të reshjeve për një kohë të gjatë, nuk është e mundur të zbulohet ndonjë prirje

Figura5. 4_ Shpërndarja e reshjeve vjetore (1951 - 2010)




5.2.2 Parashikimet klimatike për të ardhmen për Shqipërinë

Me qëllim vlerësimin e ndryshimeve klimatike, komuniteti shkencor ka hartuar Rrugët e Përbashkëta Socio-ekonomike (SSPx-Y)⁴⁴, skenarët e ndryshimeve klimatike të ndryshimeve të parashikuara socio-ekonomike botërore deri në vitin 2100 siç përcaktohet në Raportin e Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK). Këto përdoren për të hartuar skenarë të shkarkimeve të gazrave serë me politika të ndryshme klimatike.

Ndryshimet e vëzhguara dhe të simuluar lidhur me temperaturën e sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 — 1900 në shkallë botërore jepen në Figurën 5.4.

Figura 5. 5_ Ndryshimi botëror i temperaturës së sipërfaqes në krahasim me periudhën 1850 - 1900



Burimi: TS, Ndryshimet klimatike 2021: Baza e Shkencës Fizike. Kontributi i WGI për AR6 të PNNK-së


Rritja e parashikuar e temperaturës globale nën skenarë të ndryshëm dhe tregimi i skenarëve të përshtatur për Shqipërinë janë paraqitur në Shtojcën II.

Analiza e mëposhtme mbi ndryshimet e pritshme klimatike bazohet në skenarët e SSPx-y të hartuar për

⁴⁴ Një përshkrim i shkurtër i pesë SSP-ve jepet në Shtojcën II të këtij dokumenti

Shqipërinë⁴⁵. Në shumicën e rasteve analiza përqendrohet në SSP 1-1.9 (që janë në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për ndryshimet klimatike⁴⁶ dhe skenarin e lartë SSP 3-7.0. Figura 5.5 tregon se rritja e temperaturës Tmax ka gjasa të vërtetohet deri në vitin 2050 krahasuar me periudhën bazë. Në të gjithë vendin pritet pakësim i reshjeve të përgjithshme.

Figura5. 6_ Shpërndarja e ndryshimeve të Tmax gjatë verës deri në vitin 2050



Sidomos për zonën e Elbasanit:

Temperatura

- SSP1-1.9 dhe SSP1-2.6 parashikojnë rritjen më të ulët të Tmean. Ndryshimet vjetore të Tmean në krahasim me periudhën klimatologjike referencë (1996-2015) ka të ngjarë të arrijnë deri në 0,9° C (0,6° C deri 1,4° C) dhe 1,2° C (0,7° C deri në 1,7° C) përkatësisht, deri në vitin 2050.
- Skenari mesatar SSP2-4.5 parashikon ndryshime që ka të ngjarë të luhaten ndërmjet 1,0°C deri 2,2°C (vjetore) dhe 1,3°C deri në 3,0 °C (verë) deri në vitin 2050.
- Skenarët agresivë dhe shumë agresivë, SSP3-7.0 dhe SSP5-8.5 japin parashikimet më të këqija, veçanërisht në verë.


⁴⁵ Skenarët e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë hartohen përmes përpjesëtimit të skenarëve botërorë të SSPx-Y për temperaturën dhe reshjet, në rezolucion 1*1 km, duke përdorur SimClim AR6 me periudha vjetore dhe sezonale deri në vitin 2100. Viti 2005 (mesatarja e periudhës 1996-2015) përdoret si referencë për simulimet. Analiza e rezultateve përqendrohet në periudhën 2021-2040 (2030_qendër) dhe 2041-2060 (2050_qendër). Për lehtësi, tani e tutje, raporti do t'i referohet këtyre dy periudhave me vitet qendrore 2030 dhe 2050.

⁴⁶ Qëllimi kryesor i Marrëveshjes së Parisit, që është traktat ndërkombëtar detyrues, është të mbajë "rritjen e temperaturës mesatare botërore në vlerë bollshëm më të ulët se 2°C mbi nivelet para-industriale" dhe të përpiqet "të kufizojë rritjen e temperaturës në 1,5° C mbi nivelet para-industriale".

- Ndryshimet e pritshme vjetore dhe verore kanë gjasa të arrijnë deri në 2,2° C (1,4° C deri në 3,2° C) dhe 2,6° C (1,7° C deri në 3,9° C) përkatësisht deri në vitin 2050, madje edhe më shumë në vitin 2100.⁴⁷
- Numri i ditëve të nxehta dhe valëve të të nxehtit priten të rriten sipas të gjithë skenarëve në të gjitha zonat klimatike në krahasim me periudhën e referencës, veçanërisht sipas SSP3-7.0 dhe SSP5-8.5. Nga ana tjetër, numri i ditëve të ftohta dhe shumë të ftohta dhe valëve të të nxehtit pritet të ulet sipas të gjithë skenarëve.
- Shpeshtia dhe intensiteti i Tmax absolute pritet të rriten, ndërsa vlerat përkatëse për Tmean absolute të ulen.

Figura 5.6 tregon ndryshimet e pritshme të Tmax vjetore në lidhje me periudhën e referencës.

Figura 5.7 _ Ndryshimet e mundshme në vlerat vjetore dhe verore të Tmax në Elbasan



Shënim: linjat e plota janë vlerat mesatare, pritet që ato të luhaten midis vijave të ndërprera, të cilat i referohen përkatësisht përqindjeve 95% dhe 5%

Parashikimet e reshjeve:

- Të gjitha SPP-të tregojnë rënie të mundshme të reshjeve vjetore dhe sezonale krahasuar me periudhën 1995-2015 për të gjitha seritë kohore deri në vitin 2100 dhe parashikimi i variacionit rreth vlerave mesatare (nivelet 5% dhe 95%) është i lartë.⁴⁸
- Projektet e skenarit të ulët SSP1-1.9 ulen me -2,8% (nga -15,5% në +7,7%) dhe -7,7% (nga -25,1% në +8,2%) për vitin dhe verën përkatësisht, deri në vitin 2050.
- Skenari SSP3-7.0 parashikon rënie më të lartë të reshjeve në përqindje sesa SSP1-1.9. Vlerat vjetore dhe verore kanë gjasa të arrijnë deri në -5,0% (nga -27,9% deri +13,8%) dhe -13,9% (nga -45,1% deri +14,7%) përkatësisht deri në vitin 2050.⁴⁹
- Reduktimi i lartë në 5%-shin e poshtëm të ndryshimeve tregon rritje të mundshme të shpeshtisë

⁴⁷ Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi cenueshmërinë klimatike dhe ndryshimet e pritshme në Bashkinë Elbasan, Bruci E. (Janar 2024)


⁴⁸ Po aty

⁴⁹ Po aty

së thatësirave (Figura 5.7).

- Rritja e lartë në 95%-shin e nivelit të ndryshimeve tregon risk të mundshëm më të lartë për intensifikimin e reshjeve të dendura që mund të shkaktojnë përmbytje. (Figura 5.7)
- Periudhat e kthimit të niveleve maksimale të reshjeve në territorin e Shqipërisë pritet të bien. Reshjet e dendura më të shpeshta dhe me kohëzgjatje më të gjatë mund të shkaktojnë përmbytje dhe dëme ekonomike.

Figura 5.8 _ Ndryshime të mundshme në reshjet vjetore dhe verore në Elbasan



Shënim: linjat e plota janë vlerat mesatare, pritet që ato të luhaten midis vijave të ndërprera, të cilat i referohen përkatësisht përqindjeve 95% dhe 5%

5.2.3 Rreziqet

Rreziqet natyrore në Shqipëri, të tilla si stuhitë e ashpra, përmbytjet, valët e nxehtësisë dhe zjarret, po bëhen më të shpeshta, të paparashikueshme dhe serioze për shkak të prirjeve të parashikuara të ndryshimeve klimatike. Aktualisht, Shqipëria përballlet me vështirësi në rritje lidhur me prodhimtarinë e bujqësisë, prodhimin e energjisë dhe shëndetin e popullsisë. Këto vështirësi do të përkeqësohen si pasojë e trysnive klimatike dhe degradimit mjedisor, që si pasojë do të ndikojnë te burimet ujore. Shqipëria dhe bashkitë e saj nuk po e nisin punën nga zero; planifikimi, sigurimi i fondeve dhe mbledhja e të dhënave në nivel bashkiak kanë nisur tashmë në mbështetje të përgatitjes dhe përshtatjes në fusha kyçe me klimën që po ndryshon.

Ndikimet klimatike përfshijnë pasoja e shumëfishta të valëve të të nxehtit, thatësirave, përmbytjeve, acidifikimit të oqeanit dhe rritjes së nivelit të detit më të gjata dhe/ose më intensive, siç janë ndikime të njëpasnjëshme në ekosistemet detare dhe tokësore, si dhe në përdorimin e tokës dhe detit (bujqësia, pyjet, turizmi, etj.) dhe shëndetin e njeriut. Topografia e Shqipërisë mbizotërohet nga zonat malore, bregdeti dhe një rrjet i gjerë lumenjsh dhe liqenesh.

Ndikimet e pritshme klimatike nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve në të gjithë Shqipërinë janë si më poshtë:

- **Ndryshimet e temperaturës**

Shqipëria do të përballlet me stres për ujë deri në vitet 2050 dhe stres të theksuar për ujë deri në vitet 2090, me thatësira serioze në zonat qendrore dhe jugore.

- **Reshjet**

Ndryshimet klimatike pritet të rrisin riskun dhe intensitetin e përmbytjeve dhe reshjeve që rrisin më tej riskun e humbjes së jetës dhe dëmtimit të pronës dhe infrastrukturës


shkaktuar drejtpërsëdrejti nga përmbytjet dhe/ose rrëshqitjet e dheut dhe erozioni. Shirat intensivë, erozioni i lumenjve dhe përmbytjet kanë gjithashtu gjasa të dëmtojnë infrastrukturën dhe shërbimet e menaxhimit të ujërave.

- **Rritja e nivelit të detit dhe prurjet ujore nga stuhitë**
Rritja e nivelit të detit dhe intensifikimi prurjeve ujore nga stuhitë do të dëmtojë infrastrukturën bregdetare, përfshirë objektet e turizmit dhe tokën bujqësore dhe do të rezultojnë në përmbytje të shtuara.
- **Zjarr në pyll**
Ndikimi i temperaturave ekstreme/erës mund të përkeqësojë ndikimin e zjarreve në pyje

5.3 Qasja e vlerësimit të riskut dhe cenueshmërisë

Në kuadër të vlerësimit të riskut, u ndoq një metodologji dhe qasje e zakonshme, sikurse paraqitet më poshtë në Figurën 5.8. Ky dokument udhëzues ofron informacione për secilin prej këtyre hapave:

Figura 5.9_ Metodologjia



Hapat janë përshkruar më poshtë:

1. Fillojmë me identifikimin e rrezikut, ku vlerësojmë mangësitë kritike, mbivendosjet dhe mospërputhjet në klasifikimin e rreziqeve klimatike dhe konsiderojmë ekspozimin e këtyre rreziqeve në Shqipëri.

2. Më pas vlerësojmë ndikimin e rrezikut në sektorët kyç, së bashku me nivelin e ndjeshmërisë së tij.

3. Më pas vlerësojmë kapacitetin e përshtatjës së sektorit.

4. Kapaciteti përshtatës, së bashku me ndjeshmërinë e tij, lejuan vlerësimin e rezultatit përfundimtar të cenueshmërisë. Vlerësimi i ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë ofron një pamje më të mirë të përparësisë së risqeve.

5. Hapi tjetër është vlerësimi i risqeve dhe përparësia e tyre bazuar te mundësia dhe pasojat e ngjarjes së rrezikshme.

Për qëllimet e hartimit të planit vendor të përshtatjes me ndryshimet klimatike sipas bashkive, *supozohet që ndjeshmëria vendore dhe kapaciteti për përshtatje janë të njëjta me ndjeshmërinë dhe kapacitetet për përshtatje kombëtare të Shqipërisë* siç paraqitet në Tabelën 5.3 dhe Tabelën 5.4.

Megjithatë, elementi kryesor dallues është shkalla e ekspozimit të secilës bashki ndaj rreziqeve individuale klimatike. Kjo paraqitet në seksionin 6.4. Niveli i riskut përcaktohet nga ekspozimi ndaj Rrezikut (vendor) x ndjeshmëria (kombëtare) x kapaciteti për përshtatje (kombëtar).

Tabela 5.2 _ Qasja e vlerësimit të riskut

Rreziku dhe Ekspozimi i tij	Ndjeshmëria	Kapaciteti për Përshtatje
Identifikimi i rreziqeve i ndjekur nga marrja në konsideratë e ekspozimit (rreziqet prej faktorëve klimatikë)	Vlerësimi i ndjeshmërinë (përmasat e ndikimit të pritshëm). Ndjeshmëria vendore pasqyron ndjeshmërinë e Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të tjera	Vlerësimi i kapacitetin për përshtatje (aftësia për t'u përgjigjur ose rimëkëmbur). Kapaciteti vendor për përshtatje pasqyron kapacitetin kombëtar për përshtatje.

Burimi: Autori

Në kuadër të kësaj qasjeje zhvillohet një kuptim i klimës në mbarë Shqipërinë dhe vlerësohet niveli i qëndrueshmërisë dhe cenueshmërisë së vendit. Nuk jemi të sigurt si do të jetë klima e së ardhmes, kështu që planifikimi duhet të bëhet mbi bazën e skenarëve që pasqyrojnë klimën në ndryshim.

Shkalla e ndjeshmërisë me katër nivele (shihni Shtojcën III) u miratua me qëllim vlerësimin e ndikimit të rreziqeve në Shqipëri.

Ndjeshmëria e ardhshme e Shqipërisë ndaj rreziqeve dhe faktorëve klimatikë u vlerësua me anë të një metodologjie me informacion nga matrica e Planifikimit të Veprimit të Qytetit të Gjelbër, e BERZH-it, siç paraqitet në Tabelën 5.4 Ky vlerësim me shumë rreziqe u kompletua duke analizuar ndjeshmërinë e kombinuar të secilit sistem ndaj grupit të rreziqeve.

Tabela 5.3 _ Matrica e ndjeshmërisë së Shqipërisë

Core systems (Albania)	Hazards																General sensitivity to hazards and their derivatives																
	Environmental (Physical and Climatic)						Technological						Social economy & Human induced																				
	Earthquake	Landslide	Flood	Severe Storm	Wildfire	Extreme Hot Weather/Heatwave	Extreme Cold Weather/Coldwave	Drought/Water Scarcity	System breakdown (Solid Waste Managem)	Building Collapse	System Accident (Water Contamination)	Fire	Oil Spill	Chemical Spill	Gas Leak	Explosion in Building	Environment pollution (air, water, soil)	Pandemic/Epidemic (COVID-19)	Extreme Enforced Quarantine	Transport System Breakdown	Poisoning (Radiation)	Corruption	Business Discontinuity	Conflict/ Labor Strikes/Unrest	Terrorism	War	Supply crisis (Water)	Supply Crisis (Food)	Economic Crisis (Russia/China Trade Collap	Economic Crisis (Recession)	Economic Crisis (Oil demand & Price Collap		
1 People, health, communities and built environment																																	
Social Welfare	2	2	2		3	3	3	2	1	2	1	2					3	3			2	1	1	1		1	1	3	3		2	2	2
Public safety and security	2	2	1	2	3	3	3	3	2	1	2	3	1	1	1	2	3	3	3	1	3	1	2	3	3	2	2	3	2	2	1	1	1
Education	2	2	1	2	2	2	3	2		2	2	2					2	2	2	2	2	1		2	2	2							
Buildings	2	2	3	2	3	1	3	1		3	3				3	3	2		1			1	1	3	2	3							
Housing	3	3	3	2	3	2	3	1		3	2	3			2	3	1	1					1	3	1					3	2		
Historical heritage	3	3	3	1	2	1	1			3	3				2	3	1	2				1	1	3	3								
2 Infrastructure																																	
Transport and mobility	2	2	2	2	1	2	3		1									2		3	1	1		1	2	2	2						
Energy	2	2	1	3	1	2	2	3	3	1		1									1	2		1	2	2			2	2	3		
Water supply	2	2	2		1	2	1	3	3		3	1	3	3	1	1	3				1	2			1	1	3						
ICT	1	1			1	2	2			1		1										1	1	1	1	1	1						
3 Business and Industry																																	
Agriculture (Food)	2	2	2	1	3	3	3	3			2	3				1	3	1		1	3	1	2	2	1	2	3	3	2	1			
Land-use	2	2	2		3	1	1	2		1	1	3	1	1		3					2	1	2	1	1	3	1						
Tourism	3	3	3	1	3	2	2	3	1	1	2	3	1	1	1	1	3	2	3	2	3	3	2	3	3	3	3	3	3	3	3	3	
4 Natural environment																																	
Biodiversity			2	1	3	3	3	3	2		3	3	2	2	2		3	1			3					3	3	3					
Total	28	28	27	17	32	29	33	26	14	17	18	31	8	8	12	14	27	16	10	9	20	15	10	21	22	31	23	11	10	12	11		
Hazard Mean	1.4	1.4	1.4	0.9	1.6	1.5	1.7	1.3	0.7	0.9	0.9	1.6	0.4	0.4	0.6	0.7	1.4	0.8	0.5	0.5	1.0	0.8	0.5	1.1	1.1	1.6	1.2	0.6	0.5	0.6	0.6		

Shënim: Kategorizuar sipas këndvështrimit të rreziqeve të nxitura nga ekonomia mjedisore, teknologjike dhe sociale dhe njeriu (riformtuar nga metodologjia e GCAP e BERZH-it)

Kapaciteti për përshtatje i ekosistemeve dhe sistemeve njerëzore pritet të përballet me pengesa të fuqishme për shkak të efekteve ndërvepruese, të mbledhura dhe të njëpasnjëshme të thatësirave, valëve të të nxehtit, rritjes së nivelit të detit, etj. Vlerësimi i burimeve të Shqipërisë (Kapaciteti për Përshtatje i Shqipërisë) në aspektin e mundësisë së shfrytëzimit të këtyre burimeve për të përballuar rreziqet klimatike paraqitet në Tabelën 5.5.

Tabela 5.4 _ Kapaciteti përshtatës i Shqipërisë

		Sistemet dhe Shërbimet Shqiptare	Kapaciteti për Përshtatje
1.	Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar	Siguria publike	Ndikim i moderuar
		Mirëqenia sociale	Ndikim i moderuar
		Strehimi, zhvillimi urban	Ndikim i moderuar
2.	Infrastruktura	Transporti dhe Lëvizshmëria	Ndikim i ulët
		TIK-u, Energjia, Uji	Ndikim i ulët
3.	Biznesi dhe Industria	Bujqësia (Ushqimi), Përdorimi i tokës	Ndikim i moderuar
		Turizmi	Ndikim i lartë

5.4 Disponueshmëria dhe nevoja për të dhëna

- Faktet e disponueshme u mblodhën përmes hulumtimit të literaturës dhe mbi bazën e gjykimit të palëve të interesuara që morën pjesë në workshop-e me palët e interesit. Vlerësimi i hollësishëm sasior i secilit risku individual të klimës shkon përtej qëllimit të këtij projekti.
- Në kontekstin e këtij vlerësimi duhet të merren në konsideratë në sërë supozimesh dhe kufizimesh që kanë të bëjnë me besueshmërinë, disponueshmërinë, dhe ekstrapolim dhe interpolim të dhënave që nuk trajtojnë bashkinë në veçanti. Llojet e kufizimeve të hasura përfshijnë: Mungesa e të dhënave të veçanta për bashkinë, besueshmëria e të dhënave për rreziqe klimatike të caktuara në shkallë bashkie / mikro. Hulumtimi i literaturës në shkallë vendi mori në konsideratë shqyrtimin e informacionit kombëtar mbi parashikimet klimatike të paraqitur në Komunikimet Kombëtare të Shqipërisë (1-4).
- Mungesa e të dhënave të disponueshme për vlerësimin e klimës mundësoi përcaktimin e ndikimit të risqeve klimatike që përjeton aktualisht bashkia, dhe si parashikimet e ndryshimeve klimatike ndikojnë në gjasat e risqeve klimatike në të ardhmen. Me vlerë do të ishin të dhëna shtesë për përqindjen e infrastrukturës publike në risk, përqindjen e familjeve në risk, aftësinë ripërtëritëse ndaj përmbytjeve / hartëzimin e përmbytjeve dhe hartëzimin e riskut, veçanërisht për përmbytjet, me qëllim përmirësimin e aftësive ripërtëritëse dhe menaxhimin e përgjithshëm të burimeve ujore.
- Kategorizimi i përgjigjes së secilës bashki bazohen në vlerësim në shkallë të gjerë dhe të bazuar në fakte, megjithëse ky sistem kategorizimi është deri diku subjektiv dhe duhet të përdoret me kujdes. Të gjitha risqet paraqesin kërcënim për bashkitë dhe për këtë arsye të gjitha risqet duhet të merren parasysh në planet e përshtatjes; ky vlerësim synon vetëm të udhëzojë lidhur me dhënien përparësi. Për më tepër, disa përgjigje kërkojnë vite për t'u zbatuar, duke e detyruar bashkinë të rivlerësojë rregullisht këto risqe. Disa prej risqeve janë identifikuar dhe përcaktuar si "Nevojitet hulumtim/kuptim i mëtejshëm". Ky përcaktim është bazuar në faktet e disponueshme në momentin e vlerësimit. Raporti i nxitë bashkitë të vijojnë me hulumtimin e fakteve të reja dhe të shfrytëzojnë çdo mundësi për përmirësimin e fakteve aktuale. Asnjë risk nuk mund të kuptohet tërësisht, për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të risqeve klimatike.


6 Ndikimet sektoriale

Ky seksion paraqet ndikimin e potencialit klimatik në **Bashkinë Elbasan**. Ndër të tjera, bashkitë duhet të presin edhe stuhi më ekstreme, ashtu edhe valë më ekstreme të të nxehtit dhe periudha të thata, për të cilat ka nevojë për përgatitje më afatgjata. Në këtë rast, sfida kryesore është mungesa e vlerësimeve të bazës fillestare ose strategjisë së aftësisë ripërtëritëse në nivel bashkie, në të gjithë bashkitë në Shqipëri. Workshop-et me palët e interesit kanë theksuar se ndryshimet klimatike dhe moti ekstrem janë sfidat madhore për bashkitë. Këto goditje dhe strese gjithashtu mund të ndodhin njëkohësisht në bashki ose mund të shkaktojnë ndikime të njëpasnjëshme te bashkitë e tjera. Ky seksion do **të përqendrohet kryesisht në rreziqet më kritike dhe më të mundshme dhe ato që mund të kenë ndikim.**

Në të identifikohet risku dhe mundësitë, në përgjigje të shtimit të risqeve dhe ndikimeve nga ndryshimet klimatike aktuale dhe të ardhshme në Bashkinë Elbasan, asetet dhe veprimtarinë e saj. Hapi i parë ishte përcaktimi i rreziqeve klimatike, duke identifikuar seriozitetin dhe natyrën e rreziqeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Më pas, u përqendruan dhe u ndanë sipas sektorëve kyç, përkatësisht, (1) njerëzit, shëndetësia, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar (2) infrastruktura, (3) biznesi (4) mjedisi natyror dhe (5) asetet dhe veprimtaritë e bashkisë ku përfshihen bujqësia, energjia, transporti, zhvillimi urban dhe turizmi.

Për sa i përket qasjes metodologjike, fillimisht u vlerësua lista e gjatë risqesh lidhur me përkatësinë e tyre për secilën bashki; ato që u konsideruan jo të përshtatshme u hoqën dhe u shtuan risqet shtesë të veçanta për secilën bashki. Për të kuptuar më mirë kontekstin aktual vendor dhe cenueshmëritë specifike brenda secilës bashki, u ndoq një vlerësim që mundësoi vlerësimin e madhësisë së secilit risk. Ky vlerësim u ndërmor nga hulumtimi në zyrë, studimi i literaturës dhe konsultimi me palët e interesuara nëpërmjet workshop-eve të palëve të interesuara në Tiranë dhe brenda çdo bashkie. Së fundi, risqet u vlerësuan sipas ndikimit dhe mundësive, duke parë me përparësi risqet siç paraqiten në Figurën 6.1.

Figura6. 1_ Grafiku që tregon panoramën e përgjithshme të metodologjisë



6.1 Hapi 1: Vlerësimi i ndikimit klimatik në Elbasan

Analiza e ndryshimeve të klimës dhe parashikimet për të ardhmen paraqiten në Seksionet 5.3 dhe 5.4.

Disa ndikime kryesore të ndryshimeve klimatike në të ardhmen renditen më poshtë.

Ndryshimet në temperaturë:

- Temperaturat mesatare, maksimale dhe minimale të verës dhe dimrit do të rriten në mënyrë

progresive gjatë gjithë shekullit.

- Rritja e temperaturës tregon se numri i ditëve të nxehta pritet të rritet sipas të gjithë skenarëve në të gjithë Shqipërinë. Në zonën e Elbasanit pritet të rritet nga 85 (baza) në rreth 240 dhe 280, përkatësisht sipas SSP3-7.0 dhe SSP5-8.5.
- Temperatura 42.2°C, që arrihet vetëm një herë në 50 vjet, mund të ndodhë më shpesh, një herë në çdo 22 vjet (SSP1-1.9), 12 vjet (SSP3-7.0) ose 9 vjet (SSP5-8.5).
- Rritja e temperaturave në verë mund të sjellë risqe të valëve të të nxehtit për popullatën. Për më tepër, disa ndërtesa, të cilat nuk janë projektuar për verërat e ngrohta, mund të kenë vështirësi në mbajtjen e temperaturës së përshtatshme.
- Shpeshtia e valëve të të nxehtit do të rritet deri në vitin 2050. Ngjarjet ekstreme të valëve të të nxehtit ndodhin në kuadër të ndryshimeve klimatike. Megjithatë, gjatë dekadave të fundit është vërejtur rritje e shpeshtësisë, kohëzgjatjes dhe intensitetit të këtyre ngjarjeve.
- Temperaturat minimale -8.9°C që arrihen një herë në 50 vjet, ka të ngjarë të ndodhin shumë rrallë, një herë në rreth 150 vjet (SSP2-4.5, SSP3-7.0) ose një herë në rreth 200 vjet (SSP5-8.5). Rritja e temperaturave të dimrit ndikon më tej në biodiversitet, i cili është i përshtatur sipas temperaturave aktuale.
- Numri i valëve të të ftohtit pritet të ulet sipas skenarëve në të gjithë Shqipërinë. Në zonën e Elbasanit, sipas të gjithë skenarëve, si në vitin 2030 (2026-2035) ashtu edhe në vitin 2050 (2046-2055) nuk ka gjasa të ketë valë të të ftohtit.
- Dimri më i ngrohtë mund të sjellë disa përfitime, p.sh.: më pak ngrohje në shtëpi gjatë dimrit. Vera më e ngrohtë mund të ndikojë pozitivisht edhe në shëndet dhe turizëm.

Ndryshimet te ndikimet kryesore **të reshjeve** janë si më poshtë:

- Gjatë dimrit po vihet re risk më i lartë i intensifikimit të reshjeve të rrëmbyera që shkaktojnë përmytje; Reshjet e verës priten të kenë intensitet më të lartë, me breshëri që zgjasin pak në kohë.
- Reshjet e dendura rreth 125mm/ditë, që arrihen vetëm një herë në 50 vjet, mund të ndodhë më shpesh, një herë në çdo 40 vjet (SSP1-1.9,) ose një herë në 37 vjet (SSP5-8.5).
- Ndërsa, nga ana tjetër, mund të ketë më shumë thatësira, më shumë reshje të dendura më afatgjata, të cilat mund të shkaktojnë përmytje dhe dëme ekonomike në infrastrukturë dhe vendbanime.
- Rritja e thatësirave sjell sfida të mëdha për sektorët, përfshirë sektorët e prodhimit të energjisë elektrike, bujqësisë dhe ndikimet e mundshme negative në mjediset natyrore për shkak të ndotjes së ujit, erozionit dhe degradimit të tokës.

Rritja e riskut **nga përmytjet**:

- Ndryshimet në reshje dhe temperaturë do të rrisin riskun e përmytjeve në përgjithësi. Në këtë aspekt, zonat më të ndikuara janë: Qyteti i Elbasanit dhe i gjithë territori përgjatë lumit Shkumbin. Kjo mund të ndikojë te banesat e reja në zonat periferike të Bashkisë Elbasan. Ky territor mund të kthehet në një nga territoret kryesore pritëse të popullsisë së zhvendosur (të migrantëve të ndryshimeve klimatike) nga zonat rurale, ku ekziston risku i dëmtimit të një sasive të konsiderueshme të tokave bujqësore.
- Temperaturat më të larta në verë dhe rritja e pritshme e reshjeve afatshkurtra me intensitet të

lartë do të rrisin riskun e përmbytjeve të ujërave sipërfaqësore. Situata shkakton veçanërisht tejmbushjen e sistemeve të kullimit dhe moslargimin e ujit nga sipërfaqja duke shkaktuar probleme, veçanërisht pas periudhave të thatësirës kur uji përthithet më me vështirësi;

- Rritja e temperaturës në dimër pritet të ndodhë krahas rritjes së reshjeve, megjithëse shumica e këtyre reshjeve pritet të bien në formën e shiut.

6.2 Hapi 2: Identifikimi i riskut

Gjatë këtij hapi, provat e ndryshimeve klimatike për secilën bashki të përgatitura në hapin 1, u përdorën për identifikimin e risqeve dhe mundësive. Fillimisht u vlerësua lista e gjatë e risqeve sipas rëndësisë për secilën bashki. Ky konsiderohet edhe si konteksti aktual vendor dhe cenueshmërive të veçanta të secilës bashki, çka mundësoi vlerësimin e shkallës të riskut në fjalë. Më pas u identifikuan risqet më akute, të cilat u përfshinë në planin e veprimit. Risqet u ndanë përkatësisht (1) Njerëzit, shëndetësia, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar, (2) Infrastruktura (3) Biznesi dhe industria (përfshirë Turizmin dhe Bujqësinë) dhe (4) Mjedisi natyror.

Në fund, u ndërmor një vlerësim shtesë për identifikimin e risqeve të lidhura drejtpërdrejt me veprimtaritë e secilës bashki. Risqet e identifikuara janë paraqitur krahas pikëzimit në seksion 6.3.

6.3 Hapi 3: Pikëzimi i riskut

Pasi u identifikuan të gjitha risqet, u ndërmor vlerësimi i nivelit të lartë të risqeve të mundshme, ndikimeve të tyre, probabilitetit të vërtetimit të tyre dhe përgjigjes së nevojshme nga ana e këshillit. Çdo risk u vlerësua sipas ndikimit të mundshëm të riskut që ndodhte dhe probabilitetit të vërtetimit të riskut. Ky vlerësim u bazua te të dhënat më të mira të disponueshme në momentin e vlerësimit. Të njëjtat kritere u përdorën për të dyja risqet e veçanta për secilën bashki si institucion. Parashikohet që bashkitë e Shqipërisë të përjetojnë një sërë rreziqesh të ndryshme klimatike në të ardhmen. Këto përfshijnë rritje/ulje të temperaturës dhe reshjeve.

Renditja e probabilitetit përqendrohet tek ndikimi dhe bashkia:

- I ulët: Ky rrezik nuk ka gjasa të ndodhë në bashki.
- Mesatar: Ky rrezik parashikohet të ndodhë në bashki.
- I lartë: Ky rrezik ka shumë gjasa të ndodhë në bashki.

Llogaritja e ndikimit të riskut (i ulët, i mesëm, i lartë) bazohet te

Ekspozimin ndaj rrezikut x ndjeshmërinë x kapacitetin për përshtatje

Për shembull, kur "Risqet për biznesin nga përmbytjet" merren parasysh në sektorin e turizmit:

- **Ekspozimi ndaj rrezikut është i lartë**
- Matrica e ndjeshmërisë (Tabelën 5.4) tregon se **ndjeshmëria** e turizmit **ndaj përmbytjeve është e lartë** (Pikëzimi 3)
- **Kapaciteti aktual për përshtatje** i sektorit të turizmit (Tabelën 5.5) është i lartë (Pikëzimi 3)
- Matrica e riskut të cenueshmërisë (Tabelën 5.6) tregon se **cenueshmëria** e sektorit të turizmit **ndaj përmbytjeve është e lartë** (3)

Kriteret për përcaktimin e riskut të ulët, të mesëm ose të lartë, përfshijnë kritere financiare, sociale, shëndetësore dhe mjedisore, dhe paraqiten në Tabelën 8.3 të Shtojcës IV. Më pas rezultati i riskut u mor në konsideratë së bashku me provat e ndryshimeve klimatike dhe veçanërisht në shekullin kur do të materializoheshin risqet. Duke marrë këto dy elemente së bashku, u arrit në një kategorizim i nivelit të lartë të përgjigjes së bashkisë për secilin risk.

Nëse do të kishte mungesë të provave lidhur me ndikimet e riskut, mundësitë e tij ose cenueshmërinë e Elbasanit ndaj risqeve, edhe risqet do të shënoheshin si: "*Nevojitet hulumtim/kuptim i mëtejshëm*".

Sidoqoftë, vlerësimi hasi kufizimet e mëposhtme:

- Pikëzimi i risqeve u bazua te provat e mbledhura në dispozicion dhe te gjykimi i palëve të interesuara që morën pjesë në workshop. Vlerësimi i hollësishëm sasior i secilit risk më vete ishte përtej objektit të këtij projekti.
- Kategorizimi i përgjigjeve të secilës bashki bazohen te vlerësimi në shkallë të gjerë dhe të bazuar në fakte, megjithëse ky sistem kategorizimi është deri diku subjektiv dhe duhet të përdoret me kujdes. Të gjitha risqet paraqesin kërcënim për secilën bashki dhe për këtë arsye të gjitha risqet duhet të merren parasysh në planet e përshtatjes; ky vlerësim synon vetëm të udhëzojë lidhur me dhënien e përparësisë. Për më tepër, disa përgjigje kërkojnë vite për t'u zbatuar, duke e detyruar secilën bashki t'i rivlerësojë rregullisht këto risqe.
- Në shumë bashki duhet ende të zbatohen ndryshimet institucionale për të rritur përgatitjen e sistemeve të shumta të qyteteve në kuadër të përmbytjeve ose goditjeve të tjera. Përgatitja për raste emergjence mund të përmirësohet përmes planifikimit më të mirë, sistemit të informacionit për risqet dhe administrimit të transportit. Bashkitë duhet të punojnë për hartimin e vlerave bazë për shkarkimet dhe të zbatojnë ndryshimet me qëllim përputhjen me një buxhet të shkarkimeve të gazeve serë sipas një skenari të ndryshimeve klimatike të ngrohjes me 1,5° C për deri në vitin 2100.

6.4 Analiza sektoriale dhe mundësitë për Bashkinë Elbasan

Gjatë hartimit të bazës fillestare për Bashkinë Elbasan janë marrë parasysh të dhënat e mëposhtme:


1. Konteksti demografik, socio-ekonomik dhe mjedisor i bashkive për të kuptuar ndikimet dhe përparësitë e mundshme për bashkinë;
2. Ngjarjet e shkuara klimatike;
3. Prirjet e ndryshimeve klimatike dhe skenarët e ardhshëm, si dhe hulumtimin mbi mundësitë, pasojat, shpeshitë dhe ndikimet e secilit lloj rreziku mbi njerëzit dhe sektorët;
4. Identifikimi i mënyrës dhe vendndodhjes së ndikimit të rreziqet klimatike në bashki, sektorë dhe asete;
5. Identifikimi i risqeve me përparësi, bazuar te ekspozimi, ndjeshmëria, ndërvarësia dhe cenueshmëria.

Analiza e dokumentacionit u krye për të identifikuar sektorët mbizotërues në bashki ku rreziqet e identikuara do të kishin ndikim të rëndësishëm. Ky ishte shqyrtimi fillestar paraprak i sektorëve. Lista përfundimtare e sektorëve u paraqit në Tabelën 6.2.

Tabela 6.1 _ Qasja ndaj grupimit sipas sektorëve

Furnizimi me ujë	Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta	Trajtimi i ujërave të ndotura
Transporti dhe lëvizshmëria	Shëndeti publik, siguria dhe higjiena	Turizmi
Ndërtesat	Financa	Energjia
Bujqësia	Biodiversiteti	TIK-u

Tabela6. 2_ Vlerësimi Përfundimtar Sektorial për bashkitë



6.4.1 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar

Ky seksion përmbledh faktet lidhur me **risqet dhe mundësitë kyçe që ndryshimi i klimës sjell në Bashkinë Elbasan**. Ai përqendrohet te shëndeti dhe mirëqenia, si dhe te risqet për mjedisin e ndërtuar. Ai mbulon risqet dhe mundësitë për komunitetet, përfshirë ndërtesat e banimit, si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike te shërbimet kryesore publike, përkatësisht te arsimi, shëndeti dhe kujdesi social.

6.4.1.1 Risqet nga temperaturat më të larta

Ky seksion synon të ndihmojë bashkinë me identifikimin se ku është ekspozimi më i madh ndaj nxehtësisë të banorët e saj. Informacioni mund të përdoret për të kuptuar më mirë natyrën hapësinore të risqeve, për të ndihmuar Elbasanin të kuptojë riskun e vet dhe për të ndihmuar në dhënien përparësi të përshtatjes ndaj nxehtësisë.

Tabela6. 3_ Përmbledhje e risqeve ndaj shëndetit dhe komuniteteve nga temperaturat e larta të verës dhe pikëzimi përkatës

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Komente
Risqet për cilësinë e ajrit	I lartë Monitoroni riskun	Qyteti ndikohet nga ndotja industriale e ajrit. Problematike për shkak të prodhimit të çelikut dhe kromit metalurgjik, si dhe grimcave që rezultojnë në ajër. Dyfishimi i pronësisë së makinave që nga vitet 1990 ka shkaktuar ndotje të ajrit/NOx. Sëmundje të dukshme të shkaktuara nga ajri dhe temperaturat ekstreme, të cilat sjellin sëmundje të frymëmarrjes. Prania e industrisë së rëndë pranë zonave urbane, industrisë së metalurgjisë/emetimeve të gazit.
Risqet për arsimin nga temperaturat e larta të verës	I ulët Monitoroni riskun – nevojiten më shumë kërkime	Kërkesa për të menaxhuar në mënyrë efektive sipërfaqet e gjelbra. Kërkohen më shumë të dhëna.
Risqet ndaj shëndetit dhe mirëqenies nga temperaturat e larta të verës	Mesatare Monitoroni riskun	Uzinat e metalurgjisë – vendosja e mureve të gjelbra brenda zonave ku industria duhet të ketë ndikim. Konsultimi publik është i vazhdueshëm dhe shumë i dobishëm.
Risqe për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe social si pasojë e temperaturave të larta të verës	Mesatare Monitoroni riskun dhe ndikimin e përdoruesit	Elbasani po përqendrohet te gjelbërimi i zonave rurale në Elbasan për të ndikuar pozitivisht te ndotja. Kërkohen investime shtesë dhe monitorim aktiv.
Risqet ndaj kërkesës për energji në godina për shkak të rritjes së temperaturës	I ulët Monitoroni riskun dhe ndikimin e përdoruesit	Nuk ka gjasa të ndodhë deri në fund të këtij shekulli.

Temperaturat më të larta të verës dhe shtimi i valëve të të nxehtit paraqesin risqe të shumta ndaj shëndetit. Këto risqe shëndetësore prekin drejtpërdrejt komunitetet dhe individët, të cilat njëkohësisht rrisin në mënyrë direkte dhe indirekte presionin mbi shërbimet e kujdesit shëndetësor.

- Valët e të nxehtit mund të rezultojnë në rritje të vdekshmërisë, veçanërisht tek të moshuarit. Sëmundjet e lidhura me nxehtësinë janë të rrezikshme për shëndetin e komuniteteve të cenueshme, për ata që vuajnë tashmë.
- Sëmundja e lidhur me nxehtësinë përfshin goditjen nga nxehtësia, stresin nga nxehtësia, ose përkeqësimin e gjendjeve shëndetësore të mëparshme. Në Elbasan, individët e moshuar janë më të prekshëm nga nxehtësia.
- Temperaturat më të larta mund të ndërveprojnë gjithashtu me cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat urbane, duke sjellë edhe në këtë raste ndikime shëndetësore.
- Në këtë kuadër nevojiten fakte të mëtejshme për moshën e godinave dhe materialet e ndërtimit, llojet dhe vëllimet e veshjes së fasadave të godinave dhe alternativat / disponueshmërinë e ventilimit.

6.4.1.2 Mundësitë lidhur me ngritjen e temperaturave

Ky seksion ndihmon në identifikimin se ku është ekspozimi më i lartë ndaj nxehtësisë të banorët/komunitetet e Elbasanit. Informacioni mund të përdoret për të kuptuar më mirë natyrën hapësinore të risqeve, për të ndihmuar Elbasanin të kuptojë riskun e vet dhe për të ndihmuar në dhënien përparësi të përshtatjes ndaj nxehtësisë.

Tabela 6. 4_ Mundësitë e identifikuara që vijnë si pasojë e rritjes së temperaturave gjatë verës dhe dimrit

Mundësia	
Mundësia e kërkesës për energji nga familjet gjatë dimrit.	Mundësi investimi me energji të rinovueshme/diellore. Ka gjasa që kërkesa për ngrohje në të ardhmen të ulet për shkak të ndryshimeve klimatike dhe dimrit më të ngrohtë.
Mundësi për shëndet dhe mirëqenie për shkak të dimrave më të ngrohtë.	Përfitimet e shëndetit fizik dhe mendor nga rritja e aktivitetit fizik, veçanërisht aktiviteti në natyrë në zonat malore.

6.4.1.3 Risqet nga shtimi i reshjeve

Tabela 6.5_ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e reshjeve

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Komente
Risqet ndaj ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe social (infrastruktura fizike dhe funksionimi) në kuadër të përmbytjeve.	Mesatare Kërkohen monitorime	Nuk parashikohet akses i te infrastrukurat e kujdesit social (qendra shëndetësore, qendra komunitare etj.) Asnjë spital nuk ndodhet brenda hartave të shtrirjes së përmbytjeve (ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe bregdeteve). Ka disa kirurgë dhe ofruer të tjerë të kujdesit social, akses i të cilëve mund të ndikohet. Qyteti është ndërtuar në një terren që ka 19 metra diferencë në nivele (nga veriu në pjesët jugore të qytetit) mbi nivelin e detit. Nga reshjet e dendura të shiut, uji grumbullohet në zona/lagje që sjell rritje të përmbytjeve.
Risqet ndaj shëndetit dhe mirëqenies së individëve nga përmbytjet.	I lartë Nevojiten veprime	Përmbytjet ndodhin aktualisht në prona dhe biznese dhe priten të shtohen. Është e rëndësishme të merren parasysh mënyra të reja për mbështetjen e individëve të prekur. Rritja e intensitetit të përmbytjeve mund të ndikojë te kushtet e jetesës së banorëve, veçanërisht në zonat rurale/malore. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve të kullimit. Marrja e më shumë informacioneve për komunitetet ka ndihmuar në uljen e ndikimit.
Risqet për arsimin nga përmbytjet.	Mesatare Nevojiten veprime	Veprimet kërkohen për shkollat në zonat e përmbytura, madje disa plane duhet të zbatohen për nxënësit e zhvendosur (6 shkolla filllore dhe çerdhe në zonën e përmbytjeve).
Rritja e lagështisë dhe kondensimit në banesa si pasojë e përmbytjeve	Mesatare Nevojiten më shumë hulumtime	Risqet e mundshme nga përmbytjet përfshijnë ndikimin në lagështi dhe kondensim të banesat e reja. Duhet më shumë hulumtime për të kuptuar pranimin aktual të këtij risku. Kohët e fundit, shmangia e ndërtimeve në zonat e riskuara nga përmbytjet. Shtëpitë nuk po ndihmohen dhe risqet po zvogëlohen për shkak të menaxhimit të sistemeve të kullimit.

Përmbytjet dhe problematikat e lidhura me to mund të kenë ndikime serioze dhe afatgjata në shoqëri

dhe shëndetësi. Gjithashtu përmblytet mund të kenë ndikim shkatërrimtar mbi shërbimet kyçe, si ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe social dhe arsimit.

6.4.2 Infrastruktura

Ky seksion përmbledh faktet lidhur me risqet dhe mundësitë kryesore që ndryshimi i klimës sjell në infrastrukturën e Bashkisë Elbasan kur merren në konsideratë disa lloje kryesore të infrastrukturës, si ajo ujore, energjetike, e transportit dhe sistemeve të TIK-ut.

6.4.2.1 Risqet dhe mundësitë për infrastrukturën nga temperaturat më të larta në verë

Temperaturat e parashikuara në Elbasan për pjesën e mëvonshme të shekullit paraqesin risqe të shumta për infrastrukturën bashkiake.

Tabela 6.6 _ Risqet në shëndet dhe komunitet nga rritja e temperaturave

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risku për energjinë nga temperaturat e larta. Përfshirë uljen e prodhimit.	Mesatare Monitoroni riskun	Kërkesa për të monitoruar dhe planifikuar riskun, pasi mund të zhvillohet me shpejtësi nga mesi deri në fund të shekullit. Dështimet e energjisë elektrike ndikojnë te shumë sisteme të ndërlidhura.
Risqet për transportin nga temperaturat e larta.	I ulët	Studimi inteligjent i transportit solli sigurimin e transportit publik shtesë për muajt e verës. Kjo ka shtuar shpeshësinë dhe cilësinë e shërbimit. Sistemi i emergjencës në vend për të riparuar problemet me rrjetin rrugor.
Risqet për argjinaturat e tokës (pra digat) nga temperaturat e larta.	I ulët Monitoroni riskun	Kërkohet rishikim i vazhdueshëm.

- Rritja e temperaturave në verë ka mundësi të shkaktojë rritje të kërkesës për energji për t'u ftohur;
- Temperaturat e larta mund të ndikojnë drejtpërdrejt sistemet e energjisë, duke ulur prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet dhe duke rritur mundësinë e avarive në rrjet.

6.4.2.2 Mundësia lidhur me ngritjen e temperaturave në verë dhe dimër

Tabela 6.7 _ Mundësitë e identifikuara për infrastrukturën

Mundësia	
Rritja e mundësisë për energji diellore	Temperatura më e lartë mund t'i bëjë format e tjera të energjisë së qëndrueshme më tërheqëse, siç është energjia termike fotovoltaike/diellore. [Planet e subvencionimit për instalimin e paneleve diellore (deri në 70%) të mbështetura nga GIZ dhe nisma e bashkisë]
Rritja e mundësive për transport të qëndrueshëm, lëvizshmëri inteligjente dhe udhëtim aktiv	Rritja e mundësive për investime në korsinë e biçikletave për të promovuar udhëtime më aktive. Përmirësimi i sinjaleve për transport, për të reduktuar ndotjen.

6.4.2.3 Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve

Tabela 6.8 _ Risqet për infrastrukturën nga ndryshimet e reshjeve

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risqet për rrjetet e infrastrukturës nga përmbytjet e lumenjve dhe ujërave sipërfaqësore.	Mesatare Nevojiten veprime	Ndërtimi i paligjshëm i objekteve në anën perëndimore të bashkisë ka dëshmuar përmbytje të shtuara në këtë afërsi, që ka riskuar banesat e reja. Përmbytjet në pjesët perëndimore kanë sjellë mbeturina. Terreni kodrinor ka shtuar risqet për infrastrukturën.
Ekziston mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së lumit Shkumbin për shkak të depozitimeve të ngurta nga përmbytjet dhe pengesat fizike, përkatësisht e HEC-eve në degët e tij.	I ulët Rishikim i vazhdueshëm	Aktualisht, 7 HEC-e punojnë, 9 janë në ndërtim dhe mbi 54 të tjerë janë planifikuar në lumin Shkumbin dhe degët e tij, të vendosura jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë (sipas riverwatch.eu). Depozitat e ngurta të ardhura nga përmbytjet e shpeshta mund të shkaktojnë probleme shtesë në përmbytje.
Risqet për urat dhe tubacionet nga përmbytjet dhe erozioni.	I ulët Rishikim i vazhdueshëm	Ekipet e bashkisë janë gati për të lehtësuar risqet ndaj urave, të cilët kanë krijuar procedura
Risqet për rrjetet infrastrukturore (ujore, energjetike, të transportit, TIK-ut) nga avaritë e shkaktuara si pasojë e përmbytjeve.	Mesatare Nevojiten veprime	Ekipet e bashkisë janë gati për të lehtësuar risqet ndaj telekomunikacionit / sistemeve të energjisë, të cilët kanë krijuar procedura Për shkak të gjeologjisë, infrastruktura në disa zona (Gjinar, Labint-Mal, Funar, Gracen, Papër, Shushicë dhe Zavalinë) ka mundësi të jetë nën risk të madh për shkak të reshjeve të dendura që mund të shkaktojnë rrëshqitje dherash, degradim të tokës dhe erozion të tokës.
Risqet për rrjetet e transportit dhe infrastrukturës nga pjerrësia dhe dëmtimi i argjinaturës.	Mesatare Nevojiten veprime	Erozioni, rrëshqitja e tokës dhe rrëshqitja nga argjinaturat në zonat më malore të infrastrukturës vendore. Risk mesatar lidhur me zonat malore. Risk mesatar (jo i madh) pasi dëmtimet riparohen në kohë reale
Risk për infrastrukturën nëntokësore dhe sipërfaqësore nga fundosja.	I ulët	Rritje të reshjeve, me breshëri që zgjasin pak në kohë.
Risqet për furnizimet publike me ujë nga disponueshmëria dhe cilësia e reduktuar e ujit.	Mesatare Monitoroni riskun	Rezervuarët e ujit jashtë qytetit janë në nivel mesatar risku dhe disponueshmëria e ujit duket se përdoret për ujitjen e tokës.

- Efekti i përgjithshëm i ndryshimeve klimatike është rritja e sipërfaqes së prekur nga përmbytjet e lumenjve.
- Pyjet në Elbasan janë shfrytëzuar gjerësisht. Duke pasur parasysh zonat malore, shumica e infrastrukturave të transportit varet nga zgjidhjet e projektuara sikurse argjinaturat dhe prerjet e shpateve, të cilat mund të dështojnë nëse i nënshtrohen përmbytjeve ose reshjeve të shumta e të vazhdueshme.
- Rrugët kryesore janë në risk përmbytjeje, ndërsa linja hekurudhore Elbasan-Pogradec nuk ka shumë ndikim. Infrastrukturë tjetër në risk nga përmbytjet janë sistemet e kullimit. Megjithatë, edhe rrugët në fshat, të cilat qëndrojnë nën rrezet e diellit gjatë gjithë ditës, mund të jenë të pambrojtura gjatë muajve të verës.
- Vera më e thatë mund të ndikojë te nivelet e ujërave nëntokësore dhe te furnizimi me ujë i puseve private. Reshjet e reduktuara së bashku me rritjen e temperaturave mund të shkaktojnë thatësi

në verë. Kjo mund të jetë njëfarë risku për Elbasanin. Ky ndryshim mund të vendosë nën stres furnizimet me ujë.

6.4.3 Biznesi (përfshirë turizmi, bujqësia dhe pylltaria)

Gjetjet e Raportit të Analizës së të Dhënave Bashkiake⁵⁰ paraqesin mungesë të dhënash nëpër sektorë, veçanërisht në sektorin tregtar dhe atë të banimit.

Ky seksion shqyrton se si ndryshimi i kushteve klimatike do të ndikojnë te biznesi dhe industria e Elbasanit. Fokusi është kryesisht te risqet dhe mundësitë kryesore, që rrjedhin direkt dhe indirekt nga ndryshimet klimatike. Megjithatë, edhe risqet ndërkombëtare të zinxhirëve të furnizimit janë të mbuluara. Seksioni përmbledh risqet dhe mundësitë e përgjithshme për biznesin dhe industrinë. Për më tepër, ai ofron një diskutim më të detajuar të risqeve specifike për bujqësinë (përfshirë pylltarinë) dhe turizmin. Këta sektorë ekonomikë shikohen si kryesorë për ekonominë e Bashkisë Elbasan, të cilat ndikohen drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike.

6.4.3.1 Risqet për biznesin nga temperaturat dhe reshjet e rritura dhe të ulëta

Tabela 6.9 _ Risqet e identifikuara për biznesin nga temperaturat më të larta

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Rritja e kostove në verë për shkak të energjisë për ftohje.	Mesatare Monitoroni riskun	Ndikimi edhe te industritë e ndërtimit për shkak të rritjes së temperaturave, duke shkaktuar më shumë turne gjatë natës. Për shkak të temperaturave ekstreme, edhe produktivitet më i ulët në sektorin e metalurgjisë gjatë muajve të verës. Bizneset mbështeten te ajri i kondicionuar gjatë muajt e verës, por presin pak kosto shtesë pasi sistemet janë tashmë të vendosura. Temperaturat më të larta ndikojnë te të ardhurat e bizneseve për shkak të kërkesës shtesë për ftohje.
Risqet për biznesin nga përmbytjet.	Mesatare Monitoroni riskun	Rishikimi i bizneseve që ndodhen pranë çdo zone të ndjeshme ndaj përmbytjeve. Bashkia po merr masa për lehtësimin e riskut nga përmbytjet në zonat pranë lumenjve duke ulur zonat e përmbytura.
Risqet për bizneset nga mungesa e ujit	I lartë Nevojiten veprime	Oraret në dispozicion të furnizimit janë zvogëluar për shkak të disponueshmërisë së ulët të burimeve ujore. Oraret e nxënësve në shkollë janë ulur për shkak të temperaturave dhe kjo ka ndikuar te bizneset për shkak të nevojave për kujdesin e fëmijëve.
Risqet për biznesin nga ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit dhe rrjeteve të shpërndarjes.	I lartë Monitoroni riskun	Ndryshimet klimatike përkeqësojnë shpeshtësinë dhe seriozitetin e ngjarjeve ekstreme atmosferike, përfshirë uraganet, përmbytjet, thatësitrat, ngrirjet dhe zjarret. Këto ngjarje mund të bëjnë kërdi në infrastrukturë, mund të prishin rrjetet e transportit dhe të rrezikojnë burimet jetike. Këto lloj ndërprerjesh rrjedhin nga zinxhirët e furnizimit, pasi ndërprehen proceset e fabrikimit, prodhimit dhe shpërndarjes, duke rritur kështu kostot e materialeve dhe çmimet e produkteve, si dhe duke ulur të ardhurat e korporatës. Duke pasur parasysh risqet në rritje të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, zinxhirët e furnizimit duhet t'i japin përparësi aftësive

⁵⁰ Projekti UNDP-PKP, Raporti mbi "Analizën e Integruar të të Dhënave, Gjetjeve dhe Rekomandimeve: Dinamika demografike, profilet ekonomike dhe treguesit e klimës në bashkitë shqiptare" (nëntor 2023)

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
		ripërtëritëse dhe përshtatshmërisë për të përballuar sfidat e ardhshme.
Risku nga rritja e kostove për shkak të rritjes së çmimeve të lëndës së parë dhe infrastrukturës	I lartë Nevojitet mirëkuptim	Tëksa ndryshimi klimatik përkeqësohet, ndikimi i tij ekonomik rritet, duke prekur burimet ujore, bujqësinë, turizmin dhe pasuritë e paluajtshme. Ekspertët paralajmërojnë se edhe rritjet e vogla të temperaturave globale do të shkaktojnë dëm të konsiderueshëm ekonomik. Për shembull, një rritje prej 1°C mund të dyfishojë dëmin ekonomik për një rritje prej 0,5°C.
Risku nga rritja e çmimeve të sigurimeve	I lartë Nevojitet mirëkuptim	Ndryshimet klimatike janë pjesërisht përgjegjëse për rritjen e primeve të sigurimit kohët e fundit. Madje, kostot do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen. Ndryshimet klimatike mund të shkaktojnë stuhi, nxehtësi ekstreme, përmytje dhe katastrofa të tjera. Siguruesit po ia kalojnë kostot në rritje të dëmeve të pagesave konsumatorëve.
Risku nga zvogëlimi i kapacitetit prodhues	I lartë Nevojitet mirëkuptim	Gjatë temperaturave jashtëzakonisht të larta, çmimet e energjisë elektrike prirën të rriten, ndërsa gjatë të ftohtit ekstrem, çmimet e furnizimit me ujë mund të ulen, duke ndikuar kështu te kostot e prodhimit të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet duhet të investojnë te masat shtesë të ajrit të kondicionuar dhe të kontrollit të temperaturës për t'i zbutur këto efekte, duke rritur kështu shpenzimet operationale. Gjatë temperaturave ekstreme, çmimet e ngritura të energjisë elektrike rritin më tej kostot e prodhimit, duke ndikuar negativisht në rrjedhën e parasë dhe kapacitetin operational. Në fund të fundit, ndryshimi klimatik zvogëlon produktivitetin e punonjësve, rrit konsumin e energjisë dhe rrit shpenzimet administrative, duke dëmtuar aftësinë e shitjeve të ndërmarrjeve.

- Temperaturat shumë të larta kanë të ngjarë të ndikojnë te shëndetin, mirëqenia dhe produktiviteti i punonjësve gjatë ngjarjeve ekstreme të nxehtësisë. Disa punë në natyrë (sidomos ndërtimi) mund të duhet të ndërpriten nëse ka temperatura ekstreme për të siguruar punonjësit, pasi rrezikohen prej goditjes nga dielli.
- Reduktimi i parashikuar i reshjeve në verë mund të sjellë risqe edhe për bizneset. Mungesa e ujit mund të prishë vazhdimësinë e biznesit, veçanërisht në sektorë që i nevojitet uji, sikurse ushqimi dhe pijet.
- Rreziqet klimatike, të tilla si reshjet e dendura, përmytjet e ujërave sipërfaqësore dhe temperaturat e larta, janë llojet e motit që mund të shkaktojnë numrin më të madh të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit që lidhen me motin. Këto sjellin ndikime negative te bizneset, të cilat nuk janë në gjendje të vazhdojnë prodhimin e produkteve apo ofrimin e shërbimeve. Çmimet e energjisë elektrike (furnizimit me ujë) do të rriteshin (uleshin) në temperatura jashtëzakonisht të larta, gjë që do të rriste kostot e prodhimit të ndërmarrjeve. Për të mbajtur temperaturat në vendin e punës në një nivel të përshtatshëm gjatë temperaturave shumë të larta ose shumë të ulëta dhe për të zvogëluar ndikimin te prodhimi dhe operimi, ndërmarrjet duhet të rrisin shpenzimet e tyre për ajër të kondicionuar, përveç sigurimit të furnizimeve për ftohje ose ngrohje për departamentet e tyre të prodhimit dhe menaxhimit. Çmimet e energjisë elektrike mund të rriten gjatë temperaturave ekstreme, të cilat rrisin më tej kostot e prodhimit dhe menaxhimit. Kostot më të larta të menaxhimit të temperaturës reduktojnë fluksin e parave të ndërmarrjeve dhe ndikojnë negativisht te prodhimi i brendshëm dhe aktivitetet operative. Me pak fjalë, ndryshimi klimatik zvogëlon produktivitetin e punonjësve dhe rrit konsumin e energjisë, kostot e prodhimit dhe shpenzimet administrative, të cilat zvogëlojnë

prodhimin dhe kapacitetin operacional të ndërmarrjeve dhe në fund ndikojnë negativisht te aftësia e shitjes.

6.4.3.2 Mundësitë për biznes

Tabela 6.10 _ Mundësitë për biznes

Mundësia	
Mundësitë për biznes nga ndryshimet e kërkesës për mallra dhe shërbime	Moti më i ngrohtë që pritet të shkaktohet nga ndryshimet klimatike në Elbasan, mund të sjellë disa përfitime për biznesin, për shembull kosto më të ulëta të ngrohjes në dimër për ata që janë në ambiente të mbyllura.

6.4.3.3 Risqet dhe mundësitë për bujqësinë dhe turizmin

- Reshjet e dendura/breshëritë kanë ndikim te prodhimet bujqësore, veçanërisht te bimët e ullirit dhe të qershisë. Këto reshje, së bashku me mungesën e burimeve ujore për vaditje kanë sjellë sfida të mëdha bujqësore.
- Një sistem sinjalizimi dhe njoftimi i shërbimeve emergjente është vendosur nga bashkia në rast zjarri për shkak të thatësisë.
- Kërcënimi më i spikatur për biznesin në Elbasan është ndikimi i temperaturave të larta. Nga ana tjetër, temperaturat e larta ofrojnë më shumë mundësi për bizneset në industrinë e turizmit.
- Procesi i ujitjes në fshatra është në nivel individual, që do të thotë se ka pak ujë në dispozicion për puset e reja që po zhvillohen.
- Mundësitë mund të krijohen për turizmin për shkak të ndryshimit të temperaturave të verës dhe dimrit, si dhe për bizneset që synojnë ekonominë e gjelbër.
- Risqet e zinxhirit të furnizimit nuk kuptohen nga bizneset në Elbasan, por ato parashikohet të kenë ndikim minimal në biznes për shkak të afërsisë me Tiranën.
- Departamenti i Bujqësisë ka ofruar udhëzime për fermerët që të shmangin risqet e temperaturës së lartë (për shembull - udhëzime dhe subvencione financiare për ndërtimin e serave të qelqit)
- Megjithatë, mundësitë ekzistojnë: sektorët e bujqësisë, shërbimeve dhe turizmit demonstrojnë rritje të qëndrueshme dhe potencial për zgjerim të mëtejshëm, duke treguar mundësi të qëndrueshme investimi.

6.4.3.4 Industrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit

Risqet dhe mundësitë shtesë përfshijnë:

- Rritjen e temperaturave dhe temperaturave të akumuluar, si dhe përhapjen e thatësirave, të cilat kanë mundësi të ndikojnë te cilësia e tokës së punueshme dhe rendimentet e prodhuara. Me rritjen e temperaturave, ka mundësi që të korra dhe specie të reja të zhvillohen, duke rritur kështu produktivitetin bujqësor dhe pyjor. Risqe të tjera përfshijnë organizmat që ndikojnë dhe infektojnë këta sektorë.
- Nëse nuk menaxhohen siç duhet, bujqësia dhe pylltaria mund të ndikojnë te përmbytjet; në zonat ku është larguar bimësia, rrjedha e ujit nuk ngadalësohet më në mënyrë aq efektive. Risku nga përmbytjet lumore ka mundësi të rritet. Madje, një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore është ndikuar tashmë ose është në risk në të ardhmen.

- Rritja e reshjeve rrit mundësinë e përhapjes me lehtësi të ndotësve sikurse azoti, që vijnë nga plehëruesit. Për më tepër, erozioni dhe degradimi i tokës përbëjnë risk të madh për shpyllëzimin.
- Thatësitrat gjatë verës mund të kufizojnë përdorimin e kullotave malore për praktika të gjera blegtorie dhe mund të rrisin riskun e zjarreve.
- Ka reduktim të zjarreve në pyje pasi menaxhimi në sezonin e nxehtë është përmirësuar. Sfida kryesore është vënia shpesh me qëllim e këtyre zjarreve pyjore. Në vitin 2022, zjarret e pyjeve në Elbasan dogjën 100 ha tokë. Zjarret shkaktohen nga njerëzit dhe mund të përhapen nga kushtet e motit, përfshirë motin e nxehtë dhe të thatë. Nxehtësia ekstreme së bashku me thatësitë mund të ndikojë edhe te zjarret në pyje.

6.4.3.5 Gjetjet e turizmit

Turizmi është shumë i rëndësishëm për Elbasanin.

- Elbasani i kushton një rëndësi të madhe turizmit kulturor. Madje, pavarësisht temperaturave të larta (maj-shtator), Elbasani pati një dyfishim të turistëve që vizitonin monumentet dhe trashëgiminë kulturore. Elbasani ka pasur ndryshime edhe në turizmin shëndetësor nga muajt e verës në ato të dimrit.
- Ndryshimi i klimës mund të paraqesë mundësi për aktivitete në natyrë, duke nxitur më shumë turistë që të vizitojnë bashkinë gjatë këtyre stinëve. Konkretisht, për Elbasanin të ardhurat mund të arrihen nga shërbimet turistike dhe hapësirat e jashtme.
- Në agroturizëm dhe në turizmin rural, reshjet e dendura, sidomos në stinët e ndërmjetme, do të ndryshojnë pushimet dhe kontakti me natyrën do të bëhet gjithnjë e më i vështirë për shkak të pamundësisë për të pasur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe kufizimit të ndarjes nga punët e fermerit. Këtyre i shtohet edhe fakti se klima e lagësht shton insekte të llojeve të ndryshme, ndaj të cilave turistët janë përgjithësisht të frikësuar dhe për këtë arsye tërheqja ndaj këtij lloji turizmi sigurisht që zvogëlohet.
- Bashkia ka marrë masa për grumbullimin e mbetjeve/herët kur hotelet duhet të depozitojnë mbetje gjatë periudhave të verës. Turistët rrisin mbetjet urbane.

6.4.4 Risqet për natyrën

Ndryshimet klimatike do të ndikojnë edhe te mjedisin natyror në të gjithë Bashkinë Elbasan.

Habitatet dhe speciet do të vuajnë ose do të përfitojnë në varësi të ndryshimeve klimatike, por jo vetëm. Disa faktorë të tjerë mund të jenë shpërndarja bioklimatike, konkurrenca ndërmjet specieve, presionet në përdorimin e tokës dhe ndërlidhja ekologjike.

6.4.4.1 Risqet dhe mundësitë për speciet tokësore brenda Bashkisë Elbasan

Tabela 6.11 _ Risqet e identifikuar për speciet tokësore brenda Elbasanit dhe pikëzimi

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risqet nga ndryshimi i kushteve klimatike dhe ngjarjet ekstreme atmosferike: Ndryshimet në temperaturë	I lartë Duhet të merren masa dhe të kuptohen më mirë risqet specifike Nevojitet më shumë	Pyjet artificiale, veçanërisht pishat, shpesh veprojnë si lëndë djegëse për zjarrin dhe ndikojnë ekosistemin. Përbërja e ndryshme e specieve mund të kërkohet për të reduktuar risqet e zjarreve në pyje. Sëmundjet ose organizmat e dëmshëm janë aktualisht të pranishëm në zonë; Tenja procesionare e pishës (<i>Thaumetopoea pityocampa</i>), kanceri i

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
	mirëkuptim	rrapit (<i>Ceratocystis platani</i>), mola e pemës (<i>Cydalima perspectalis</i>), kanceri i gështenjës (<i>Cryphonectria parasitica</i>), grenza e tëmthit të gështenjës (<i>Dryocosmus kuriphilus</i>) si rezultat i temperaturave të larta, duke ndikuar kështu te ekosistemet dhe bujqësia / blegtoaria.
Risqet nga ndryshimi i kushteve klimatike dhe ngjarjet ekstreme atmosferike: Ndryshimet në Reshje	I lartë Nevojiten veprime Nevojitet më shumë mirëkuptim	Pemët në Elbasan kërcënohen nga insektet (shembull janë sëmundjet e pishës), të cilat e bëjnë më të vështirë lulëzimin e bimëve. Krahas insektit (<i>Cydalima perspectalis</i>), edhe shkurret përgjatë luginës së Shkumbinit janë tharë dhe prishur, ndërsa pemët janë të kërcënuara nga mungesa e ujit. Gjeologjia në disa zona (Gjinar, Labinot-Mal, Funar, Gracen, Papër, Shushicë dhe Zavalinë) përfaqëson zona në risk të madh për shkak të reshjeve të dendura që mund të shkaktojnë rrëshqitje dherash, degradim të tokës dhe erozion të tokës.
Risqet nga ndryshimi i kushteve klimatike dhe ngjarjet ekstreme atmosferike: Nga ngjarjet e stuhive	I lartë Nevojiten veprime Nevojitet më shumë mirëkuptim	Rritja e shpeshtësisë dhe intensitetit të ngjarjeve ekstreme të stuhisë do të ndikonte te speciet tokësore, veçanërisht te speciet e pemëve të kultivuara (pishat mesdhetare dhe të zeza).
Risqet për speciet dhe habitatat tokësore nga organizmat e dëmshëm dhe patogjenët, përfshirë speciet invazive të huaja	I lartë Nevojiten veprime Nevojitet më shumë mirëkuptim	Nevojitet ta kuptojmë më mirë këtë lloj kërcënimi. Nevojitet ta kuptojmë më mirë këtë lloj kërcënimi. Të kuptojmë se çfarë është e cenueshme dhe cilët prej organizmave të dëmshëm/patogjenë ka mundësi të jenë kërcënim i madh. Mundësitë janë shumë të pasigurta dhe të vështira për t'u shënuar pasi ndryshimi klimatik është një nga shumë faktorët që sjellin këtë risk.

Tabela 6.12 _ Mundësitë për speciet tokësore

Mundësia	
Mundësi për kolonizimin e habitateve tokësore nga speciet e reja.	Mundësi për rritjen pozitive të bimëve mjekësore pa kujdesin e njeriut

6.4.4.2 Risqet dhe mundësitë për tokat dhe për speciet e ujërave të ëmbla

Tabela 6.13 _ Risqet e identifikuar për tokat, rezervat e karbonit dhe speciet e ujërave të ëmbla

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risqet për tokat nga ndryshimi i kushteve klimatike, përfshirë thatësinë sezonale dhe lagështinë.	I lartë Nevojiten veprime	Reshjet e rënda po ndikojnë te cilësia e tokave (për shkak të degradimit të tokës dhe erozionit të tokës). Disa bimë po ndikojnë te erozioni dhe cilësia e tokës.
Risqe dhe mundësi për rezervat e karbonit natyror, sekuestrimin e karbonit dhe emetimet e GS nga ndryshimi i kushteve klimatike, përfshirë ndryshimin e temperaturës dhe mungesën e ujit.	I lartë Nevojiten veprime	Ky risk është i lartë për shkak të rëndësisë së tokës si për biodiversitetin, ashtu edhe për bujqësinë dhe ruajtjen e karbonit.
Për shkak të ndryshimeve të kushteve klimatike dhe ngjarjeve ekstreme, speciet dhe habitatat e ujërave të ëmbla rrezikohen edhe temperaturat e të larta të ujit, përmytjet dhe erozioni i brigjeve, mungesa e ujit dhe ndryshimet	Mesatare Nevojiten veprime	Rritja e temperaturave në ujë ndryshon stinën, pasi temperaturat e ujit janë më të larta në pranverë - para majit - dhe ndërpret mbarëshkrimin e llojeve të peshqve.

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
fenologjike.		
Risqet për speciet dhe habitatet e ujërave të ëmbla nga organizmat e dëmshëm, patogjenët dhe speciet e huaja.	Mesatare	Ky është risk mesatar, pasi rritja e temperaturave do të ndikojë edhe te temperaturat e ujit (speciet e ujit të ëmbël, sikurse peshqit, do të vuajnë nga temperaturat e nxehta dhe reduktimi i burimeve ujore.

Tabela 6.14 _ Mundësitë për habitatet e ujërave të ëmbla

Mundësia	
Mundësitë për habitatet e ujërave të ëmbla nga kolonizimet e specieve të reja mund të përfshijnë:	Verat më të thata dhe më të ngrohta mund të nxisin mbijetesën e sëmundjeve të reja dhe specieve invazive të huaja, të cilat mund të kërcënojnë habitatet dhe speciet.

6.4.4.3 Risqet dhe mundësitë nga ndryshimi klimatik në karakteristikat e peizazhit

Tabela 6.15 _ Risqet nga ndryshimi klimatik në karakteristikat e peizazhit dhe pikëzimi

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risqet nga ndryshimi klimatik në karakteristikat e peizazhit	Mesatare Nevojitet më shumë mirëkuptim	Nevojitet më shumë mirëkuptim në Elbasan lidhur me ndotjen, pasi ndikon te ndotja e ujit të pijshëm. Flora dhe fauna e Elbasanit po ndikohen nga ndryshimet klimatike. Madje shumë specie po zhduken, por jo të gjithë e dinë këtë gjë.

Tabela 6.16 _ Mundësitë për peizazh

Mundësia	
Mundësitë për peizazh	Biodiversiteti i përmirësuar mbështet një sërë shërbimesh të ekosistemit, veçanërisht ato kulturore sikurse zbavitjet (peshkimi dhe kënaqësia e kafshëve të egra).

6.4.5 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Seksionet e mëparshme të vlerësimit të riskut kanë dhënë një panoramë të përgjithshme mbi risqet klimatike me të cilat përballen banorët, bizneset, infrastruktura, mjedisi natyror dhe kultura brenda Bashkisë Elbasan. Ndërsa ky seksion do të ofrojë një panoramë të përgjithshme të risqeve klimatike me të cilat përballen organizata e Bashkisë Elbasan, asetet e saj dhe veprimtaritë e lidhura me to.

6.4.5.1 Risqet për asetet në pronësi të bashkisë ose të mirëmbajtura nga Bashkia Elbasan

Tabela 6.17 _ Risqet e identifikuara për asetet e bashkisë.

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Risqet për bashkitë që mirëmbajnë hapësirat e bashkisë dhe pronat e tyre.	I ulët	Për shkak të rritjes së temperaturave, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë disa procedura. Kështu, fëmijët do të vendosen në katin përdhësë të kopshtit, ku klima është më e freskët. Ndërkohë, objektet janë duke u rinovuar (objektet arsimore dhe spitalet) dhe të gjitha përfshijnë treguesit e klimës.

Risku	Pikëzimi i risqeve dhe Veprimi	Narrativa e riskut
Edhe pronat e Bashkisë Elbasan rrezikohen nga përmytjet.	I lartë	Dëmtimi i zyrave ose pajisjeve mund të shkaktojë probleme në funksionimin normal. Kostot janë të larta për ofrimin e akomodimit alternativ dhe riparimit, si dhe për ndërprerjen e shërbimit të banorët.
Risqe për infrastrukturën rrugore nga përmytjet.	Mesatare	Risqe të ngjashme për seksionin e infrastrukturës.

- Rritja e parashikuar e temperaturave mund të ndikojë te mundësia e mbinxehjes së ndërtesave. Nëse kjo ndodh në ndërtesa brenda kompetencës së bashkisë, do të ketë ndikime të shumta negative, veçanërisht për përdoruesit e cenusshëm. Kjo do të ndikonte te buxheti dhe mirëmbajtja e Bashkisë Elbasan.
- Gjatë verës, kostot e përdorimit të kondicionerëve do të rriteshin, duke sjellë ndërlikime shtesë të dëmshme të aftësia e përgjithshme e bashkisë për reduktimin e emetimeve të karbonit. Për më tepër, banorët e bashkisë kanë mundësi të ndikohen më shumë financiarisht nga kostoja e teknologjive të ajrit të kondicionuar që nevojitet për uljen e temperaturave në shtëpitë e tyre.
- Rritja e dëmtimit në infrastrukturën rrugore nënkupton rritje të kostove të riparimit dhe mirëmbajtjes.
- Rritja e reshjeve dhe përmytjeve mund të kenë një sërë ndikimesh negative te pronat dhe banesat në pronësi dhe në operim të bashkisë. Risk i shtuar për shtëpitë ose ndërtesat e tjera, për shkak të reshjeve më intensive dhe dëmtimeve nga përmytjet. Kostot e regjimit të riparimit dhe mirëmbajtjes do të rriten për shkak të trajtimit të probleme të materialeve të ndërtimit, sikurse rrjedhjet e çatisë, amortizatori i prishjes së ndërtesave dhe përmytjet brenda zonës së ndërtesës.

6.5 Përfundimet

Ky kapitulli ka identifikuar shumë risqe dhe vetëm disa mundësi për Bashkinë Elbasan, të cilat lidhen me ndryshimet klimatike. Sektorët që janë vlerësuar se do të ndikohen përfshijnë:

1. Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar.
2. Infrastruktura.
3. Biznesi dhe industria.
4. Mjedisi natyror.
5. Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.

Për sa i përket risqeve të Bashkisë Elbasan për shkak të ndryshimeve klimatike, janë evidentuar disa cenusshmëri dhe shumë pak mundësi.

- Risqet kryesore të shtëpive ose ndërtesave të tjera, të cilat menaxhohen nga Elbasani, përfshijnë rritjen e temperaturave, duke sjellë kështu verë më të nxehtë dhe më të thatë. Ndikimet klimatike shkaktojnë edhe stuhi më të shpeshta dhe më intensive.
- Vera më e nxehtë dhe më e thatë do të kërkojë instalimin e më shumë teknologjive të ajrit të kondicionuar te shtëpitë ose ndërtesat e tjera.

- Ndryshimi i klimës drejt ekstremeve më dramatike të motit pritet të përbëjë risk për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla, për tokat dhe karakteristikat e peizazhit.
- Ekziston risku që me ngrohjen e klimës, toka të mos jetë në gjendje të ruajë të mënyrë efektive karbonin dhe lëndët ushqyese.
- Rritja e temperaturave dhe reshjeve/përmytjeve ka mundësi të dëmtojë veprimtaritë, shërbimet dhe asetet e Bashkisë Elbasan, në rast se Bashkia Elbasan nuk ndërmerr asnjë masë si rezultat i vlerësimit të riskut klimatik.

Vlerësimi i rrezikut ka konkluzione përfundimtare:

- Nxehtësia ka mundësi të ndikojë në Elbasan pasi temperaturat e verës po rriten dhe valët e të nxehtit po bëhen më të shpeshta dhe ekstreme.
- Sfidat ekzistojnë për sa i përket burimeve më pak të disponueshme ujore, ndikimit të erozionit të tokës dhe rrëshqitjeve të dheut krahas pyjeve të dendura.
- Shumë prej risqeve që has natyra kategorizohen si risqe me ndikim të lartë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka natyra si te turizmi, ashtu edhe te bujqësia e Elbasanit.
- Ndikim do të kenë edhe asetet dhe veprimtaritë e Bashkisë Elbasan, përfshirë aftësinë për të reduktuar emetimet e karbonit nëpërmjet risqeve kalimtare. Miratimi i masave të përshtatjes që në fillim do ta zvogëlonte këtë ndikim.
- U identifikuan disa mundësi: vera më e ngrohtë e më e thatë dhe dimri më i ngrohtë sjellin ndikime pozitive, sidomos për përdorimin e energjisë, shëndetin e njeriut dhe turizmin e veçanërisht për aktivitetet në natyrë. Megjithatë, nëse i baraspeshojmë, risqet e ndryshimeve klimatike janë shumë më të mëdha se mundësitë.

Vlerësimi i mundësive është hapi i parë për krijimin e një plani të integruar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për Bashkinë Elbasan, e cila do të krijojë aftësitë e mëtejshme ripërtëritëse. Hapi tjetër do të jetë përdorimi i vlerësimit të riskut për krijimin e një plani veprimi të përshtatshëm për zbatimin për Elbasanin dhe qytetarët e tij, krahas veprimeve që tashmë janë duke u zhvilluar. Propozohet që vlerësimi i riskut të monitorohet në baza vjetore, pasi me kalimin e kohës risqet nga rritja e temperaturës mund të shtohen.

- Gjatë viteve të ardhshme, duhet të shikohen me përparësi kërkimi ose mbledhja e provave për risqet e theksuara, sikurse "*nevojitet mirëkuptim*". Këto risqe duhet të rivlerësohen kur të ketë më shumë prova.
- Për risqet më të mëdha dhe për ato të kategorizuara si "*veprime të nevojshme*", aktorët kyç të interesit duhet të identifikohen, të edukohen mbi risqet dhe të bashkëpunojnë me organizata të ndryshme për hartimin e planeve të suksesshme për përshtatje.
- Mundësitë janë identifikuar, megjithatë nevojitet më shumë punë për të kuptuar se si këto mundësi mund të optimizohen më mirë.
- Plani i punës duhet të krijohet dhe zbatohet, i cili duhet të përcaktojë veprimet që duhen rishikuar rregullisht, për t'u siguruar se çdo e dhënë e re është përditësuar dhe marrë parasysh. Më vonë, kjo rrjedhë specifike e punës për riskun klimatik duhet të integrohet te strukturat ekzistuese të qeverisjes klimatike brenda Bashkisë Elbasan.
- Palët e interesuara duhet të angazhohen vazhdimisht.

7 Plani Vendor i Veprimit

Ka të dhëna se klima e Elbasanit po ndryshon në përputhje me prirjet globale të ndryshimeve klimatike. Gjatë dekadave të fundit, klima e tokës është ngrohur, niveli i deteve është ngritur, modelet e reshjeve kanë ndryshuar dhe Elbasani është ndikuar nga ngjarjet më të shpeshta, intensive dhe ekstreme atmosferike.

Ndryshimet klimatike kanë pasur ndikime të ndryshme dhe të gjera te burimet ekonomike dhe natyrore të Elbasanit, përfshirë:

- Ndryshime te temperaturat mesatare në të gjitha stinët, me valë të nxehti që priten të ndodhin më shpesh.
- Elbasani mund të preket nga lloje të ndryshme thatësirash, për shkak të ditëve të nxehta dhe valëve të të nxehtit. Këto, së bashku me mungesën e ujit në verë, do të rrisin riskun e organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve të reja.
- Nëse shikojmë në të ardhmen, teksa valët e nxehtësisë do të bëhen më të shpeshta (dhe do të zgjasin më shumë sipas SSP5-8.5), mungesa e ujit në basenin lumor mund të shkaktojë mungesa në rrjedhën sipërfaqësore ose nëntokësore. Derdhjet e lumenjve në pranverë priten të rriten ndjeshëm për shkak të reshjeve dhe disa rrjedhjeve malore.
- Ndryshimi i modeleve të reshjeve do të ndikojë te bujqësia, shëndeti i njerëzve, blegtoria, furnizimi me ujë. Ndërsa, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut dhe erozioni i tokës do të ndërpresin ujitjen e të mbjellave, do të reduktojnë rendimentet dhe do të rrisin pasigurinë ushqimore.

7.1 Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit

Si niveli i qeverisjes më i afërt me komunitetet vendore dhe bizneset vendore, dhe si reaguesi i parë në shumë emergjenca, Bashkia Elbasan është në vendi i duhur për të sjellë ndryshime reale e pozitive lidhur me ofrimin e një të ardhmeje me karbon të ulët dhe me qëndrueshmëri klimatike. Ky Plan Vendor Veprimi, krahas vlerësimit të riskut klimatik të Elbasanit, synon:

- (i) të sigurojë mirëkuptimin e risqeve dhe cenueshmërive kryesore për shkak të ndryshimeve klimatike;
- (ii) të nxjerrë në pah zbatimin e veprimeve me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, në mënyrë të planifikuar dhe proaktive;
- (iii) të sigurojë se konsideratat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike do të përfshihen te të gjitha planet dhe politikat dhe do të integrohen te të gjitha veprimtaritë dhe funksionet e Bashkisë Elbasan.

Ky Plan Vendor Veprimi i shërben Bashkisë Elbasan për realizimin e:

- shërbimit ndaj klientit: me fokus te efektiviteti i biznesit, përmirësimi i efikasitetit dhe ruajtja e mirëqenies së stafit, dhe
- shërbimeve bashkiake: ofrimi i shërbimeve dhe funksioneve te të gjithë zonën administrative dhe gjeografike të Elbasanit.

7.1.1 Konteksti i këtij plani për Bashkinë Elbasan

Ndryshimet klimatike sjellin ndryshime të rëndësishme te modelet e motit, sikurse te reshjet,

temperatura dhe era, të cilat vazhdojnë për një periudhë të zgjatur (d.m.th. me dekada ose më gjatë). Ka gjithnjë e më shumë shqetësime se veprimtaritë e përsheptuara njerëzore po ndikojnë te klima. Këto veprimtari po ndikojnë negativisht te ndryshimet e klimës dhe po shkaktojnë ndikime serioze te ngrohja globale. Ngruhja e sistemit klimatik i atribuohet aktiviteteve njerëzore si pasojë e emetimeve të gazeve serrë⁵¹ nga:

- Djegia e lëndëve djegëse fosile sikurse nafta, gazi, torfeja dhe qymyri, rezultojnë në emetim e dioksidit të karbonit;
- Aktivitetet bujqësore që sjellin emetimin e metanit dhe oksidit të azotit;
- Emetimet nga ndryshimet e përdorimit të tokës, si urbanizimi, shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi.

Disa ndikime të ngrohjes globale, sikurse rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet bregdetare, janë tashmë të pashmangshme.

Ky Plan Vendor Veprimi është vendosur në sfondin e risqeve në rritje që lidhen me ndryshimet klimatike dhe që synon reduktimin dhe menaxhimin e këtyre risqeve në nivel vendor. Të gjitha bashkitë, përfshirë Elbasanin, ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, shumë prej të cilave preken dhe do të preken gjithnjë e më shumë nga ndryshimet klimatike. Me shumë mundësi njerëzit do të vazhdojnë të luajnë një rol kryesor për përgjigjen ndaj ndikimeve të ngjarjeve ekstreme atmosferike dhe ndikimeve të tjera, të cilat kanë mundësi të shfaqen gjatë dekadave të ardhshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të zbatimit të disponueshme në një bashki.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike synon të ndërtojë komunitete që qëndrueshme ndaj klimës, të mbrojnë njerëzit, ekosistemet, bizneset, infrastrukturën dhe ndërtesat nga ndikimet negative të ndryshimeve klimatike. Bashkia Elbasan luan një rol kyç në planifikimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente. Elbasani është vendi më i mirë për të reaguar më shpejt dhe më efektivisht ndaj ngjarjeve vendore klimatike, për shkak të marrëdhënieve të ngushta me komunitetet dhe njohurive të shumta për mjedisin natyror dhe atë të ndërtuar.

Teksa klima po ndryshon, Bashkia Elbasan duhet të sigurohet se po përshtatet me ndryshimet klimatike. Thelbësore është përfshirja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike te proceset vendimmarrëse të Bashkisë Elbasan dhe zbatimi në mënyrë proaktiv i detyrave të bashkisë. Për më tepër, përfitimet dhe mundësitë që mund të vijnë si rezultat i ndryshimeve klimatike duhet të kapitalizohen lidhur me kursimet e kostove dhe mënyrat e reja, që të nxisin qëndrueshmërinë mjedisore.

Bashkia Elbasan ka për detyrë të përfshijë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me kalimin e kohës të gjitha funksionet, operacionet dhe shërbimet e bashkisë. Bashkia kërkon të informojë ose të "mbrojë klimën" nëpërmjet planeve dhe politikave ekzistuese të ndërmarra dhe të zbatuara nga bashkia. Kjo siguron një qasje që do të merret parasysh, një qasje të qëndrueshme dhe koherente për të përballuar sfidat e ardhshme klimatike dhe për të ndërtuar aftësitë ripërtëritëse brenda bashkisë dhe komuniteteve.

7.2 Procedura dhe kriteret e përparësisë

Në seksionin vijues, ndikimet e rreziqeve të ndryshimeve klimatike (të renditura në kapitujt 5 dhe 6) janë marrë parasysh si përgjigje nga Bashkia Elbasan për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve. Pas marrjes në konsideratë të rreziqeve klimatike dhe të vlerësimeve për risqet shoqëruese, të cilat kanë ndikuar te Bashkia Elbasan (kapitulli 6), hapi tjetër për përgatitjen e planit vendor të veprimit është identifikimi i veprimeve të duhura, që do ta ndihmonin Bashkinë Elbasan të përmirësonte aftësitë e saj ripërtëritëse

⁵¹ Përfshirja e avujve të ujit, e dioksidit të karbonit (CO₂), e metanit (CH₄), e oksidit të azotit (N₂O) dhe e gazrave industrialë: Hidrofluorokarburet (HFC-ve), perfluorokarburet (PFC-ve), Hekzafloridi i squfurit (SF₆) dhe Trifluoriza e Azotit (NF₃).

ndaj klimës. Këto veprime janë kategorizuar sipas 5 fushave sektoriale, të cilat janë më të përshtatshmet për të synuar:

- Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar.
- Infrastruktura.
- Biznesi dhe industria.
- Mjedisi natyror.
- Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë.

6	Hartoni plane komunikimi në fusha të tilla si <ul style="list-style-type: none"> - Rritje e ndërgjegjësimin të pronarëve të shtëpive private për ndikimet e mundshme të ngjarjeve të ndryshimeve klimatike në strehim dhe për mënyrën se si të kujdesen më mirë për shtëpinë e tyre që të shmangin ose zvogëlojnë ndikimet. 	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatshkurtër-afatmesëm

Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar			
Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ngjarjeve të rënda atmosferike përmes rritjes së kapaciteteve dhe aftësive ripërtëritëse klimatike brenda Bashkisë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	<ul style="list-style-type: none"> - Informimi i banorëve se si mund të reduktojnë përdorimin e ujit, duke ndihmuar në kursimin e ujit. - Informimi i Bashkisë Elbasan duke përdorur kushtet e sakta të motit, duke vendosur alarme, sinjale paralajmëruese, këshilla dhe mbështetje përpara ngjarjet ekstreme atmosferike. - Promovimi nëpër shkolla i përshtatjes dhe aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe promovimi i fizibilitetit të zgjidhjeve bazuar te natyra, për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe për të përmirësuar biodiversitetin. - Nxitja e ndryshimeve të sjelljes dhe e krijimit të aftësive ripërtëritëse në komunitete me ndryshime klimatike dhe ngjarje të rënda atmosferike. - Hartimi dhe drejtimi i një fushate komunikimi, e cila detajon ndikimet që mund të ketë ndryshimi klimatik në shëndet dhe mirëqenie. - Hartimi i këshillave dhe udhëzimeve se çfarë duhet bërë nëse banorët preken nga ngjarjet ekstreme atmosferike (p.sh. përmbytje, valë të të nxehtit etj.), duke u dhënë përparësi komuniteteve të cënueshme, në mënyrë që të mund të përgjigjen më shpejt në rast të motit ekstrem. 		
7	Zhvillimi i trajnimeve për stafin e bashkisë për të ofruar mbështetje dhe asistencë për shërbimet thelbësore për banesat dhe komunitetet e cënueshme në të gjithë Bashkinë Elbasan, duke krijuar ekspertiza, kapacitete dhe duke rritur bazën e njohurive brenda komunitetit nëpërmjet programeve të synuara dhe përkatëse të trajnimit mbi Ndryshimet Klimatike dhe ndikimet e tij.		Afatshkurtër
8	Përdorni si mundësi projektet arsimore të shkollave ose ngjarjet në komunitet për të shpërndarë informacionin e ndryshimeve klimatike te publiku. Nismat arsimore për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me informacionin dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike	Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportive	Afatshkurtër
9	<p>Përmirësoni mbledhjen e të dhënave lidhur me ndikimet e ngjarjeve ekstreme klimatike, përfshirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtimin, grumbullimin dhe dokumentimin e ndikimeve të ngjarjeve ekstreme klimatike në Elbasan. - Kapjen e ndikimeve të ngjarjeve klimatike në infrastrukturë dhe ndërtesa kritike përmes hartës së GIS-it, për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve dhe zonave të cënueshme, për të lejuar planifikimin e ardhshëm të përshtatjes. - Zhvillimin e një sistemi raportimi dhe shkëmbimi informacioni, që lejon vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe mbështet vlerësimin e vërtetë ekonomik të projekteve të përshtatjes në të ardhmen. - Vazhdimin e aktivizimit të Protokollit të Emergjencave për Motin Ekstrem gjatë periudhave të motit ekstrem, duke siguruar që njerëzit e pastrehë të kenë qasje në strehimore. 	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatshkurtër-afatgjatë

Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar			
Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ngjarjeve të rënda atmosferike përmes rritjes së kapaciteteve dhe aftësive ripërtëritëse klimatike brenda Bashkisë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	- Vazhdimin e monitorimit të niveleve të cilësisë së ajrit, duke siguruar që cilësia e ajrit do të mbetet në nivel të sigurt gjatë periudhave me temperatura të larta.		
10	Sigurohuni se vlerësimet rutinë të ndikimit në shëndet përfshijnë konsideratat e ndikimeve nga ndryshimet klimatike, veçanërisht nga moti ekstrem.	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm
11	Përfitoni nga vera më e gjatë dhe më e thatë duke nxitur zgjedhje fleksibël të stilit të jetesës për përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies. P.sh: duke ndryshuar modelet e punës, duke promovuar përdorimin e hapësirave të jashtme ose duke nxitur daljen në natyrë për të nxitur turizmin vendor dhe mundësitë ekonomike.		Afatshkurtër
12	Vlerësoni zonat që mund të jenë më të prirura ndaj zjarreve të pyjeve dhe vendosni sinjalistika dhe udhëzime në këto zona për t'i nxitur përdoruesit që të mos e përkeqësojnë riskun, për shembull duke ndezur zgarën ose zjarre në kamp.		Afatmesëm
13	Jepuni përparësi masave përshtatëse, sikurse përmirësimi i kullimit, integrimi i infrastrukturës së gjelbër dhe integrimi i stacioneve të ftohjes sikurse: burime ujit dhe stola me hije në rrugët më të njohura të ecjes dhe çiklizmit në të gjithë Bashkinë Elbasan.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm
14	Krijimi i programeve të komunitetit për qëndrueshmëri, që të sigurohen se komunitetet vendore do të jenë më të përgatitura për ngjarjet ekstreme atmosferike më të shpeshta dhe më intensive (përmbytje, valë të nxehti, stuhi) dhe mund të përgjigjen dhe rikuperojnë në mënyrë më efektive.		Afatmesëm
15	Eksploron mënyra se si Bashkia Elbasan mund të ndihmojë grupet e cënueshme (romët dhe egjiptianët, gratë kryefamiljare, etj.) dhe njerëzit e izoluar (të moshuarit) dhe komunitetet që të jenë më të qëndrueshëm ndaj klimës.		Afatshkurtër-afatmesëm
16	Nxitini të gjitha grupet e komunitetit që të <ul style="list-style-type: none"> - Marrin parasysh përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike të planet dhe programet e tyre shumëvjeçare. - Ndjekin në mënyrë aktive projektet për reduktimin e konsumit të energjisë dhe për zvogëlimin e sasisë së karbonit. - Mbështetin identifikimin e atyre që janë më të riskuar nga skenarët e përcaktuar dhe që të japin përgjigje proaktive sipas rastit. 	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatmesëm
17	Bashkëpunoni me organizatat përkatëse qeveritare, agjencitë dhe palët e interesuara për të rritur ndërgjegjësimin për ndikimet e ndryshimeve klimatike të ngjarjet e përmbytjeve dhe të cilësia e ujit, dhe punoni me këto palë të interesuara për zhvillimin dhe	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit	Afatshkurtër-

Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar			
Për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ngjarjeve të rënda atmosferike përmes rritjes së kapaciteteve dhe aftësive ripërtëritëse klimatike brenda Bashkisë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	zbatimin e masave të përshtatjes.	Parashkollor, Trashëgimisë Kulture, Turizmit dhe Sportive; Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	afatgjatë
18	Sigurohuni që programet e rinovimit të shtëpisë kërkohen së bashku me realizimin e objektivave të efikasitetit të energjisë, të cilat integrojnë masat e përshtatjes aty ku është e mundur, të tilla si instalimi i masave të efikasitetit të ujit, opsionet e hijes, ventilimi më i mirë për reduktimin e riskut të mbixhjes dhe për përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm, etj. Këtu mund të përfshihet edhe ventilimi natyror për të përmirësuar performancën termike dhe për t'u ndierë rehat gjatë valëve të të nxehtit duke përdorur gjelbërime natyrore, reflektime çatish, trotuare të depërtueshëm dhe duke grumbulluar ujin e shiut në vend të ujërave të ëmbla.	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatgjatë
19	Promovoni zhvillimin që nxit përdorimin e energjisë elektrike të pastër, që minimizon konsumin e karburanteve në Elbasan.	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatshkurtër-afatgjatë
20	Përgatitni strategjinë për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth rolit të Bashkisë Elbasan për reagimin ndaj emergjencave klimatike.	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatmesëm-afatgjatë
21	Kini parasysh se si temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit mund të sjellin rritje të shqetësimeve për shëndetin publik dhe sigurohuni që shpërndarja e burimeve ta marrë këtë gjë parasysh.	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm
22	Planifikimi i ndërtesave për të përfshirë projektimin e përshtatur ndaj nxehtësisë, sikurse fasadat e bardha, përdorimi i grilave, çatitë e gjelbra dhe teknologjitë efikase të ftohjes. Futja e një sistemi raportimi dhe monitorimi për izolimin e ndërtesave, për të siguruar ndërtesa të qëndrueshme ndaj nxehtësisë.		Afatshkurtër-afatgjatë
23	Termoizolimi i të gjitha objekteve publike, veçanërisht shkollave, kopshteve dhe çerdheve	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatgjatë
24	Hartimi dhe zbatimi i vlerësimit të riskut dhe planit korrigjues për identifikimin e stokut të ndërtesave të Elbasanit dhe integrimi i proceset vendimmarrëse për programet e infrastrukturës rugore; projektimi, planifikimi dhe mirëmbajtja.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore	Afatmesëm

Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar			
Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ngjarjeve të rënda atmosferike përmes rritjes së kapaciteteve dhe aftësive ripërtëritëse klimatike brenda Bashkisë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuksi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
		dhe e Prokurimit Publik	
25	Identifikimi i masave të aftësive ripërtëritëse ndaj ngjarjeve ekstreme atmosferike të ndërtesave historike/trashëgimisë në pronësi dhe në operim të Bashkisë Elbasan.	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër-afatmesëm
26	Rishikimi i planeve të lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme për Elbasanin.		Afatmesëm-afatgjatë

A.3 Infrastruktura

Infrastruktura			
Për të rritur aftësinë ripërtëritëse të asetëve infrastrukturore në Bashkinë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuksi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
1	<p>Filloni konsideratat klimatike për projektimin, planifikimin dhe ndërtimin e të gjitha projekteve infrastrukturore të ndërmarra nga Bashkia Elbasan, që të reduktohet cenueshmëria e Bashkisë Elbasan nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Veprimet e mundshme mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i projektimit dhe ndërtimit cilësor me aftësi ripërtëritëse dhe qëndrueshmëri ndaj klimës. - Mbrojtja dhe fuqizimi i korridoreve ekologjike: shtimi i bimësisë të zonat përreth rrjedhave ujore, liqeneve - Përfundimi i hipotezave për vendbanimet pranë zonave që përbëjnë korridoret ekologjike - Krijimi i brezave të gjelbër ngjitur me infrastrukturën kryesore të transportit - Krijimi i parqeve urbane pranë zonave industriale të prekura nga lloje të ndryshme ndotjesh - Përdorimi i asfaltit me pasqyrim të lartë (ulja e efektit të zonës së nxehtësisë urbane (UHIE), kursimi i kostove dhe i energjisë për ndriçimin e rrugëve për të ofruar më shumë shikueshmëri)/Modifikimi i trotuareve të rrugëve përmes përdorimit të trotuareve të freskëta - Përdorimi i bojërave mbrojtëse për sipërfaqet e jashtme me veprim fotokatalitik, të cilat garantojnë rezistencë të shkëlqyer ndaj 	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> <p>Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p>	Afatshkurtër-afatgjatë

Infrastruktura			
Për të rritur aftësinë ripërtëritëse të aseteve infrastrukturore në Bashkinë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	<p>ujit dhe përshkueshmëri të lartë ndaj avujve të ujit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Futja e trupave ujorë brenda hapësirave publike - Përfshirja e rolit të mjedisit natyror për promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike përmes promovimit të infrastrukturës së gjelbër, të tilla si çatitë dhe muret e banimit në vende të përshtatshme. - Promovimi i projektimit dhe ndërtimit të zhvillimeve të reja për të krijuar lagje me karbon të ulët dhe me mundësi për shëtitje, si dhe vende pune me infrastrukturë të gjelbër dhe blu me cilësi të lartë. - Rishikimi i kërkesave të projektimit për qëndrueshmëri të kullimit urban në kuadër të planifikimit të Elbasanit - Zbatimi i Udhëzimeve të Planifikimit të Përmbytjeve dhe praktikave më të mira për zvogëlimin e riskut të zhvillimeve të reja nga risqet e përmbytjeve lumore, nga reshjet ose e përmbytjeve nëntokësore. - Mbrojtja e hapësirave të hapura, me infrastrukturë multifunkionale të gjelbër dhe blu, lidhur me rrjetin më të gjerë të hapësirave të hapura dhe habitateve. - Zbatimi i masave bioinxhinierike përgjatë rrugëve të njësive administrative Gjinar, Zavalinë, Papër, Shushicë, Labinot Mal, Funar dhe Gracen për të parandaluar rrëshqitjet dhe erozionin. - Zbatimi i masave infrastrukturore për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet dhe erozioni përgjatë të dyja anëve të lumit Shkumbin 		
2	<p>Zbatoni Regjistrin e Riskut dhe Mundësive dhe kuadrin menaxhues për të gjitha infrastrukturën dhe ndërtesat kritike në pronësi të Bashkisë Elbasan, përfshirë rrugët, ndërtesat, infrastrukturën e TI-së, pajisjet kritike, mbetjet, nëpërmjet nismave si p.sh.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i një regjistri që merr parasysh ndikimet e mundshme dhe shpeshtësinë e ndryshimeve klimatike të infrastruktura kritike. - Vendosja e një plani monitorimi për të inspektuar integritetin e infrastrukturës ekzistuese. - Identifikimi i planeve rezervë dhe të emergjencës për ngjarjet klimatike që kanë potencial të ndikojnë të infrastruktura kritike. - Vazhdimi i zhvillimit të bazës së të dhënave për hartën e riskut, pasi zonat e njohura të përmbytjeve po përhapen në të gjithë Bashkinë Elbasan. - Zhvillimi i Regjistrit të Infrastrukturës për Mbrojtjen nga Përmbytjet dhe Planet e Menaxhimit. 	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p> <p>Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p>	Afatmesëm - afatgjatë
3	<p>Zbatoni Regjistrin e Riskut dhe Mundësive për mbrojtjen e infrastrukturës nga përmbytjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i planeve për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore, në mënyrë që të menaxhohen risqet e përmbytjeve të ujërave sipërfaqësore në zonat e identikuara. - Identifikimi dhe zhvillimi i regjistrit të infrastrukturës ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet e forta dhe të buta në Elbasan. - Kryerja e rishikimit të qëndrueshmërisë klimatike dhe vlerësimit të riskut, duke marrë parasysh gjendjen e infrastrukturës 	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm - afatgjatë

Infrastruktura			
Për të rritur aftësinë ripërtëritëse të aseteve infrastrukturore në Bashkinë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	<p>mbrojtëse nga përmbytjet, kapacitetin e projektimit dhe cenueshmërinë e receptorëve nëse infrastruktura dështon.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi dhe zbatimi i protokolleve për vlerësimet e integritetit strukturor të infrastrukturës së përmbytyjeve pas ngjarjeve ekstreme. - Zhvillimi i një programi mirëmbajtjeje për ruajtjen e integritetit të infrastrukturës. - Identifikimi i zhvillimeve të zonat me përparësi të riskut nga përmbytjet dhe pikat e nxehta në të gjithë bashkinë dhe provimi i përdorimit të teknologjisë së sensorëve në distancë për vlerësimin e zonave të njohura të përmbytyjeve në të gjithë rrjetin e autostradave dhe bashkisë, që synon veprimet përpara ngjarjeve të rënda të reshjeve. - Zhvillimi i planeve alternative të rrugëve në rast përmbytyjeje për të minimizuar ndërprerjen e shërbimit. - Përparësia e projekteve për reduktimin e riskut nga përmbytjet dhe siguria e hartës së detajuar të zonave të prirura ndaj riskut të përmbytyjeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. - Vlerësimi dhe forcimi i urave, të cilat rrezikohen të dëmtohen nga përmbytjet. - Garantimi se sistemet e duhura të kullimit të ujërave të shiut për zhvillimet e reja ofrojnë siguri për ndikime të mundshme të ndryshimeve klimatike në të ardhmen. 		
4	<p>Sigurohuni se Vlerësimet e Riskut nga Përmbytjet, të cilat janë specifike për një zonë të caktuar, janë përgatitur për infrastrukturën dhe ndërtesat e reja që të informojnë lidhur me vendimet e planifikimit dhe kërkesat e përshtatjes, duke siguruar që sistemet e kullimit të ujërave të stuhisë do të merren parasysh për zhvillimin e ri të ndikimit të mundshme të ardhshme të ndryshimeve klimatike në projektimet e tyre, përfshirë përdorimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban.</p>	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik; Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p>	<p>Afatshkurtër-afatmesëm</p>
5	<p>Integrioni konsideratat e klimës në projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve, shtigjeve, urave dhe projekteve të tjera ndërtimore dhe ndërmerrni masa për përfshirjen e infrastrukturës së gjelbër si mjet për mbështetjen e biodiversitetit, për zbutjen e stresit të nxehtësisë, për mbajtjen e ujit, për uljen e përmbytyjeve, si dhe për përfitime më të gjera mjedisore.</p>	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</p>	<p>Afatmesëm</p>
6	<p>Zhvilloni një plan shërbimi për të vendosur burime për ruajtjen e qëndrueshmërisë së rrjetit të autostradave dhe vendeve kritike brenda bashkisë gjatë gjithë muajve të dimrit.</p>	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik</p>	<p>Afatmesëm-afatgjatë</p>

Infrastruktura			
Për të rritur aftësinë ripërtëritëse të asetëve infrastrukturore në Bashkinë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
7	Eksploroni potencialin për të ndërmarrë trajtime parandaluese të mirëmbajtjes në dimër të shtigjeve ku kalojnë këmbësorët dhe biçikletat, duke ulur riskun / përgjegjësinë e mundshme të dëmtimit të komuniteteve vendore.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm
8	Merrni pjesë në procesin e konsultimit të planifikimit për të siguruar se ndikimet e disponueshmërisë së ujit dhe cilësisë së ajrit konsiderohen në fazën e aplikimit të planifikimit.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm-afatgjatë
9	Vlerësoni politikën e automjeteve të Bashkisë Elbasan dhe ndërmerrni vlerësime të përshtatshmërisë së automjeteve për funksionimin efektiv në kushte sfiduese dhe nxitni politikën për mbështetjen dhe zhvillimin e Infrastrukturës së karikimit të Automjeteve Elektrike (EV) te Zonat në pronësi dhe të marra nga Bashkia Elbasan.		Afatmesëm-afatgjatë
10	Përdorni të dhëna inteligjente, për të ndarë praktikat më të mira dhe për të mbështetur realizimin e komuniteteve më të sigurta dhe me të qëndrueshme.	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatgjatë
11	Bëni një studim për identifikimin e llojeve të motit ekstrem që ndikon në zona të ndryshme të rrjetit të autostradave dhe infrastrukturës kritike. Identifikoni pjesët e rrjetit / infrastrukturës që kanë nevojë për më shumë qëndrueshmëri.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm
12	Bashkëpunoni me kompaninë e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kompaninë e ujërave të zeza për sigurimin e sistemeve të qëndrueshme për të parandaluar ndotjen gjatë ngjarjeve të zgjatura të përmbytjeve - auditimi i sistemeve dhe mirëmbajtja parandaluese.		Afatshkurtër-afatmesëm
13	Ndërmarrja e Vlerësimit të Riskut të infrastrukturës ekzistuese rrugore/transportuese te zonat e cenueshme për të identifikuar seriozitetin e risqeve të ndryshimeve klimatike për funksionimin dhe gjendjen e tyre.		Afatmesëm-afatgjatë
14	Sigurohuni që planet e reagimit ndaj emergjencave të motit ekstrem të rishikohen çdo vit për të siguruar që kapaciteti i duhur i burimeve është i vendosur për të ofruar një përgjigje efektive emergjente.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër
15	Eksploroni qëndrueshmërinë klimatike të materialeve të përdorura për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.		Afatshkurtër

Infrastruktura			
Për të rritur aftësinë ripërtëritëse të asetëve infrastrukturore në Bashkinë Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuksi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
16	Kryeni Vlerësimin e Riskut për ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike te objektet e menaxhimit të mbetjeve të Elbasanit, për të identifikuar vendet dhe proceset më të prekura nga ndryshimet klimatike dhe për të formuluar planet e duhura të veprimit për të trajtuar ndikimet e mundshme.		Afatmesëm-afatgjatë
17	Hartoni udhëzime për projektet e mëdha të investimeve kapitale, të cilat përcaktojnë mënyrën e përdorimit të parashikimeve klimatike specifike rajonale dhe të opsioneve të përshtatjes.		Afatmesëm

A.4 Biznesi dhe Industria

Biznesi dhe industria			
Për të identifikuar dhe avancuar mundësitë e ndjekjes së përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtuksi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
1	<p>Zhvilloni një Program Ndërgjegjësimi për Ndryshimet Klimatike për bizneset dhe nismat e reja për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimin e tyre lidhur me masat e veprimit klimatik që mund të integrohen te aktivitetet e biznesit. - Identifikimin e mbështetjeve të biznesit dhe opsionet e financimit për bizneset që kërkojnë të jenë më të qëndrueshëm ndaj ngjarjeve të ndryshimeve klimatike. - Mësimin e bizneseve vendore për rëndësinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. - Promovimin e përshtatjes përmes ofrimit të këshillave dhe mbështetjes së bizneseve dhe organizatave vendore për përshtatje dhe ndërhyrjet e kërkimeve për trajtimin e sfidave të ndryshimeve klimatike. - Komunikimin e çështjeve strategjike me komunitetin e biznesit, duke ofruar trajnime dhe këshilla për kryerjen e kontrollit të Qëndrueshmërisë së Biznesit, për t'u siguruar se bizneset mund të reagojnë mirë ndaj presioneve të jashtme sikurse moti ekstrem. - Integrimin e konsideratave të ndryshimeve klimatike te praktikat dhe operacionet ekzistuese të biznesit dhe zhvillimin e ideve ekzistuese dhe të reja që kërkojnë të kapin mundësitë lidhur me përparimet mjedisore dhe teknologjike që mbështesin tranzicionin me karbon të ulët. - Nxitjen e tyre që të mos përdorin qymyrin te oeracionet e tyre. 	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatmesëm

Biznesi dhe industria			
Për të identifikuar dhe avancuar mundësitë e ndjekjes së përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtimi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	- Shfaqjen e praktikave më të mira në të gjithë industrinë, nëpërmjet punës së zbatuar nga Bashkia Elbasan.		
2	Sigurohuni se ka kërkesa që të gjitha zhvillimet e reja tregtare të përfshijnë një sistem të qëndrueshëm të kullimit urban.	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm
3	Hartoni dhe përhapni ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike, trajnimin ekologjik dhe të qëndrueshmërisë nëpër shtëpia.	Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatshkurtër
4	Zbatoni Strategjinë e Riskut dhe Mundësive të Kulturës dhe Trashëgimisë, duke përfshirë veprime për: - Hartimin e një regjistri për vendet me trashëgimi dhe me kultura në Elbasan, i cili do të marrë parasysh ndikimet dhe çdo mundësi të ndryshimeve klimatike, përfshirë ndikimet indirekte të komunitetet dhe identiteti i tyre kulturor. - Hartimin e protokolleve dhe procedurave për monitorimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në zonat kulturore dhe e trashëgimisë në Elbasan për të informuar lidhur me politikën dhe menaxhimin e përshtatjes kombëtare dhe vendore, si dhe mbështetjen e programet e duhura të mirëmbajtjes dhe riparimit.	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportive	Afatshkurtër-afatmesëm
5	Zbatoni regjistrin e Riskut dhe Mundësive Turistike, duke përfshirë veprime për: - Analizimin e potencialit për humbjen e burimeve turistike si pasojë e ndikimeve të vendet e trashëgimisë, vendet kulturore dhe hapësirat, si dhe përcaktimin e çdo mundësie të mundshme që mund të vijë nga ndryshimet klimatike. - Ndërmarrjen e analizës kosto-përfitim të investimeve përshtatëse për vendet me risk të lartë, të cilat janë gjithashtu me prioritet për turizmin, dhe zhvillimin e planit të investimi strategjik për përshtatjen e burimeve turistike me risqet dhe mundësitë e identifikuar.	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportive	Afatshkurtër-afatmesëm
6	Merrni në konsideratë proceset për përshtatjen në punë për të minimizuar riskun shëndetësor të fuqia punëtore. Për shembull: ndryshimin e modeleve të punës dhe PMP-ve.	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportive	Afatmesëm-afatgjatë
7	Sigurimi se të gjitha sektorët dhe bizneset, të cilat kërkojnë leje mjedisore, sikurse aktivitetet që përfshijnë substanca potencialisht të dëmshme, punimet e çimentos, stacionet e benzinës, i vlerësojnë ndikimet e ndryshimeve klimatike për funksionimin e tyre.		Afatgjatë

Biznesi dhe industria			
Për të identifikuar dhe avancuar mundësitë e ndjekjes së përpjekjeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Elbasan			
Nr.	Veprimi	Drejtori dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
8	Sigurohuni që risqet klimatike të përfshihen te vlerësimet e riskut të korporatës.	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatmesëm
9	Nxitni qëndrueshmërinë përmes zinxhirit dhe proceseve të furnizimit të prokurimit dhe komisionimit të Bashkisë Elbasan, për të ndihmuar Bashkinë Elbasan të promovojë sektorët vullnetar, komunitetin dhe ndërmarrjet sociale.	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm
10	Përmirësoni evidenca dhe kuptoni risqet ndërvepruese dhe të njëpasnjëshme, duke i përfshirë në të gjithë zinxhirin e furnizimit.	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër
11	Ofrimi si lehtësues në prezantimin e Pagesave për Shërbimet e Ekosistemit (PES), veçanërisht në sektorin e bujqësisë, për të kontribuar te një strategji e qëndrueshme financimi	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm-afatgjatë
12	Hartimi i nismave të tjera për financimin e klimës, të tilla si modeli i koncesionit të tarifave të hyrjes, lejeve të hyrjes, miratimit të zhvillimit dhe dhënies së kredive të kushtëzuara për zhvillimin e strategjisë së financimit të qëndrueshëm	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm-afatgjatë
13	Përmirësoni bashkëpunimin me akademinë në mënyrë që të shkëmbehen praktikatat dhe njohuritë më të mira.	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatmesëm
14	Mbështetni bizneset që të prezantojnë sektorët e menaxhimi të riskut brenda kompanive të tyre, veçanërisht te kompanitë e mëdha.	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatmesëm

A.5 Mjedisi natyror

Mjedisi natyror			
Për integrimin e konsideratave të veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror të Bashkia Elbasan dhe për promovimin e menaxhimit efektiv të biodiversitetit dhe për përmirësimin e mbrojtjes së habitateve dhe peizazheve natyrore			
Nr.	Veprimi	Drejtuuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
1	<p>Identifikoni mundësitë për të rritur qëndrueshmërinë klimatike të infrastrukturës dhe mjedisit të ndërtuar përmes masave ekologjike natyrore të zhvillimit të reja (dhe për rinovimin e ekzistuesve), të tilla si përdorimi i veçorive natyrore (p.sh. pemët e rrugëve, çatitë e gjelbra, kopshtet me shi etj.) dhe materiale të tjera, si p.sh. trotuari i depërtueshëm. Këtu mund të përfshihen veprime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e mekanizmeve dhe kanaleve të komunikimit për të siguruar që përshtatja dhe infrastruktura e gjelbër promovohet dhe përfshihet te punimet e ardhshme të zhvillimit dhe mirëmbajtjes, duke realizuar infrastrukturë dhe projekte ndërtimi cilësore, miqësore me klimën dhe të përshtatshme. - Identifikimin e vendeve ose projekteve për gjelbërim të përkohshëm në tokë të lirë dhe të braktisur. - Eksplorimin e mundësive të rritjes së vëllimit të hapësirave të gjelbra dhe sistemeve të qëndrueshme të kullimit urban të të gjitha Bashkitë Elbasan, për të reduktuar riskun e përmbajtjeve të komuniteteve nga ngjarjet ekstreme të reshjeve. - Zbatimi i masave bioinxhinierike në zonat e pjerrëta dhe të degraduara të njësive administrative Gjinar, Zavalinë, Papër, Shushicë, Labinot Mal, Funar dhe Gracen, për të parandaluar degradimin, rrëshqitjet dhe erozionin e tokës. - Projektimi dhe shpallja e tre parqeve bashkiake: Krasta e Elbasanit, Funari dhe Gjinari për të rritur qëndrueshmërinë klimatike për qytetarët dhe komunitetet vendore. - Zbatimi i masave për parandalimin e dëmeve në bujqësi (rrjetat, sigurimet, sistemet e paralajmërimit të hershëm etj.) - Përmirësimi i ruajtjes dhe efikasitetit të ujitjes - Përmirësimi i shërbimit të zgjerimit të bujqësisë (si për bujqësinë ashtu edhe për blegtorinë) - Zbatimi i praktikave më të mira bujqësore për: kultivimin, rotacionin e të korrave, periudhën pas vjeljes, menaxhimin e organizmave të dëmshëm dhe sëmundjet 	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik;</p> <p>Drejtoria e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit</p>	Afatshkurtër-afatmesëm
2	<p>Zhvilloni/Rishikoni Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit të Elbasanit dhe projekte specifike të zonës për t'u siguruar se risqet nga ndryshimet klimatike janë identifikuar dhe janë marrë parasysh, sikurse ekzaminimi i ndryshimeve të sezonit, përfshirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e një strategjie vendore për ofrimin e 10% të fitimit neto të biodiversitetit të zhvillimi i ri. - Mbrojtjen dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër, e habitateve dhe korridoreve ekologjike nëpërmjet projekteve të peizazhit, duke zbatuar një skemë Fitimi Neto të Biodiversitetit. - Promovimin e integritit të biodiversitetit në zhvillime - Sigurimin e hapësirave të gjelbra dhe pemëve që thithin më shumë CO2 dhe që janë në gjendje të përshtaten me klimën për të siguruar jetëgjatësi gjatë gjithë vitit. - Zbatimin e menaxhimit të organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve në të gjithë ekosistemin natyror (në pyjet e prekura) - Hartimin e hartës së riskut nga zjarri për bashkinë 	<p>Drejtoria e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit</p>	Afatmesëm

Mjedisi natyror			
Për integrimin e konsideratave të veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror të Bashkia Elbasan dhe për promovimin e menaxhimit efektiv të biodiversitetit dhe për përmirësimin e mbrojtjes së habitateve dhe peizazheve natyrore			
Nr.	Veprimi	Drejtuuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	- Zbatimin e masave për parandalimin e zjarrit, sikurse hapja e rrugëve pyjore		
3	Hartoni një strategji të përzier për mbjelljen e pemëve, pasi pemët do të përdoren për qëllime ftohjeje në zona të caktuara me kafshë të egra, në të gjithë Bashkinë Elbasan, duke përfshirë veprimet për <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimin e shpërndarjes në mënyrë të dobishme për biodiversitetin, duke rritur njëkohësisht sekuestrimin e karbonit. - Zhvillimin e një procesi studimi për pemët për të përcaktuar punët e nevojshme për minimizimin e riskut. - Vëzhgimin e pemëve dhe strukturave që preken nga erërat e forta dhe që mund të paraqesin risk dëmtimi nëse shemben/bien gjatë erërave të forta. Megjithatë, duhet t'i jepet përparësi masave parandaluese. - Përfitimin nga shtrirja e programeve vendore të mbjelljes së pemëve duke siguruar se të gjitha skemat kontribuojnë te objektivat e përshtatjes klimatike, për shembull ato që ndihmojnë në reduktimin e riskut nga përmbytjet dhe në ftohjen urbane. - Zhvillimin e planit vendor të pyllëzimit, bazuar te speciet vendore dhe te përbërja e pemëve të afta për t'u përballur me ndryshimet klimatike. - Fillimin e përzierjes së pemëve të mbjella me speciet vendore (p.sh. përzierja e pishave mesdhetare dhe të zeza me lisat) - Zbatimin e masave të pylltarisë për të arritur përbërjen e dëshiruar të specieve të pemëve 	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatmesëm-afatgjatë
4	Përgatitni një Plan/Program për Menaxhimin e Specieve Invazive për <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimin dhe trajtimin e specieve të dëmshme invazive, veçanërisht ato që paraqesin risk për shëndetin publik. - Sigurimin se janë identifikuar risqet përkatëse nga ndryshimet klimatike; identifikimin e specieve invazive, përhapja e të cilëve është e lidhur me ndryshimet klimatike dhe zhvillim e teknikave të përshtatshme të menaxhimit për kontrollin e tyre. - Monitorimin e përhapjes së specieve invazive tokësore dhe ujore në klimë në ndryshim dhe kontrollimin e specieve pushtuese ku përhapja e tyre konsiderohet problematike. - Eksplorimin e metodave më miqësore me mjedisin për kontrollimin e organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve dhe për reduktimin e përhapjes së specieve invazive. 	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatshkurtër-afatmesëm
5	Zhvilloni dhe përshtatni Strategjinë e Infrastrukturës së Gjellbër për të siguruar realizimin e habitateve të shumta dhe të përmirësuara. Sigurohuni që hapësirat e gjelbra të ofrojnë edhe përmirësime të biodiversitetit, duke përfshirë veprime për <ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtjen dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër e të hapur, e habitateve dhe korridoreve ekologjike nëpërmjet projekteve të peizazhit. 	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatshkurtër-afatmesëm

Mjedisi natyror			
Për integrimin e konsideratave të veprimit klimatik në politikën e mjedisit natyror të Bashkia Elbasan dhe për promovimin e menaxhimit efektiv të biodiversitetit dhe për përmirësimin e mbrojtjes së habitateve dhe peizazheve natyrore			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	<ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtjen dhe kujdesin e ekosistemeve ekzistuese dhe natyrore dhe sigurimin e integritetit të skemave të përshtatshme të peizazhit dhe mbjelljes të projektet infrastrukturore dhe komunitare. - Vlerësimin e qëndrueshmërisë së parqeve urbane dhe hapësirave të gjelbra të Bashkisë Elbasan, duke marrë parasysh si biodiversitetin brenda ashtu edhe përdoruesit. - Promovimin e përfitimeve më të gjera të infrastrukturës së gjelbër sikurse sigurimin e hijeve për lehtësimin e stresit të nxehtësisë, mbështetjen e biodiversitetit, sigurimin e mbajtjes së ujit dhe zbutjen e përmytjeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. - Integrimin e masave të përshtatshme kur është e përshtatshme si mbjellja strategjike e pemëve, ujitjen e livadheve, ndryshimin e regjimit të kositjes, instalimin e burimeve të ujit të pijshëm dhe mbjelljen e specieve më rezistente ndaj thatësisë. 		
6	Përgatitni një Plan Qëndrueshmërie për kontrollin e infektiveve të parazitëve, insekteve dhe specieve invazive që lidhen me nxehtësinë	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatmesëm
7	Siguroni konvertimin në shkallë të gjerë të ish-zonave industriale. Aty ku zona të tilla nuk janë të përshtatshme për zhvillim, merrni parasysh opsionet e përshtatshme për gjelbërimin e zonave (pyjet urbane, ligatinat, parqet etj).	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatmesëm-afatgjatë
8	Zhvilloni dhe miratoni një Strategji Peizazhi për të siguruar që planifikimi strategjik i peizazhit merr parasysh ndryshimet klimatike.	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatmesëm
9	Përdorni krijimin e habitatit në vende strategjike për të reduktuar riskun e erozionit të tokës.	Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatshkurtër-afatmesëm
10	Krijoni argjinatura përmytëse nëpërmjet vendosjes së zgjidhjeve të bazuara në natyrë.	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban; Drejtorja e Shërbimeve të Pyjeve, Blegtorisë, Bujqësisë dhe Mjedisit	Afatmesëm-afatgjatë

A.6 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë			
Për rritjen e qëndrueshmërisë së aseteve të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Elbasan, përfshirë stokun e banesave			
Nr.	Veprimi	Drejtuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
1	<p>Krijoni hartën e rrezikut dhe riskut, veçanërisht për përmytjet, për të përmirësuar aftësitë ripërtëritëse dhe aftësitë e përgjithshme të menaxhimit të ujit, duke përfshirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forcimin e aftësive të sistemit të paralajmërimit të hershëm. - Sigurimin se përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe risqet e qëndrueshmërisë janë përfshirë te regjistri i riskut të Bashkisë Elbasan. 	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Afatshkurtër-afatmesëm
2	Kryeni një kontroll të qëndrueshmërisë së Bashkisë Elbasan për pronat, duke filluar me ato te zonat më të rrezikuara dhe duke ofruar mbështetje nga komuniteti.	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër-afatmesëm
3	<p>Rishikoni shërbimet e Bashkisë Elbasan për</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimin se personeli dhe burimet teknike dhe operacionale janë vendosur dhe përgatitur për të reaguar ndaj ngjarjeve të mundshme ekstreme atmosferike. - Sigurimin se planet e menaxhimit janë vendosur për të përballuar çdo incident ekstrem të motit që mund të ndodhë, për të siguruar që shërbimet vazhdojnë të ofrohen kudo që është e mundur - Mirëkuptimin se cilat zona shërbimi kanë mundësi të ndikohen më shumë gjatë periudhave të emergjencave klimatike. 	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatmesëm
4	Sigurohuni që praktikatat e menaxhimit të mbetjeve, objekteve të magazinimit dhe trajtimit janë të qëndrueshme për t'i bërë ballë kushteve klimatike të ardhshme, përfshirë përmytjet dhe valët e të nxehtit.		Afatmesëm-afatgjatë
5	Rishikoni planet ekzistuese civile të kontigjencave dhe emergjencave që kanë të bëjnë me ngjarjet e rënda atmosferike, veçanërisht për informacionin e udhëtimeve dhe motit, për të punuar për mbështetjen e njerëzve më të cenueshëm në të gjithë bashkinë		Afatmesëm-afatgjatë
6	<p>Përfshini stafin e Bashkisë Elbasan për</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosjen e fleksibilitetit të punës te praktikatat standarde të punës së këshillit, për t'i mundësuar stafit punën në periudha të motit ekstrem. - Kryerjen e vlerësimeve të riskut dhe monitorimin e vendeve për përcaktimin e veprimeve të nevojshme për minimizimin e riskut për stafin dhe përdoruesit. - Përfshirjen e masave që ofron një mjedis pune më të rehatshëm për stafin, të cilët duhet të punojë në zyrë gjatë moteve 	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër-afatgjatë

Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë			
Për rritjen e qëndrueshmërisë së aseteve të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Elbasan, përfshirë stokun e banesave			
Nr.	Veprimi	Drejtpuesi dhe Partneri(ët)	Afati kohor S/M/L
	ekstreme		
7	Përgatitjen e një manuali për reagimin ndaj emergjencave, i cili përcakton rolin e secilës zonë shërbimi gjatë periudhave të emergjencave që lidhen me klimën.	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatmesëm-afatgjatë
8	Ndërmarrjen e kërkimeve deri në shkallën ku infrastruktura dixhitale, telekomunikacioni dhe TIK-u po shqyrton parashikimet e ardhshme të ndryshimeve klimatike brenda bashkisë.	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatshkurtër-afatgjatë
9	Punimin me organizatat partnere dhe palët e interesuara për rritjen e zbatimit të projekteve të Menaxhimit të Përmbytjeve Natyrore në Bashkinë Elbasan.	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	Afatmesëm-afatgjatë
10	Rritjen e qëndrueshmërisë (dhe të kuptuarit e riskut) të ndërtesave në Bashkinë Elbasan dhe të stokut të banesave nëpërmjet <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimit dhe vlerësimit të integritetit të ndërtesave të vjetra dhe të braktisura për të reduktuar kërcënimet e paraqitura. - Identifikimit dhe mbrojtjes ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe lehtësimin e ndërprerjeve të shërbimit. 	Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban; Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër-afatmesëm
11	Zbatimin e planeve/planeve përgatitore për minimizimin e ndikimit të zjarreve me qasje të reja që rrisin llojet e ndryshme të pyjeve, të cilat do të minimizonin ndikimin e zjarreve.	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe e Prokurimit Publik	Afatshkurtër-afatgjatë

Shtojca VII: Kriteret me përparësi

Pjesë e metodologjisë janë:

- a. Duke marrë parasysh se të gjitha veprimet e identifikuar kanë potencial të konsiderueshëm për të kontribuar në përshtatje, ushtrimi i dhënies së përparësisë përqendrohet në dy aspekte kryesore, përkatësisht te:
 - Potenciali i bashkëpërfitimit të veprimeve, i cili i referohet probabilitetit dhe masës në të cilën veprimet në fjalë mund të gjenerojnë (i) zhvillim socio-ekonomik dhe (ii) përfitimet lehtësuese.
 - Lehtësia e zbatimit, e cila kërkon identifikimin e veprimeve zbatimi i të cilave është më i lehtë për t'u arritur, i cili merr parasysh analizën e kryer në hapin e parë. Ky aspekt konsideron kompleksitetin e (i) kërkesave institucionale (ii) kërkesave teknike dhe (iii) përmasave të kostove (aspekte financiare), në përpjesëtim të zhdrejtë me lehtësinë e zbatimit, domethënë, një masë shumë e shtrenjtë është më pak "e lehtë për t'u zbatuar", duke pasur parasysh se duhet mobilizuar një buxhet i madh. Fizibiliteti nuk është analizuar, pasi të gjitha veprimet konsiderohen si të realizueshme dhe të nevojshme.
- b. Çdo nën-kategori u vlerësua si "e ulët", "mesatare" ose "e lartë" dhe këto vlerësime u matën dhe u grumbulluan duke rezultuar në vlerësimin e përgjithshëm me përparësi. Masat për bashkëpërfitimet janë 0.8 për zhvillimin dhe 0.2 për lehtësimin. Për lehtësimin e zbatimit, masat janë 0.3 për institucionet, 0.3 për teknikën dhe 0.4 për financat.
- c. Për secilën kategori, vlerësimet e ulëta, mesatare ose të larta u shoqëruan përkatësisht me 1, 2 ose 3 pikë. Në mënyrë të barabartë, masat totale marrin parasysh kriteret e bashkëpërfitimeve dhe lehtësinë e zbatimit. Niveli përfundimtar i prioritetit identifikon si "Shumë të lartë" veprimet me vlerësim >4.5 pikë, si "Të lartë" ato me $4.5 > x > 4.0$ dhe si "Mesatar" ato prioritete ato me vlerësim <4.0 (numri maksimal i pikëve që një veprim mund të marrë është 6).